


Shtator 2014  
Numri: 78  
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - [www.revistaetika.com](http://www.revistaetika.com)

Shqipëri: 200 Lekë  
Kosovë: 1.5 Euro  
Maqedoni: 90 Den  
Evropë: 7 Euro


# ETIKA



TË JETOSH MORALIN HYJNOR  
OSMAN NURI TOPBASH



MUSTAFA ERISH  
HISHAM IBN HAKIM  
NEXHAT IBRAHIMI  
SFIDAT E IMANIT  
NË JETËN  
BASHKEKOHORE



DR. MUHAMED MUSTAFI  
FUNKSIONALITETI  
I MENDIMIT ISLAM  
PËRSIATJE MBI  
MODERNIZMIN ISLAM  
DR. HUSEIN RIZAI



IMAM MUHAMED SYARI  
FANATIZMI  
ËSHTË NJË ENTUZIAZËM  
QË DJEG,  
JO NJË E VËRTETË  
QË NDRIÇON


## NJERIU BEBJA E SYRIT TË GJITHËSISË



ISSN 2227-3611  
0 9  
9 772227 361004

# Arsyeja *dhe* Filozofia


IRI



Një notar profesionist mund të notojë në ujëra të thella pa frikë, duke shijuar në këtë mënyrë bukuritë nënujore. Nuk ka asnjë problem për një besimtar cilësor, i cili ka njoħuri të mjaftueshme rrēth fesë së tij, të shëtisë nëpër kulturat e popujve të tjerë. Problem është të notosh në ujëra të thella pa ditur not. E rrezikshme është të përballesh me kulturat, botëkuptimet dhe rrymat e tjera filozofike, pa pasur njoħuritë e duhura rrēth Islamit. Në këtë rast ekziston rreziku për të mbetur nën ndikimin e tyre.

Një tjetër problem që ka sjellë filozofia, është përpjekja e disa pseudofilozofëve dashamirë dhe admirues të filozofisë perëndimore, për ta bazuar mendimin islam mbi themele filozofike. Kjo është një përpjekje tinëzare për të vendosur arsyen mbi shpalljen hyjnore.

TË  
RINJ



**SHQIPËRI:** Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"; Shkodër; Shqipëri | Mob: +355 67 607 8484 | E-mail: revistaetika@progresibotime.com

**KOSOVË:** Rr: Arđan Zurnaxhiu; pn. Ralin; Prizren; Kosovë | Mob: +377 4411 9848

**MAQEDONI:** Drvarska 28; Stara Carsija; Skopje; Makedonija | Mob: +389 7042 8245

Shtator 2014

**"...A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?.." (Zumer, 9)**

Ky ajet hyjnor, na tregon dallimin në peshën specifike që i sjell dija njeriut.

Kur flasim për botën islame prej një miliardi e gjysmë dhe me zemër të thyer vazhdojmë të përsëritim mjerimin, shtypjen dhe prapambetjen e kësaj bote. Siç e dimë, pothuajse e gjithë bota islame ka shumë probleme nga aspekti i lirive. Këtë e quajmë "kolonizim të hapur ose të fshehtë".

Nuk duhet harruar, se nëse Islami na fal "djinjtet", mungesa e lirisë, është formuesja më e madhe e atmosferës së shkatërrimit të dinjitetit. Nuk do të gabonim aspak nëse do të thoshim, se liria është kushti i domosdoshëm i Islamit.

Para së gjithash, nëse nuk keni liri, nuk mund të jeni vetvetja. Nëse nuk keni liri, nuk mund të ndërtoni as njeriun dhe as civilizimin tuaj.

Pula del nga veza e veza nga pula. Nëse nuk ka liri, Islami e ka të vështirë të ndërtojë njeriun e tij, e nëse nuk është ndërtuar njeriu i Islamit, është vështirë të arrihet lira. Në një qark të tillë jetojmë ne myslimanët.

Mbase kemi një farë gjallërimi:

Ne jemi të vetëdijshëm, se nuk kemi mundur ta ndërtojmë botën tonë. Jemi të vetëdijshëm ndaj dhimbjeve tona. Në zemrat tona kemi mallin që na bën të themi: "Dikur kemi qenë një popull, e çfarë popull se!". Nga zemrat tona ngrihen zëra që thonë: "Po më habit, ti nuk ke qenë kështu!". Në botën ku nuk gjendesh ti, njerëzimi po përjeton një fatkeqesi të madhe, siç është shkëputja nga vlerat njerëzore... Dhe kështu vazhdon lidhja jonë e cila na bën të themi të sigurt në vetvete: "Eja ti që të vijë Islami, të vijë njerëzimi".

Bota islame, myslimanët, janë të detyruar ta ngrenë peshën specifike të veçorive njerëzore. Nëse them, se pesha specifike që i ngarkohet njësisë njerëzore, duhet të jetë në gjendje të bartë shekullin, nuk e di se çfarë kuptohet, por duhet ta dimë, se ky shekull ka nevojë për një njeri me këto veçori.

Le të kemi njerëz simbol, të cilët ia paraqesim botës dhe ata shtohen me bukuritë që shfaqin; le të kemi institucionë simbol, deklarata simbol; le të kemi zgjidhje që u japid rrugëdalje krizave njerëzore...

Të gjitha këto arrihen me njeriun. Nëse besojmë se Islami është nevoja jetike për njeriun, duhet të dimë, se bartësi kryesor i kësaj, është vetë njeriu. Për këtë arsy, Islami, për njeriun dhe shoqërinë duhet të jetë dhënës më tepër se sa marrës, shndërrues më tepër se i shndërruar, ndikues më tepër se sa i ndikuar dhe subjekt më tepër se objekt.

Është humbur shumë kohë dhe janë krijuar distanca të mëdha. Atmosferën tonë e ka zaptuar një lloj radioaktiviteti kulturor që është futur deri në zemrat tona si një mbetje nukleare.

Duhet të investojmë për formimin e këtij njeriu.

Në horizont ekzistojnë argumentet e Allahut. Po, por edhe në vetët tona ekzistojnë argumentet e Tij. Njeriu duhet të përpinqet ta përdorë gjithësinë për hir të Allahut, por më parë, ka përgjegjësinë të punojë për të nxjerr në pah thesaret e groposura nën veten e tij.

Njeriu është bebja e syrit të gjithësisë.

VITI: VIII

NUMRI: 78

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Artur Tagani

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"  
Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 607 8484

E-MAIL

revistaetika@progresibotime.com

WEBSITE

www.revistaetika.com

KOSOVË

Rr: Aridian Zurnaxhiu; pn. Ralin  
Prizren; Kosovë  
Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija  
Skopje; Makedonija  
Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë  
Kosovë: 15 Euro  
Maledoni: 900 Denar

Ju bëjmë të ditur

se materialet e sjella në redaksi  
pavarësisht nëse botohen apo jo  
nuk i kthehen autorit. Koha e botimit  
të një materiali përcaktohet  
nga redaksia. Honoraret e shkrimeve  
autoriale ose përkthimeve duhet të  
vini t'i têrhiqi pranë  
Shtëpisë Botuese "Progresi"  
ose pranë zyrave të përfaqësimit  
në Kosovë dhe Maqedoni.

# Përbajtja


Anatomia e bijeve të Israilit  
Ilir Hoxha

20



- Mos e harro Zotin dhe jetën tjetër 28  
Xhafer Durmush  
Namazi me xhemat dhe vëllazëria islamë 30  
Dr. Kerim Bulladë  
Një Ajet - Një Hadith 32

- Përsiatje mbi modernizmin islam 44  
Dr. Husein Rizai  
Femrat dhe varret 51  
Muhammed El-Gazali  
Muri prej guri 54  
Nuredin Nazarko  
"Allahu për ju dëshiron lehtësim 56  
e nuk dëshiron vështirësim..."  
Fatmir Hadri  
Sjelljet e hijshme dhe respekti 59  
Naim Drijaj



Hisham ibn Hakim  
Mustafa Erish

52



# NJERIU

## BEBJA E SYRIT TË GJITHËSISË

Ahmet Tashgetiren

**“...gjithsesi ju jeni më të lartët, nëse jeni besimtarë të vërtetë.”** (Al ’Imran, 139)

Në përgjithësi, ajo që kuptojmë kur e lexojmë këtë ajet, është fakti që ne duke qenë besimtarë, jemi më të lartët. Është shumë e vërtetë, në këtë ajet, Allahu i Madhëruar aludon për një lloj epërsie. Por, nëse shohim mënyrën e formimit të ajetit, vëmë re se “të besuarit” është vënë si kusht i kësaj epërsie.

Vallë, çfarë lloj epërsie është kjo epërsi e lidhur me ekzistencën e besimit, ose çfarë cilësie besimi duhet, për t'u konsideruar i lartë në planin hyjnor?

Ndërkokë që vlerësojmë këto, ajeti që na vjen ndërmend **“...gjithsesi ju jeni më të lartët, nëse jeni besimtarë të vërtetë”**, duam apo nuk duam, flet për një epërsi në emër të besimtarëve. Mirëpo, nuk mund të rrimë pa menduar mbi pyetjen: “Po mjerimin e popullsisë myslimanë prej 1,5 miliardësh, si ta kuptojmë?”.

Në këtë pikë, probabilitetet që na vijnë në mendje, janë:

- Epërsia që Allahu i Madhëruar e përmend të lidhur

me besimin, është një lloj epërsie e veçantë, kështu myslimanët kanë një lloj epërsie tjetër, edhe pse duken të privuar nga epërsia në planin e kësaj bote.

- Ose, në të vërtetë nuk kemi asnjë lloj epërsie dhe përrjedhojë, kemi probleme në lidhje me çështjen e të qenit bashkësi besimtarare.

Vallë, cila prej këtyre është?

Pa asnjë dyshim, se bashkësia e myslimanëve mbi të cilët zbriti për herë të parë ky ajet, e posedonte pjeturinë e zemrës e cila ishte kusht i epërsisë. Sot, këtë ajet ne e lexojmë si bashkësia e myslimanëve pas 14 shekujsh dhe vërejmë një dallim shumë të madh.

Padyshim, se sa herë që t’i lexojmë këto ajete, duhet të shohim se sa u përshtatemi atyre. Kur lexojmë ajetet në lidhje me besimin, duhet të shohim cilësinë e besimit tonë. Kur lexojmë ajetet në lidhje me mohimin, idhujtarinë dhe dyfytërsinë, duhet të bëjmë kujdes që në zemrën tonë të mos ketë asnjë grimcë prej tyre.

Duke u nisur nga ky ajet, mund të mendojmë se në botën islame mund të ketë edhe kushte të tjera për

realizimin e kësaj epërsie në fusha të tjera. Pra, në fund të fundit edhe çështja e besimit ka të bëjë me cilësinë njerëzore, por edhe me epërsitë në fusha të tjera.

Ne, këtë e quajmë pesha specifike e njeriut. Pesha specifike e trupave, është e ndryshme. Dy trupa me të njëjtin volum, mund të mos kenë të njëjtën peshë. Kjo është një çështje që ka të bëjë me dallimet në peshën specifike. Për shembull, zhiva dhe hekuri kanë peshë specifiket të ndryshme.

Me sa duket, tek Krijues i Madhëruar edhe besimi formon një peshë specifike shumë të lartë për zemrën e njeriut. Për shembull, trurit tonë mund t'i ngarkojmë një peshë specifike të veçantë me anë të leximit, mendimit dhe zgjidhjes së disa problemeve. Rezistenca fizike e zemrës së çdo njeriu, nuk është e njëjtë me sasinë e ajrit që mund të thihin mushkëritë e tyre. Në sajë të stërvitjes që mund t'u bëjmë syve, veshëve, duarve, muskujve të krahëve dhe të këmbëve, ne shtojmë peshën specifike të tyre. Në sajë të disa ushtrimeve psikologjike, mund ta pajisim botën tonë shpirtërore me aftësi të veçanta.

"Dhikri" i Allahut të Madhëruar, të cilin Kurani e ka këshilluar për botën e zemrës, pra mos'harrimi i Allahut, përkujtimi i vazhdueshëm i Tij, mbushja e zemrës me Të dhe kënaqja me Të, janë përcaktuar si kusht i arritjes së qetësisë shpirtërore. Nisur nga logjika e Kuranit, zemra e cila nuk takohet me dhikrin/përkujtimin e Allahut, është një zemër që nuk e ka arritur ngopjen, pra që përjeton një lloj problemi në peshën specifike të saj.

Shkencat natyrore, si fizika, kimia dhe biologjia, ose shkencat shoqërore si psikologjia, sociologjia dhe logjika, apo edhe shkencat islamë si fikhu, hadithi dhe tefsiri dhe kërkimet shkencore në fushën e shpirtit, mund t'i pajisin njerëzit me pesha specifike të ndryshme nga njëri-tjetri.

**“...A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?..”** (Zumer, 9) Ky ajet hyjnor, na tregon dallimin në peshën specifike që i sjell dija njeriut.

Po flasim për botën islamë prej një miliardi e gjysmë dhe me zemër të thyer vazhdojmë të përsëritim mje-

rimin, shtypjen dhe prapambetjen e kësaj bote. Siç e dimë, pothuajse e gjithë bota islamë ka shumë probleme nga aspekti i lirive. Këtë e quajmë “kolonizim të hapur ose të fshehtë”.

Nuk duhet harruar, se nëse Islami na fal “dinxitet”, mungesa e lirisë, është formuesja më e madhe e atmosferës së shkatërrimit të dinxitetit. Nuk do të gabonim aspak nëse do të thoshim, se liria është kushti i domosdoshëm i Islamit.

Para së gjithash, nëse nuk keni liri, nuk mund të jeni vetvetja. Nëse nuk keni liri, nuk mund të ndërtoni as njeriun dhe as civilizimin tuaj.

Pula del nga veza e veza nga pula. Nëse nuk ka liri, Islami e ka të vështirë të ndërtojë njeriun e tij, e nëse nuk është ndërtuar njeriu i Islamit, është vështirë të arrihet liria. Në një qark të tillë jetojmë ne myslimanët.

Mbase kemi një farë gjallërimi:

Ne jemi të vetëdijshëm, se nuk kemi mundur ta ndërtojmë botën tonë. Jemi të vetëdijshëm ndaj dhimbjeve tona. Në zemrat tona kemi mallin që na bën të themi: “Dikur kemi qenë një popull, e çfarë populli se!”. Nga zemrat tona ngrihen zëra që thonë: “Po më habit, ti nuk ke qenë kështu!”. Në botën ku nuk gjendesh ti, njerëzimi po përjeton një fatkeqësi të madhe, siç është shkëputja nga vlerat njerëzore... Dhe kështu vazhdon lidhja jonë e cila na bën të themi të sigurt në vetvete: “Eja ti që të vijë Islami, të

vijë njerëzimi”.

Çështja është kjo:

Bota islamë, myslimanët, janë të detyruar ta ngrenë peshën specifike të veçorive njerëzore. Nëse them, se pesha specifike që i ngarkohet njësisë njerëzore, duhet të jetë në gjendje të bartë shekullin, nuk e di se çfarë kuptohet, por duhet ta dimë, se ky shekull ka nevojë për një njeri me këto veçori.

Të mendojmë Turqinë:

Këtë vit, në Turqi fillojnë ciklin arsimor 9 vjeçar 17 milion fëmijë. Ndërsa 5 milion të rinj shkojnë në universitet, në nivelet baçelor, master dhe doktoraturë. Kjo do të thotë, 22 milion njerëz në moshën e arsimit. Fara e së

Në horizont ekzistojnë argumentet e Allahut. Po, por edhe në veten tonë ekzistojnë argumentet e Tij. Njeriu duhet të përpinqet ta përdorë gjithësinë për hir të Allahut, por më parë, ka përgjegjësinë të punojë për të nxjerr në pah thesaret e groposura në veten e tij.

ardhmes së Turqisë, është e fshehur në këtë brez.

Të pyesim veten:

Në sa përqind të këtij brezi kemi thurur plane,ëndrra apo investimet tona? Tashmë bota është e globalizuar. Ashtu siç mund t'i shtonit vlerat tuaja tek njerëzi tuaj, ashtu mund t'i shtonit ato edhe tek njerëzit e shoqërive të tjera.

Njësoj si shoqëritë e tjera që e shtojnë tek njerëzit dhe fëmijët tanë kulturën dhe vlerat e tyre. Sa prej vlerave tona shëtisin në Amerikë, sa prej kulturës dhe vlerave Amerikane-Perëndimore shëtisin tek ne?

A nuk është drithëruese kjo pyetje për sa i përket pluseve-minuseve tona?

Kur thuhet peshë specifike, duhet të kemi parasysh edhe fushat e kalbura të veçorive tona njerëzore. Kodet e sjelljes jonjerëzore që shëtisin në personalitetin tonë, në një farë kuptimi, janë zonat e kalbura që e ulin peshën tonë specifike.

Le të kemi njerëz simbol, të cilët ia paraqesim botës dhe ata shtohen me bukuritë që shfaqin; le të kemi institucionë simbol, deklarata simbol; le të kemi zgjidhje që u jasin rrugëdalje krizave njerëzore...

Të gjitha këto arrihen me njeriun. Nëse besojmë se Islami është nevoja jetike për njeriun, duhet të dimë, se bartësi kryesor i kësaj, është vetë njeriu. Për këtë arsy, Islami, për njeriun dhe shoqërinë duhet të jetë dhënës më tepër se sa marrës, shndërrues më tepër se i shndërruar, ndikues më tepër se sa i ndikuar dhe subjekt më tepër se objekt.

Është humbur shumë kohë dhe janë krijuar distanca të mëdha. Atmosferën tonë e ka zaptuar një lloj radioaktiviteti kulturor që është futur deri në zemrat tona

si një mbetje nukleare.

Studimet në cilësinë e përkufizimit të grupeve të reja rimore, si brezi X apo brezi Y, dalin në rezultatin se distanca midis prindërve dhe fëmijëve, është zmadhuar në disfavor të prindërve.

E thënë shkoqur, bëhet fjalë për fenomenin e grabitjes së zemrave të brezave të rinx. Pas një farë kohe, mund të shfaqet fenomeni i prindërve dhe fëmijëve që nuk e kuptojnë gjuhën kulturore të njëri-tjetrit.

Sa kultura jetojnë në secilin prej nesh? Ku është Amerika, Rusia apo Medina në personalitetin tonë?

Cilësia njerëzore.

Problemi më i dhimbshëm i botës islame. Pesha specifike e njerëzve tanë. Njeriu të cilit i është rritur pesha specifike, si nga ana e vlerave personale islame, ashtu edhe nga ana dijeve që na jashtë mundësi të përdorim botën brenda kuadrit njerëzor.

Investimi tek ky njeri.

Të gjitha strukturat që nuk kanë në aktualitetin e tyre investimin tek njeriu, janë të dënuara ta humbasin të ardhmen e tyre. Gjithësia është vënë nën shërbimin e njeriut. Vet njeriu, është vënë në shërbim të njeriut.

Në horizont ekzistojnë argumentet e Allahut. Po, por edhe në veten tonë ekzistojnë argumentet e Tij. Njeriu duhet të përpinqet ta përdorë gjithësinë për hir të Allahut, por më parë, ka përgjegjësinë të punojë për të nxjerr në pah thesaret e groposura në veten e tij.

Njeriu është bebja e syrit të gjithësisë.

Me këtë sy duhet ta shohim veten dhe çdo njeri që lind. Dhe po me këtë kujdes, duhet të zhvillojmë potencialet tona... Kjo është sprova jonë.





Dr. Adem Ergyl

## Ata që kërkojnë një burrë të fjalës...

Po bashkëbisedoja me një mikun tim, një student i pjekur dhe i suksesshëm universiteti, gjatë një udhëtimi. Pasi folëm për gjëra të ndryshme radha erdhi tek marrëdhënia me familjen. Pasi më kishte treguar një copë herë të mirë në lidhje me dashurinë dhe respektin që kishte për prindërit e tij, një moment djaloshit iu përlotën sytë dhe më tha:

- I nderuar profesor, ne jemi një familje e mesme nga ana financiare. Jemi dy vëllezër që mësojmë në shkollë. Pa dyshim që arsimimi ynë i kushton finanziarish familjes sonë. Kjo më bën që herë pas here thellë në zemër të përjetoj ndaj babait tim ndjenja të fuqishme dhembshurie dhe keqardhjeje. Një herë kur ia shpreha këto ndjenja dhe mendime tim eti, ai më dha një përgjigje që nuk kam për ta harruar sa të jem gjallë. Ai më tha: "Biri im! Ju mos neglizhonni mësimet në mënyrë që të arsimoheni dhe të edukoheni. Ne jemi pleq dhe jetojmë edhe vetëm me bukë dhe me qepë. Po qe se nuk kemi para, jemi gati të shesim edhe shtëpinë dhe nuk do t'ju lëmë pa ju arsimuar. Mos u bëni merak për ne! Mjafton që ju të bëheni njerëz cilësorë që do t'i shërbeni atdheut dhe popullit tuaj.

Ja pra, çdo njeri i edukuar dhe i suksesshëm në jetë ka pas një histori të tillë të jetës, e cila duhet marrë parasysh. Në këtë histori do të ketë përherë mbështetësit, përpjekjet e tij personale dhe sa e sa mjete të tjera që e kanë ngritur drejt suksesit. Këto rrëfime suksesi në jetë kanë përherë lidhje me lutjet, përpjekjet, vështirësitet e përjetuara, durimin, këmbënguljen, sakrificën, vështrimet plot shpresë dhe interesimin e më të më-

dhenjve ndaj më të rinjve. Këta njerëz më të mëdhenj mund të janë prindërit, por edhe vëllezërit e mëdhenj, ndoshta edhe xhaxhai apo daja, mbase tezet apo hallat, ndonjëherë një mësues ose një njeri i singertë besimtar. Nuk ka dyshim se në historinë e suksesit një vend të rëndësishëm ka vetë personi mbi të cilin investohet. Aftësitë e tij, vullneti, dëshira, durimi, këmbëngulja, synimet, mundësitet që i ofron vendi dhe koha ku jeton dhe mbi të gjitha rrizku që i ka paracaktuar atij Zoti.

Në qoftë se mbjellja e pemës është sadaka, atëherë vallë çfarë sadakaje është mundësimi i formimit të një personi? Nuk ka dyshim se edukimi i një personi është një art i vështirë që nuk përngjan me edukimin e bagëtive apo me rritjen e bimëve. Nuk ngjason as me një makinë që punon si robot. Ai është një krijesë me zemër të ndjeshme. Adminstrimi i ndjenjave të një personi është puna më e vështirë. Durimi ndaj shpirtit që mund të ndryshojë në çdo moment duke përjetuar ngritje dhe rënje nuk është një punë e lehtë që njeriu i ingratë mund ta kryejë me fuqinë e tij. Pa stabilitet dhe pa qëndrueshmëri nuk ka edukim dhe përparim. Ata që kërkojnë të kultivojnë një burrë të vërtetë në jetë, duhet që në një anë t'i drejtotohen Zotit dhe nga ana tjetër të kërkojnë mundësi dhe të bëjnë ato përpjekje nëpërmjet të cilave do ta përfitojë mëshirën dhe ndihmën e Allahut, duke iu qasur individit me mirësjellje në shoqérinë e një zemre të ndjeshme. Para së gjithash, çdo njeri duhet ta konsiderojmë të vlefshëm apo ashtu siç është shprehur mendimtari i njojur Muhammed Ikbali: "Vlera e njeriut është më e lartë se vetë qielli, ndërsa baza e arsimimit dhe edukimit të tij është respektimi i njeriut." Zbulimi i saktë i vlerave

dhe aftësive që përmban çdo njeri dhe njohja e tij nga të gjitha aspektet ka rëndësi shumë të madhe nga aspekti i përgatitjes dhe zhvillimit të tij. Për këtë eshtë e nevojshme largpamësia dhe mendjemprehtësia. Ndërhyrjet e bëra kuturu dhe në mënyrë të verbër në të shumtën e herëve bëhen shkak që njeriu të plagoset, madje edhe të gjymtohet dhe ndoshta të vdesë nga aspekti shpirtëror. Nuk ka dyshim se njerëzit që merren me edukimin e njerezve kanë nevojë të kenë një nivel të caktuar njohurish, por për ta eshtë shumë më e domosdoshme të kenë një zemër të mbushur plot me dhembshuri dhe me dashuri. Zemra e mbushur plot me dashuri dhe me dhembshuri eshtë burimi më i rëndësishëm i energjisë pozitive që e mbush me vlera pozitive fushën e interesimit. Interesimi i realizuar në mënyrë tangente dhe të thjeshtë nuk eshtë asnjëherë zhvillues dhe ushqyes. Gjithashtu edhe interesimet e mbështetura në interesa personale dhe të kushtëzuara nuk janë të frytshme. Interesimi me synim skllavërimin e personit me logjikën se "njeriu eshtë robi i mirësisë që i bëhet", nuk mbjell në zemrën e bashkëbisësuesit farat e dashurisë, por të urrejtjes dhe kështu që nuk ka për të qenë asnjëherë një lloj edukimi.

Durimi në emër të formimit të individit eshtë një bazë e pashmangshme. Madje lindja para kohe e fëmijës mund të përfundojë me ndërprerjen e jetës së tij. Prandaj lindjet e personaliteteve dhe autoritetet e shëndoshë janë më shumë të vështira dhe të gjata sesa lindjet biologjike. Për këtë arsy, ata që nuk dinë të tregojnë durim dhe këmbëngulje, nuk mund të ndihmojnë asnjëherë që botës t'i vijnë personalitetet e nevojshme. Këqyrja e vazhdueshme e personit që dëshirojmë të formojmë, kujdesi i vazhdueshëm ndaj tij, më e rëndësishëmja, krijimi i vendit të lirë për të në zemër dhe në shpirt, madje edhe ndarja me të e mundësive të jetës kanë qenë metodat e edukimit të suksesshëm që kanë aplikuar murshidët dhe edukatorët e suksesshëm. Njeriu i vërtetë nuk mund të formohet dhe të lulëzojë pranë personave egoistë, që mendojnë vetëm për interesat e tyre. Ata që nuk e durojnë tipin e ndryshëm, që nuk dinë ta falin atë kur eshtë e nevojshme dhe që nuk e mbyllin njërin sy ndonjëherë përgabime të lehta, janë njerëz shterpë në drejtim të formimit të personaliteteve. Fjalët e gnostikut dhe murshidit të madh Mustafa efendi Haxhivejsizade se "po qe nevoja përballem me shqetësimet e një mijë mynafikëve, që të arrij të formoj një personalitet të vërtetë mysliman" eshtë një shembull i goditur që pasqyron shpirtin e thellë të edukatorëve të suksesshëm. Të mundësosh edukimin e një njeriu cilësor, ndonjëherë eshtë e nevojshme të përballohen vështirësitë që të krijojnë qindra njerëz të tjerë. Koncepti që i mveshet sulltan Mehmetit II se "Jam i gatshëm të duroj problemet e një mijë personave vetëm e vetëm që të arrij të formoj një personalitet të vërtetë", shpreh një përvjohje liderëshipi që eshtë formuar me kalimin e shekujuve. Këto fjalë mund t'i shprehë secili, por pranimi i tyre kërkon një horizont të gjërë. Sa e sa insitucionet janë mbyllur brenda një

kohe të shkurtër për shkak të mungesës së horizontit të gjerë dhe të mungesës së durimit. Një herë, një mislik mysliman më pati këshilluar me këto fjalë: "Biri im, ndonjëherë një person i vetëm duhet konsideruar si të ishte një klasë e tërë. Edhe sikur t'i caktoni dhjetë mësues një njeriu të tillë nuk keni bërë shpenzim të tepërt për të. Ka studentë për të cilët po të shpenzoni vetëm një lek dhe eshtë e tepërt, por ka studentë të tillë që po të harxhon miliona për ta, ia vlen!" Sa konstatim i saktë! Vetëm përreth këtij botëkuptimi mund të formohen dhe të zhvillohen njerëz të suksesshëm. Ka edhe nga ata që kërkojnë personalitetet e që nuk i vlerësojnë njerëzit e aftë që kanë para syve, por duke u kyçur në portretin e personalitetit që kanë vizuatuar në imagjinatën e tyre, ata çojnë dëm sa e sa mundësi financiare. Allahu (xh.sh.) ia pati tërhequr vërejtjen në këtë pikë vetë Profetit të Tij, Muhamed (a.s.), duke e urdhëruar që të interesohet dhe të mos i nënveftësonët aspak personat që Zoti i kishte drejtuar në shoqërimin e tij, vetëm e vetëm se këta persona konsideroheshin të parëndësishëm nga ana tjetër e shoqërisë. (Kehf, 28) Në këtë kontekst, mjeshtri që lavdëron çirakun e mjeshtrit tjetër dhe nuk e vlerëson çirakun e tij, prindërit që ua ngulin sytë fëmijëve të të tjerëve dhe nënveftësojnë fëmijët e tyre, mësuesi apo edukatori që merret me nxënësit e të tjerëve dhe hedh pas krahësh nxënësit e tij, administratori apo lideri që nënveftëson ekipin e tij dhe lartëson personelin e të tjerëve, të gjithë këta nuk ka dyshim që kanë rënë brenda një mashtimi të qartë.

Po aq sa eshtë fitore e madhe formimi dhe edukimi i një personaliteti të madh, po aq humbje e madhe eshtë të mos vlerësosh njerëzit e formuar apo të tregohesh indiferent dhe të heshtësh përpëra humbjes së tyre, në emër të fesë, kombit, atdheut, madje edhe në emër të njerëzimit. Po kështu, të shuash një zemër të gjallë, të çosh dëm aftësitë e personave të caktuar, të shuash entuziazmin e njerëzve, të skllavërosh njerëzit apo t'i kthesht ata në robotë, eshtë një tradhti e madhe që i bëhet kapitalit njerëzor të umetit. Si përfundim, në qoftë se formimi i një personaliteti të vërtetë eshtë ideali ynë, kjo nuk do të arrihet të realizohet pa zemër të ndjeshme, pa dashuri, pa durim, pa këmbëngulje, pa dhembshuri, pa interesim dhe pa dua.





Imam Muhammed Sytar  
Myfti i Zonës Shkodër

# FANATIZMI

## ËSHTË NJË ENTUZIAZËM QË DJEG, JO NJË E VËRTETË QË NDRICON

"Në Islam, besimi i saktë është frut i vullnetit të lirë", shkruan dijetari dhe mendimtari i shqar islam i shekullit të kaluar, Shejkh Muhammed El-Gazali, në një ndër kryeveprat e tij rreth fanatizmit dhe tolerancës, në mes të Krishterimit dhe Islamit.

Natyshëm, në një botë të rënduar nga luftërat dhe mashtimet, spastrimet etnike e dallimet raciste, shpesh me ngjyresë fetare, të gjithë jemi të ftuar të pyesim me qetësi në brendësi të vetes: A është ky thelli i fesë sime? A është kjo feja, që Zoti ka zbritur për njerëzimin, si mëshirë e balsam shërues për lëngatat e shumta shoqërore? A janë vrashjet, dhunimet dhe shkel-

jet e të drejtave të besimtarëve (të ndryshëm nga ne), feja, në të cilën ne besojmë dhe me të cilën shpresojmë të afrohemë tek Zoti?

Këto pyetje, e të tjera të ngjashme me to, duhet t'ia drejtojë vetes çdo mysliman, çdo i krishterë, çdokush që beson në një fé, që ka një Libër Hyjnor e një të Dërguar nga Zoti i gjithësisë!

Në fund të vitit të kaluar, teksa bëja llogaritë e vitit kalendarik 2013, prej të cilit po ndaheshim, vit që u mbyll me shkatërrimin e xhamive në Angola (veprim fanatik e ekstremist fetar, për të cilin askush nuk e ngriti zërin dhe askush nuk u distancua publikisht), publikova shkrimin me titull: "Viti 2013-vit i dekadencës shpirtërore të njeriut bashkëkohor..."

1. Shejkh Muhammed El-Gazali, "Et-Teassubu vet-Tesamuhi bejn-Mesihijjeti vel-Islam", Kajro, 1997, fq. 9.

Akoma sot, pasi kanë kaluar rreth tetë muaj nga ai shkrim, unë vazhdoj të besoj se bota e sotme, njësoj si ajo e viti që lamë pas, vazhdon të rrugëtojë në momentet më të errëta të historisë së saj.

Citoj nga shkrimi në fjalë: "Njeriu i vitiit 2013 dështoi në rrugën e vërtetimit se është i denjë të dëshmojë vëllazërinë e shenjtë humane, atë për të cilën Zoti i njeriut, nëpërmjet Librave të Shenjtë, e ka ftuar atë ta dojë e ta respektojë vëllain e tij human, të dojë për tjetrin atë që do përvete, të mos punojë pas krahëve, të mos vrasë, të mos bëjë tregti me imoralitetin, etj.

Me veprën e tij, njeriu bashkëkohor i vitiit 2013 vërtetoi dekadencën dhe rrugëtimin në labirinthet e errëta të injorancës dhe fanatizmit ekstremist e vrastar, pa mëshirë e dhembshuri, pa ndjenja njerëzore..."

Dhe kjo dekadencë sa vjen e shtohet, fatkeqësisht? Tashmë, ajo ka marrë një pamje edhe më të frikshme, edhe më të kobshme, që na bën të gjithëve të reflektojmë e të mbajmë pozicionin tonë në raport me atë që shohim e dëgjojmë dhe qëndrimin që duhet mbajtur në raport me të ardhmen, për të cilën aspirojmë!

Ky vit u dëshmua si viti i pashpirtësisë së atyre, që shkelën dhe grisën shenjtërinë e Muajit të Shenjtë Ramazan, duke vrarë, bombarduar e shkatërruar jetë të pafajshme, fëmijë me fytyra të ndritshme, pasuri e shtëpi të myslimanëve të izoluar në Gaza të Palestinës së pushtuar!

U dëshmua si vit i ndëshkimeve kolektive të të krishterëve të pafajshëm në Musil dhe jezidive të pafajshëm në malet e Sinxharit, vetëm e vetëm se ndryshojnë në mendim e fé nga ca të armatosur nga kushedi se ku e kush, për të mbjellë injorancë e dhunë në tokë!

U lëndova shumë, kur pashë se harfi kuranor "Nún", i shtrenjtë "Nún", për të cilin Zoti betohet në Librin e Tij, u vendos si shenjë racizmi e intolerance, mbi shtëpitë e të krishterëve të pafajshëm në Musilin e Irakut të sotëm?

A ka logjikë fetare e islame një veprim i tillë? A mund ta pranoj unë si mysliman këtë spastrim etnik e fetar, gjoja në emër të Islamit? Cilit Islam? A mund ta pranoj unë si mysliman i thjeshtë, por edhe si islamolog e prijës fetar, një veprim të tillë në emër të fesë sime? Jo, KURRË! Kjo nuk është feja ime! Ky nuk është Islami i Kurant dhe i Hz. Muhamedit! Kjo është injoranca vrastare, që shënon me "Nún" edhe shtëpinë time, edhe mua, edhe familjen time, edhe çdo mysliman besimtar në lirinë e besimit dhe respektimin e tjeterit, edhe besimin tim, edhe fenë time!

Po lexoja me vëmendje një ndër studimet e shumta të dijetarit botëror, Shejkh Ahmed Keftaro, rreth dialogut ndërfetar dhe respektimit të jomyslimanëve

në Islam. Shkruante: "Kurani Famëlartë, në têrësinë e tij është dialog i lirë dhe i respektuar, në mes Hz. Muhamedit (a.s.) dhe të dërguarve para tij dhe popujve kundërshtarë të tyre në fé. Ai ishte një dialog i lirë, i moralshëm, logjik... Pastaj, në kohën kur dërgesës profetike të Muhamedit (a.s.), iu shtua edhe pushteti dhe forca e organizimit, zbriti ajeti kuranor: "**Nuk ka dhunë në fé...**"

Tradita profetike e Hz. Muhamedit (a.s.), në marrëdhëni me jomyslimanët, nuk ishte asgjë tjetër vetëm se një praktikë e pastër e lirisë së feve dhe një thirrje drejt dialogut të ndërtuar mbi bazat e respektit të ndersjelltë, mbi themele logjike dhe argumente të qarta, në kërkim të së vërtetës.

Ndërkokë, historia islame është e mbushur me shembuj të pastër se si kalifët dhe dijetarët islamë zhvillonin takime dhe bashkëbisedime intelektuale, ku dialogu i lirë (me aq sa kuptohet nga kjo fjalë) ishte etiketë qytetëruese, sidomos në kalifatin emevit dhe atë abasit, të nxitur nga vlerat e Kurant dhe Traditës profetike në këtë drejtim..."<sup>2</sup>

Ndërkokë, në librin e tij: "Rruja e së vërtetës", Kryemyftiu sirian ndër të tjera theksion: "Kur kristianët e Nexhranit e vizituan Hz. Muhamedin (a.s.), ai me respekt e dëshirë i lejoi ata të bënin lutjet në xhaminë e tij".

Kur perandoria e Islamit shtrihej nga Kina deri në Francë, një tempull romak në Damask u përkiste njësoj, edhe myslimanëve edhe kristianëve, të cilët hynin dhe dilnin nga një derë dhe i thoshin lutjet e tyre në tolerancë dhe të lirë. Për shkak të përqafimit të Islamit nga një numër i madh kristianësh në Siri, gjysma myslimanë nuk kishte më vend të mjaftueshëm për t'u falur, kështu që Kalifi El-Velid u kërkoi kristianëve të hiqnin dorë nga gjysma e tyre e tempullit, në favor të myslimanëve, në shkëmbim të një çmimi dhjetë herë më shumë, për të cilin ata me dëshirë ranë dakord.

Kalifi, i cili qeveriste gjysmën e botës së lashtë në atë kohë, mund ta kishte marrë tempullin me forcë, por meqenëse Islami është feja e lirisë, drejtësisë dhe adhurimit për të gjithë fetë e reveluara, ai mund të bënë te vetëm atë që bëri.

Pikëpamja e Islamit ndaj hebrejnje dhe ndjekësve të të gjitha feve të reveluara mund të nxirret si rrjedhim i këtij hadithi profetik: "Kushdo që trazon (ngacmon) një jomysliman do të jetë kundërshtari im në Ditën e Gjykimit dhe unë do të fitoj." (Ibn Maxheh).<sup>3</sup>

Po të thellohem i më tej në historinë islame, atë të

2. Nga studimi i paraqitur nga Kryemyftiu i Sirisë, Shejkh Ahmed Keftaro, në konferencën e organizuar nga Këshilli Botëror përf Fetë, në San-Francisko, 1990.

3. Shejkh Ahmed Keftaro, "Rruja e së vërtetës", dorëshkrimi në gj - hën shqipe, përkthyer nga anglishtja nga znj. Shpresa Bushati, Shkodër, 2009.

lavdisë së kalifateve të drejta, do të gjejmë se: "Një atmosferë e mrekullueshme nga atmosferat e lirisë së të menduarit është edhe kuvendi i organizuar nga kalifi abasit El-Me'mun, për Imamin Ali ibn Musa Er-Rida, ku ishin ftuar dijetarë të krishterë, me shusë e të tjerë nga fetë dhe besimet e përhapura asokohe. Dialogu i ndërsjellë në atë kuvend, konsiderohet si një dëshmi historike e asaj çfarë përfaqëson Islami në horizontin e gjerë dhe zemërgjerësinë në fushën e thirrjes dhe besimit".<sup>4</sup>

Por, ka edhe shumë argumente e dëshmi kuranore e profetike, të përkthyera në histori të jetuar, përtej tubimeve dhe kuvendeve të dialogut dhe respektimit ndërfetar, në të shkuanët e ndërtuar mbi burimet dhe themellet e kulturës kuranore dhe traditave profetike.

Është shumë interesant rasti i Shejkul-Islamit Ibn Tejmije, në mbrojtje të të krishterëve sirianë, në ditët e pushtimeve tatare. Ja sesi dëshmohet ky moment, që përbën histori më vete, në raportet e mbrojtjes së të krishterëve dhe jomyslimanëve në përgjithësi, në shoqëritë islame: "Prej shembujve dhe dëshmive historike, që tregonjë angazhimin e myslimanëve përmbrojtjen e "njerezve të besës" (jomyslimanëve në shtetin islam), është edhe qëndrimi i Shejkul-Islamit Ibn Tejmije (v.1328 e.r.), kur tatarët pushtuan Damaskun. Asokohe, mbreti tatar vendosi të lirojë nga burgu vetëm myslimanët. Por dijetari i shqar Ibn Tejmije e refuzoi me të madhe këtë vendim dhe kërkoi lirimin e krejt të burgosurve, myslimanë e të krishterë, duke sqaruar se: "Ne nuk pranojmë vetëm se lirimin e plotë të krejt të burgosurve, myslimanë dhe jomyslimanë, sepse ata janë në besën tonë. Nuk do të lëmë asnje të burgosur, as prej njerëzve të besës, as prej njerëzve të fesë tonë". Madje, Ibn Tejmije ua obligoi myslimanëve vijimësinë e luftës deri në lirimin e plotë të krejt të burgosurve, gjë që e detyroi mbretin tatar t'i lironë krejt të burgosurit".<sup>5</sup>

Ky është Islami (shembujt argumentues që përbëjnë féjanë të shumtë dhe të panumërt, nuk mund të bitisen në këtë material modest), feja ime, thirrja ime, besimi im, në të cilin mbështetem dhe përpiqem si mysliman, por edhe si qytetar shqiptar dhe si banor i kësaj toke,

të ndërtoj urat e komunikimit dhe dialogut me cilindo, që ka zgjedhur në lirinë e vullnetit të tij të jetë ndryshe nga unë në besim e fë!

Dua ta mbyll, me një mesazh, që i drejtohet sojtit tim, prijësve fetarë, të cilësdo feje qofshin, nga një njeri i urtë i ditur, thellësisht kuptues i vërtetësive të fesë dhe thirrës drejt tyre; Shejkh Ahmed Keftaro (1915-2004).

Në kujtimet e tij, Kryemyftiu i Sirisë dëshmon: "E kam vizituar Vatikanin tri herë, ku jam takuar me Papa Gjon Palin II. Herën e parë, kur më kërkoi të mbaja një referat në Vatikan me temë: "E ardhma e Islamit dhe Krishterimit në kohët moderne". Herën e dytë, kur mbajta një referat në Universitetin e Milanos, me temë: "Toleranca fetare në Islam".

Herën e tretë, në një takim të posaçëm me Papën, që zgjati 60 minuta, i thashë Papa Gjon Palit II: 'A e di

se kush është shkaku kryesor i

përhapjes së ateizmit në botë?

Ma ktheu: 'Kush?' I thashë: 'Til!'

(Kur Papa dëgjoi këtë përgjigje, e pashë se u sikletos dhe u bez-

dis prej saj.) Pastaj vijova: 'Edhe unë!' Më pyeti: 'Si ka mundësi kjo?' I ktheva: 'Sepse ne, një-

rezit e fesë, e kemi paraqitur fenë në mënyrë jologjike, as në

vërtetësinë e saj, as në formën

më të bukur e të pranuar...' His-

toria na tregon se si u përçanë

drejtimet fetare në krishterim,

po ashtu edhe në Islam. **Ndërsa**

**ne, nuk e kemi guximin ta kthej-**

**më fenë në origjinën e saj".<sup>6</sup>**

Sepse, siç thotë edhe Shejkh Muhammed

El-Gazali: "Fanatzimi është një entuziazëm që djeg,

jo një e vërtetë që ndriçon"<sup>7</sup> dhe fanatzimi injorant, i

ndërtuar mbi perversitete në emër të fesë, nuk është

feja ime!

Zot, ki mëshirë përmyslumanët e pafajshëm në Gaza, përmëtë krishterët e pafajshëm në Musil, përmëtë jeziditët e pafajshëm në Sinxhar, përmyslumanët në Turkistanin e largët, përmyslumanët e Afrikës, përmyslumanët e Burmas, përmëtë gjitha kriesat e Tua të pafajshme në mbarë botën, që vriten e ndëshkohen, që shkelen e dhunohen, nga injoranca dhe fanatzimi afetar, shpesh i veshur edhe me rrobat e fesë, cilësdo fë!



4. Ajetull-llahil-udhma Es-Sejjid Muhammed Husejn Fadlull-llah, "El-Hivaru fil-Kuran", botimi i V-të, Bejrut, 1996, fq. 41.

5. Dr. Bessam Aixhik, "El-Hivarul-Islamili-Mesihi", botimi i III-të, Damask, 2008, fq. 39. (Duke u bazuar në referencat përkatëse).

6. Imd Nedaf, "Esh-Shejkh Ahmed Keftaro jetehaddeth", botimi I, Damask, 1997, fq. 131.

7. Shejkh Muhammed El-Gazali, "Et-Teassubu vet-Tesamuhi bejn-Mesihijjeti vel-Islam", Kajro, 1997, fq. 79.



# Sfidat e IMANIT

## në jetën bashkëkohore

Nexhat Ibrahimli

### HYRJE

Vendet e Ballkanit dhe në veçanti trojet shqiptare janë në periudhë tranzicioni. Po ndodhë kalimi prej sistemit socialist të politikës, ekonomisë, kulturës, shoqërisë në sistemin shekullar, i cili si bazë ka *demokracinë* dhe *ekonominë e tregut*. Nëse mund të thuhet se ndryshime ka në këtë rrafsh, a mund të thuhet e njëjtë edhe për aspektin e brendshëm, shpirtëror dhe cilat janë sfidat, rreziqet dhe përparësítë (nëse ka diçka tē tillë)?

Sfida e parë është *liria fetare* e rrejshme, e cila nuk bën tē na mashtrojë. Sot vërtet nuk ka dhunë e imponim sikurse në kohën e komunizmit, sot vërtet feja pranohet si e drejtë legitime e njeriut dhe mund tē manifestohet lirisht, sot vërtet mund tē shkrurajmë për fenë dhe tē mësojmë për fenë. Por sot kemi presion tjetër, shumë më kamouflues, shumë më i rrezikshëm sesa i pari, sepse

të qesh para fytyrës e të vret pas shpine.

Rreziku i kësaj ideologjje përbëhet në atë që fryma e saj drejt rritjes materiale është e vazhdueshme dhe e pamëshirshme, duke mos zgjedhur mjete për të realizuar synimet. Sipas tyre, nëse një individ, grup apo shoqëri e humb synimin për rritje dhe pasurim të vazhdueshëm ajo shoqëri e ka orientuar veten drejt zhdukjes. Ky motiv dhe ky parim është korrekt, nëse shërben për mirëqenien njerëzore, fizike dhe shpirtërore e jo përjashtimisht për rritjen materiale dhe fuqizimin fizik, në frymën e teorisë së Darvinit, se vetëm tē fuqishmit mbijetojnë. Kështu vepron edhe ekonomia e tregut, filozofi e së cilës është: tē mbijetojnë tē fuqishmit, kurse tē tjerët tē zhduken ose tē shndërrohen në sklevër modernë. Kjo lojë e ekonomisë së tregut i pasuron edhe më tē pasurit dhe i varfëron edhe më tē varfrtit. Vlera e tërë këtij aktiviteti

matet në grumbullimin sa më të madh të pasurisë, duke pasur synimin e Nikolla Makiavelit se "synimi justifikon mjetet". (Nikolo Machiavelli, Sundimtari, Prishtinë, 1990).

Kjo filozofi nuk mund ta kuptojë se ekonomia islame vpron me parime krejt të ndryshme. Ajo ndjek porosinë / ekonominë e Kuranit, sipas së cilës ajo që shpenzohet në rrugën e Zotit dhe për kënaqësi të Tij, rritet shumëfish:

**"Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut, i shëmbëlljenë atij që mbjell (një) kokërr nga e cila dalin shtatë kallinj, dhe në çdo kalli nga njëqind kokrra. - Allahu ia shton (shpërblimin) edhe më tepër atij që do; se Allahu është i Gjithëdijshëm dhe Mirëbërës i madh."** (Bekare, 261)

Ekonomia islame afaristin e fton në sinqeritet, e fton në luftë kundër egoizmit dhe pandjeshmërisë dhe për bamirësi dhe altruizëm.

### PUNA DHE FITIMI HARAM

Çdo mysliman e ka të njobur se kryerja e çdo pune dhe aktiviteti që çon në prodhimin, qarkullimin dhe shpërndarjen e prodhimeve haram është rigorozisht e ndaluar. Këtu bëjnë pjesë alkooli, drogat e ndryshme mishi i derrit dhe derivatet e tij, mediat pornografike dhe çdo gjë tjetër që direkt apo indirekt prodhon apo ndihmon në prodhimin apo bërjen e haramit.

Sot qytetet tona në Kosovë, edhe pse nuk qeverisen nga serbët, por edhe ato në viset e tjera shqiptare, nuk mund të arsyetohen se serbët ua imponojnë llojin dhe mënyrën e tregtisë. Këtë e bëjnë ata vetë, për të rritur qarkullimin dhe fitimin material. Prandaj, shesin alkool dhe pije dehëse të formave e emrave të ndryshëm.

Rreziku tjetër i madh qëndron në sistemin ekonomik ku shfrytëzimi i klientit bëhet në masë të madhe. Në-përmjet shkallëve të larta të interesit, lexo shfrytëzimit të klientëve, afaristëve, ata e nënshtrojnë njeriun. Sot pothuajse është e pamundur të zhvillosh biznes e të mos zhvillosh afarizëm me bankat, të bazuar në sistem kamator të vrazhdë. Rrugëdalje për këtë është zhvillimi i sistemit bankar mysliman, i cili përfat të keq është i dobët dhe i pakapshëm për 99% të myslimanëve të botës.

### RRËNIMI I BARAZPESHËS MES IBADETIT DHE PUNËS

Barazpesha në meditim, punë, pushim e tjera është gjëja ideale që duhet ta synojë njeriu. I tillë është i tërë kozmosi. Çdo dalje prej këtij sistemi domethënë prishje e rendit kozmik, është largim nga udha e Allahut të Më-shirshëm. Por këtë barazpeshë njeriu duhet ta mbajë

edhe në aspekt të ibadetit dhe punës. Njeriu duhet t'u shmanget dy skajshmërive: skajshmëria e parë është braktisja e punës dhe dhënia me qëllim pas përtacisë. Kjo vërejtje nuk vlen për të sëmurët, të pafuqishmit, të paaftët për të punuar apo për ata që janë në rrugën e Allahut dhe nuk kanë kohë të fitojnë ndryshe. " (Sadakaja) **u takon të varfërve, të cilët, të angazhuar në rrugën e Zotit nuk janë në gjendje të udhëtojnë** (për të fituar). **Pasi ata janë modestë e nuk lypin, ai, që nuk i njeh ata, kujton se janë pasanikë. I njeh ata në fizionominë e tyre. Ata nuk i mërzisin njerëzit duke lypur. E çdo gjë që shpenzoni prej të mirave, Perëndia i di ato.**" (Bekare, 273) Skajshmëria e dytë është braktisja e plotë e ibadetit, duke nxituar drejt pangopësisë dhe lakmisë dhe duke harruar Krijuesin, Allahun e Madhërishtëm.

Prandaj, çdo besimtar është i obligueshëm të kryejë ibadetet e domosdoshme, por edhe punët e domosdoshme, duke fituar ushqimin hallall si rezultat i punës vetjake. Punën duhet përshtatur fesë e jo fenë punës, sepse pasojat do të jenë të rënda. Prishja e këtij rendi kalon kryesisht nëpër tri shkallë të dobësimit të imanit. *Shkalla e parë* e dobësimit është prishja e barazpeshës ndërmjet ibadetit, punës dhe kohës kushtuar familjes. Njeriu i tillë punon shumë, synon t'i kalojë të gjithë konkurrentët, të bëhet i pari, por i tilli harron se po kalon kufijtë e normales, rrugës së mesme që e rekomandon Islami. Njerëzit e tillë falen, por mendjen e kanë te fitimi, Kur'anin e kanë në raft, por ai është për muze e jo për lexim, sepse ai nuk lexohet as formalisht e lëre edhe kuptimet e tij. *Shkalla e dytë* është kur afaristët e caktuar kryenë obligimet shpirtërore në punë, por gjithnjë duke nxituar e me hope, kohë pas kohe, për shkak të obligimeve të mëdha. *Shkalla e tretë* në rrugën e humbjes është vrasja e zemrës duke e harruar Allahun (xh.sh.). Nga shkaku i dinamikës së jetës, punës, të tillët harrojnë obligimet e larta, ato intelektuale e shpirtërore. Kjo ndodh edhe për shkak të shefave të tyre, të cilët nga punëtori kërkojnë maksimumin, duke mos i lënë hapësirë edhe për nevojat shpirtërore e intelektuale.

Ne harrojmë se kujtimi i Allahut është gjëja më e vlefshme për një besimtar. "...**E, të përmendurit e Allahut është më e madhja** (lutje)! - **E Allahu di çka punoni ju.**" (Ankebut, 45)

**"O besimtarë, mos t'ju habisin pasuria juaj dhe fëmijët tuaj nga të përmendurit e Allahut. E ata që bëjnë këtë, do të humbin."** (Munafikun, 9)

Mund të përfundojmë se rrethanat bashkëkohore janë një lloj makine, nga jashtë e maskuar, që përpinqet të nënshtrojë çdo gjë, kurse çdo gjë që i kundërvihet,

kjo makinë përpinqet ta zhdukë. Prandaj, kësaj makine i duhet kundërvënë me *xihad* të madh, në fryshtë e hadithit të njohur të Muhamedit (a.s.), se të keqes i duhet kundërvënë me dorë ose me gjuhë, ose të gjykoitet me zemër:

Nga Ebu Said El-Hudriu, (r.a.), transmetohet se ka thënë: E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, (a.s.), duke thënë: "Kush nga ju sheh një të keqe, le ta ndryshojë me dorë e, nëse nuk mundet ta bëjë këtë, atëherë me gjuhën e tij e, nëse nuk mundet ta bëje këtë, atëherë me zemrën e tij, porse ky është imani më i dobët." (Muslim)

## RAPORTI I SHËNDOSHË I NJERIUT ME ZOTIN

Njeriu është krijesa më e mirë, (Et-Tin, 4). Këtë dhuratë e ka nga Krijuesi. Për këtë shkak, njeriu nuk është pronar, por shfrytëzues dhe llogaridhëns. Nisur nga kjo pozitë, njeriu nuk ka të drejtë t'u kundërvihet ligjeve të Allahut (sunnet'ull-llah) ose të shprehë shpërfillje ndaj tyre. Mirëpo, kjo nuk duhet marrë në kuptimin fatalist të jetës. Në angazhimin e njeriut në këtë botë duhen pasur parasysh edhe tre faktorë: *nijeti* (vendosja), *duaja* (lutja) dhe *xuhdi* (përpjekja).

Çdo mendim dhe veprim i yni duhet të jetë në emër të Allahut dhe për dashuri të Tij e jo për mendjemadhësi, për interes material, për dashuri kalimtare, etj. Çdo *bismi'l-lah*, në fryshtë e tre faktorëve të sipërm, duhet të përcillet deri në realizim. Çdo nijet i gabueshëm na çon në rrugë të gabuar dhe në vend të ibadetit të pranueshëm do të korrim dënimin e Zotit.

Pas *nijetit* dhe *bismi'l-lahit* ne duhet t'i drejtohemë Zotit me sinqeritet dhe duke shfaqur nevojën për Të, për të treguar varësinë tonë për Të dhe nevojën për Të. Çdo mbështetje jona në shkencë, në vetyvet e aftësitet tona jashtë Zotit, është një gabim i rëndë.

Këtu edhe qëndron dallimi mes konceptit islam dhe atij materialist të punës, sepse sipas Islamit, parësor është sendërtimi i rezultatit shpirtëror (kënaqësisë së Zotit), kurse rezultati material është pasojë, përkatësisht dhuratë e Allahut për ne. Në anën tjetër, koncepti materialist i punës konsiston në prodhimin material gjithnjë në rritje. Pa këto parametra, puna është e kotë dhe nuk ka kuptim. Si mjet për rritje më efikase, ata bëjnë planifikime të shumta. Çdo dështim në planifikim shkakton dëshpërim dhe nervozizëm të paparë. Këtu




edhe qëndron dallimi mes besimtarit dhe jobesimtarit. Besimtarit punon, angazhohet dhe lutet te Krijuesi për sukses, kurse jobesimtarit këmbëngul në sukses, duke harruar se njeriu vetëm planifikon dhe nuk përcakton. Jobesimtarit me veprimet e veta gjithashtu gjendet para dy ekstreme: një, zemërimi, hidhërimi dhe revoltës pse gjërat nuk ndodhin siç do njeriu dhe dy, dëshpërimi me përcaktimin e Zotit, inferioriteti nga i cili buron humbja e shpresës dhe vullnetit për punë të mëtejme. Njeriu harron se kjo karakteristikë është nga djalli i mallkuar, i cili pakënaqësinë e tij ndaj planit absolut të Zotit e finalizoi me dëbim nga afërsia dhe mëshira e Zotit. Njeriu harron se ligjësitë e Zotit janë të vetmet absolute dhe se pakënaqësitë tona për dështime në jetë nuk janë arsyë për rebelim ndaj Tij dhe ambientit ku gjendemi. Muhammedi (a.s.), ka urdhëruar qartë: "Mos e shani kohën, se me të vërtetë Allahu është koha" (Sahih'ul-Buhari, Kitab'ul-Edeb, babu: La tesubb'ud-dehre, 5713).

## PËRFUNDIM

Besimtarit në përgjithësi dhe sidomos besimtarit mysliman, në periudhën e tranzicionit përballet me sfida të Jashtëzakonshme, në dukje demokratike, të pranueshme, joshëse e në fakt, shumë të dhembshme dhe me pasoja të rënda shpirtërore e shoqërore. Liria e besimit, liria e lëvizjes, ekonomia e tregut, janë vetëm disa nga sfidat e kësaj periudhe. Ato imponohen nga Perëndimi si vlera të padiskutueshme, ndaj të cilave duhet të nënshtron hemi dhe bindemi.

Mirëpo, besimtarit mysliman nuk pajtohet me vlerat që ofron Perëndimi. Përveç të tjerash, besimtarit mysliman dëshiron ta ketë para vetes njeriun komplet, e jo të pjesshëm, me mungesa shpirtërore e fizike. Vetëm si i plotë, njeriu mund t'u përgjigjet sfidave të jetës. Imani apo besimi është faktori i shpërfillur nga Perëndimi që për pasojë ka sjellur degjenerimin total të njeriut dhe shndërrimin e tij në një paçavure të përditshme. Besimtarit mysliman, i pajisur me iman (besim), vlereson vlerat perëndimore, ngarendjen drejt arritjes së pasurisë, por nuk aprovon njëanshmërinë gjatë fitimit dhe konsumimit, përkatësisht nuk aprovon dëbimin e shpirtëroritetit dhe lartësimin e materies. Njeriu është genie dykomponentëshe dhe vetëm si i tillë mund të arrijë rezultatet e plota.



# E kemi detyrë të jemi vëllezër!

Neslihan Nur Turk

Lavdëruar qoftë Allahu, ne jemi myslimanë dhe si të tillë nuk kemi të bëjmë aspak me ngatérresat!

Çdo person që thotë shehadetin është vëllai ynë i fesë!

Teksa bota gjendet brenda një kaosi të kotë dhe brengë-lënës, për shkak se njeriu është aq i dobët sa të dorëzohet përpara epsheve dhe zemërimit të tij, myslimanët janë të detyruar të shohin veten mirë në pasqyrë dhe të nisur nga qëllimi i shëndoshë të rrahin nën kurdhën e shekullit të lumturisë ndërgjegjen tonë.

Ne si myslimanë jemi të detyruar të gjemjë shërimin përgon tonë të fryrë dhe të stërfryrë që bie në kundërshtim me qëndrimin modest, por shumë hijerëndë të Qabesë, të mësohemit të themi, "ne" në vend që të themi vetëm "unë", si dhe të bëjmë garë me njëri-tjetrin se kush kryen më shumë vepratë mëra dhe të dobishme, duke u bërë në këtë mënyrë masë parandaluese nga të këqijat për njëri-tjetrin. Ne duhet të mirëpresim me dashuri të gjithë myslimanët ashtu sikurse mirëpret në prehërin e saj myslimanët nga e gjithë bota, xhamia e Profetit. Ne jemi të detyruar të bëhemit vëllezër me njëri-tjetrin mbi bazën ku diferencat nuk shkaktojnë frankcionime dhe imtësitë nuk janë më të rëndësishme se çështjet madhore.

Myslimanët për njëri-tjetrin janë si pjesët e lidhura

ngushtë me njëra-tjetren, falë të cilave qëndron në këmbë ndërtesa. (Buhari, Salat 88.) Meqë është kështu, dallimet mes neshjanë të lejuara, me kusht që të bëhen vetëm dhe vetëm për hir të Allahut dhe të janë të zhveshura nga çdo lloj tendencë abuzive egoistike. Ti duhet të mbështetësh vëllezërit e tu myslimanë që përpiken me gjithë shprt të shtohen punët e hajrit dhe këtë e bëjnë vetëm për hir të Allahut, edhe në qoftë se ti personalisht nuk ke ndonjë përfitim personal nga e gjithë kjo! Ti duhet t'i mbështetësh me lutjet tuaja të gjithë ata që sot përpiken për hir të Allahut, edhe në qoftë se në të kaluarën e tyre kanë bërë gabime, por janë penduar për to!

Askush nuk ka fuqi të bëjë përpara i vetëm! Në qoftë se punët do të mund të kryheshin nga një person i vetëm, as profetët nuk do të kishin pasur nevojë për ndihmës dhe bashkëvujtës në rrugën e tyre. Në qoftë se duke thënë vetëm "unë, unë" do të mund të kapërcehesin pengesat dhe do të fitoheshin zemrat, atëherë faraoni do të kishte genë njeriu më i mbarë i kësaj bote.

Në rast se hallkat e një zinxhiri nuk janë të kapura mirë me njëra-tjetren, atëherë do të mjaftonte një forcë e lehtë që ai zinxhir të këputet. Në qoftë se tullat nuk ngjiten me njëra-tjetren me një suva cilësore, muret do të shemben përpara një tronditjeje të vogël. Prandaj ne duhet të na

lidhin jo idealet kalimtare dhe të thjeshta të kësaj jete, por idealet e vërteta dhe të përhershme të jetës tjetër.

Si mund ta ruajë kopenë një qen i uritur dhe i dobët, që me të parë t'i hidhen tri apo pesë copë kocka përpara vjen në qejf dhe rri e kalon kohën vetëm duke lëpirë ato? Cila shoqëri ua ka parë hajrin njerëzve të babëzitur që u ka ikur mendja pas dashurisë për grumbullimin e pasurisë dhe nuk kanë shqetësim tjetër në këtë jetë, përvèç problemeve të kësaj jete? Cili post mund t'i lihet në dorë njeriut të ngratë që mund të mashtrohet me dhurata të thjeshta dhe e ka të hapur derën e tij ndaj ryshfetit dhe haramat?

Cilën kauzë mund të mbështesë personi i cili e konsideron marifet të vërrë kujën për shkak të probleme të vogla që përjeton në jetë, të cilat në sytë e tij janë fundi i kësaj jete? Çfarë peshe mund të mbajë mbi shpatulla personi i cili nuk e kupton dot se problemet në këtë jetë janë një begati në sajë të së cilës dalin në pah aftësitë e fshehura brenda fuqisë mendore të individit? Si mund të shpërndajë shpëtim personi që ka frikë të shkojë në derën e doktorit për të kuruar sëmundjen që e ka kapur? Si mund t'ua shpjegojë fenë islame të tjerëve personi smirëzi, i cili e konsideron prishjen e marrëdhënieve me të tjerët vendosmëri?

Që nga vëllazeria të pritet mbarësi, duhet që vëllezejtë të kenë shqetësimin që ta purifikojnë vetveten nga të gjitha cilësítë negative të egos. Vëllai në fe duhet ta mbysë egon e tij në rrugën e pëlqimit të Allahut, në mënyrë që shërbimi i tij ndaj njerëzve dhe kriesave të tjera të begatohet. Zemra e papastuar nga smira dhe urrejtja nuk mund të bëhet vëlla me një zemër tjetër. Shpirti që nuk ka marr hise nga dhembshuria dhe përmallimi, nuk e merr mundimin të lodhet për persona të tjerë.

Ne jemi të detyruar të bëhem si petalet e trëndafilit, që janë të kapur fort pas njëri-tjetrit. Ashtu si ato petale, ashtu edhe ne myslimanët duhet të kapemi fort pas rrënjëve të Kuranit dhe të traditës profetike. Për sa kohë që nuk dëshirojmë për vëllain tonë të fesë ato gjëra që duam dhe dëshirojmë për veten tonë, nuk do të konsiderohemi asnjëherë nga ana e Zotit si besimtarë të vërtetë. Prandaj duhet të mësojmë që të dëshirojmë edhe për vëllezejtë tanë të fesë çdo gjë të mirë materiale dhe shpirtërore që urojmë dhe dëshirojmë për veten tonë. (Buhari, Iman 7)

Muslimani është vëllai i myslimanit! Ai nuk i bën zullum atij dhe nuk e dorëzon atë tek armiku. Allahu ia mbulon nevojat atij mysliman që mundohet t'i mbulojë nevojat që ka vëllai i tij i fesë. Atij që i zgjidh një hall vëllait të tij mysliman, Allahu do t'i zgjidhë një nga hallet e tij në Ditën e Kiametit. Atij që mbulon një të metë të vëllait të tij mysliman, Allahu do t'i mbulojë një të metë të tijën në Ditën e Gjykimit. (Tirmidhi, Hudud, 3.) Prandaj ne duhet të bëhem vëllezejtë të fesë, jo duke qëmtuar të metat dhe gabimet e njëri-tjetrit, por duke ndihmuar njëri-tjetrin në përmirësimin e gabimeve, duke ia lehtësuar barrën e problemeve të jetës njëri-tjetrit dhe duke dashur me shpirt njëri-tjetrin!

As gishtat e dorës nuk janë të njëjtë me njëri-tjetrin, por të gjithë së bashku në varësi të situatës bëhen grusht, bëhen ngushëllim, riparojnë, bëjnë rrafsh me tokën. Megjithëse është e pamundur që në çdo moment vëllezejtë të janë bashkë me njëri-tjetrin, por me mend dhe me shpirt ata janë të detyruar të janë bashkë siç janë mishë me thoin. Besimtarët janë vëllezezë. Prandaj ne kemi për detyrë të gjejmë të përbashkëtët në mesin e vëllezezëve tanë dhe t'i pajtojmë ata me njëri-tjetrin. (Enfal, 1)

Të vrasësh pa të drejtë është shenjë e kufrit për myslimanët. Ne jemi të detyruar t'i vëmë veshin paralajmërit që na ka bërë profeti Muhamed, shpëtimtët botëve, kur ka thënë: "Mos u bëni pasi të vdes unë si qafirët që vrasin njëri-tjetrin." (Buhari, IIm 43.) Përballë përcarjes dhe intrigave myslimanët duhet të mbajnë qëndrim të shëndoshë, duke u lidhur fort me njëri-tjetrin me anë të lidhjes së besimit!

Muslimani është vëllai i myslimanit. Ai nuk i bën pëdrejtësi atij dhe nuk e nëpërkëmb, nuk ia pret ndihmën dhe nuk e nënveftëson atë. Nënveftësimi i vëllait në fe konsiderohet një vepër e keqe. Muslimani e ka haram jetën, pasurinë dhe nderin e myslimanit. (Muslim, Birr, 32.) Atëherë vëllai im, ne duhet të mbërrimë tek Allahu si vëllezërt që e duam njëri-tjetrin, jo si myslimanë që kemi pasur grindje dhe konflikte mes nesh.

Nuk duhet harruar se vëllai yt vetullngrysur është më i mirë për ty sesa armiku yt buzagaz. Muslimani mund të mbajë qëndrim ndaj vëllait të tij për të mirën e të dy botëve dhe për hir të Allahut. Vëllai që bën të shpenzosh për hallet e tij është më i mirë se armiku yt që të mashton me të mirat e kësaj jete, sepse bota nuk është një gjë me vlerë përpëra Allahut.

Të të pëlqejë apo jo! Çdo person që thotë shehadetin dhe shpall publikisht se është mysliman, jemi të detyruar ta duam! Të të vijnë mirë apo jo! Ne jemi të detyruar të konsiderojmë vëlla çdo person që dëshmon se Allahu është një dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguar i Tij!

Ne kemi për detyrë të mbështesim, ta mbrojmë dhe t'i bëhem krah çdo vëllai mysliman, edhe në qoftë se ai ka karakter të ndryshëm, frekuencë tjetër, stil jete jo të ngashëm me tonin. Nuk mund të bësh përpëra duke nxjerrë bërrylat dhe duke vënë stërkëmbësa! Në qoftë se je më të vërtetë mysliman, atëherë do të bëhesht streh për të pastrehin, udhërryfyes përrugaçin dhe krah ndihme për të pambrojturin. Në qoftë se dëshiron me zemër të hysh në xhenet, duhet që në zemrën tënde të lësh vend edhe për vëllain tënd.

Asnjë gjë në këtë jetë nuk është e jona dhe nuk e dimë se ku është e mira për ne! Ne jemi amanetqarët e gjithçkaje në këtë jetë dhe në pritje të orës së mbarë! Lavdëruar qoftë Allahu që jemi myslimanë dhe nuk kemi të bëjmë me intrigat! Çdo person që thotë shehadetin, është vëllai ynë në fe!



# RRËFIME NGA JETA E PROFETIT IBRAHIM

Kur Allahu i Lartësuar e shpalli profetin Ibrahim, alejhissem, si mikun e Tij më të afërt, melekët mbetën të pakënaqur nga ky vendim dhe i thanë:

- Zoti ynë! Si mund ta shpallësh Ibrahimin mikun Tënd? Ai është njeri dhe si çdo njeri ka kokëçarje për jetesën, fëmijët dhe familjen e tij. Allahu i Lartësuar u përgjigj:

- Unë nuk i vlerësoj robërit e Mi në varësi të pamjes së tyre fizike apo pasurisë që kanë, por në varësi të zemrës dhe punëve që bëjnë. Miku Im, Ibrahimi nuk do askënd tjetër përvëç meje dhe, në qoftë se dyshoni përkëtë gjë, atëherë shkoni dhe vëreni në provë.

Atëherë engjëlli Xhebrail -alejhisselam- mori pamjen e njeriut dhe shkoi tek profeti Ibrahim. Ibrahimi (a.s.), ishte duke kullotur bagëtitë e tij. Ai mbante dymbëdhjetë qen që i ruanin kopenë dhe secilit prej tyre i kishte vënë nga një qafore prej ari për të treguar se ari nuk është gjithçka. Engjëlli Xhebrail, alejhisselam, i dha selam Ibrahimit, alejhisselam, dhe e pyeti:

- O Ibrahim! Të kujt janë këto kafshë?

- Ato janë të Allahut të Lartmadhëruar dhe m'i ka dhënë mua amanet në këtë botë. - u përgjigji profeti Ibrahim.

- A do të ma shitje mua një? - e pyeti Xhebraili.

- Përmende një herë të vetme Allahun dhe do të marrësh një të tretën e tufës. - iu përgjigji Ibrahimi.

سُبْحَانَ رَبِّنَا وَرَبِّ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحِ

- tha Xhebraili.

Atëherë profeti Ibrahim i dhuroi atij një të tretën e tufës. Pastaj i tha:

- Po e përmende edhe një herë Allahun, do të të jap edhe një të tretën tjetër të tufës. Në qoftë se e përm-

mend për herë të tretë, atëherë do të jap të gjithë kopjenë time së bashku me qentë. Po e përmende për herë të katërt Allahun, atëherë unë do të bëhem skllavi yt.

Atëherë Allahu (xh.sh.), e pyeti engjëllin Xhebrail:

- O Xhebrail! Çfarë mendimi ke për mikun tim Ibrahimim?

- Sa mik të mrekullueshëm që paske! - iu përgjigj engjëlli Xhebrail, alejhisselam.

Nga ana tjetër, profeti Ibrahim (a.s.), u tha barinje të tij:

- O barinjtë e mi! Merrini kafshët dhe shpjerani në shtëpi këtij njeriu. Atëherë Xhebraili (a.s.), i tha:

- Unë nuk kam nevojë për kafshët tuaja. Unë jam Xhebraili.

- O Xhebrail! - iu përgjigj profeti Ibrahim. Unë jam miku i Allahut!

Nga ana tjetër, Zoti e urdhëroi profetin Ibrahim të shiste kopenë dhe me paratë që do të fitonte nga shitja të blinte toka që do t'i dhuronë për bamirësi. Të gjitha shpenzimet që bëhen sot për varrin e profetit Ibrahim mbulohen nga këto prona. (Ruhu'l-Bejan Tefsiri, 2/486)

Në një hadith të raportuar nga i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, thuhet:

"Mëshira është shkulur nga zemra e gjynahqarit."

Në një hadith që raportohet nga Abdullah ibn Amr ibn As, radijallahu anh, mësojmë se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

"Allahu mëshiron ata që janë të mëshirshëm me të tjerët. Mëshironi ata që janë në tokë, në mënyrë që t'u mëshirojnë juve ata që janë në qiell!"



Hadithe nga Profeti Muhamed, krijesa më e respektuar e gjithësisë dhe lavdi i ekzistencës:

- Zoti më ka urdhëruar që të jem modest!
- Në qoftë se besimtari edukohet me ndjenjën e modestisë për shkak të frikës së Allahut, Ai ka për t'ia rritur përherë e më shumë famën.
- Nuk mund të jesh besimtar i vërtetë, përderisa nuk di të jesh besimtar modest.
- Shoqërimi me të varfërit është shenjë e modestisë.
- A t'ju tregoj se kush ka për të hyrë në xhenet? Çdo besimtar i dobët dhe modest, i cili për çdo përbetim në emër të Allahut, do të marrë begati prej Tij. A t'ju tregoj se kush ka për të hyrë në xhehenem? Çdo person që i bën të tjerët të vuajnë, i cili është mendjemadh dhe i paedukatë.
- Allahu e ka pastruar nga çdo mëkat një besimtar të cilin e ka drejtuar në rrugën e drejtë, ia ka hijeshuar pamjen e jashtme, e ka ngritur atë në atë shkallë që nuk e ka pasur për qëllim dhe megjithatë ai tregohet modest.
- Katër gjëra u dhuron Allahu robërve që Ai i do: 1. I mëson të mos flasin vend e pa vend dhe fjalë të mbrapshta, 2. i mëson të mbështeten vetëm tek Ai, 3. i falë modesti, 4. i mëson t'u shhangen veprimeve të këqija.
- Modestia nuk i shton asgjë besimtarit, përvceçe ngritjen e nivelit shpirtëror, prandaj bëhuni modestë, në mënyrë që Allahu t'jua rrisë shkallën tuaj shpirtërore.
- Po kështu, një ditë Profeti iu drejtua sahabëve të tij duke i pyetur:
  - A e shoh unë gabim apo tek ju nuk e shoh halavet-in e adhurimeve?
  - Cfarë është halavet-i i adhurimeve? - e pyetën sa habët.
  - Ajo është modestia, - u përgjigji Profeti.
- Po kështu, profeti Muhamed, salallahu alejhi ve sellem, ka thënë:
  - Allahu i Lartësuar më ka mësuar të jem modest.

# MODESTIA

Askush të mos tregohet prepotent ndaj një besimtarit jetër.

- Kush dëshiron të arrijë perfeksionimin e besimit të tij, duhet të tregohet modest dhe të japë sadaka edhe kur është i varfër. Këto dy shprehi e ngrenë njeriu në shkallën më superiore.

Vejsel Karani, kudise sirruhu, ka thënë:

- Kërkova gradën më të lartë dhe e gjeta atë tek modestia.

Ahmed Antaki, kudise sirruhu, ka thënë:

- Modestia e vërtetë është ajo që e zhduk mendjemadhësinë që mund të kesh dhe e asgjëson përfare.

Xhunejd Bagdadi, kudise sirruhu, ka thënë:

- Modestia do të thotë të mos tregohesh mendjemadhëndaj krijesave të dy botëve dhe të kërkosh të gjendesh vetëm në shoqërinë e Zotit.

Ebu Bekr Verrak, kudise sirruhu, ka thënë:

- Dija e sigurt fetare (jekin) e bën zemrën modeste dhe të përkryer.

Ibn Semak, kudise sirruhu, ka thënë:

- Modestia më fisnikë është ta konsiderosh vetveten të barabartë me të gjithë njerëzit e tjerë.

Abdullah ibn Mubarek, kudise sirruhu, ka thënë:

- Modestia do të thotë të sillesh prepotent me mendjemadhin dhe modest ndaj njeriut modest.

- Njeriu nuk do të bëhet kurrë modest, për sa kohë që interesohet vetëm për nevojat e egos së tij.

Jusuf Esbat, kudise sirruhu, ka thënë:

- Grada e fundit në modesti është të konsiderosh më të mirë se veten çdo person që do të takosh rrugës.



# Anatomia e Bijve të Israilit

Ilir Hoxha

Hebrenjtë janë pasardhës të Pejgamberit të Allahut, Jakubit (a.s.), i cili ishte i biri i Pejgamberit Is'hak (a.s.) dhe nipi i Pejgamberit Ibrahim (a.s.). Jakubi (a.s.), njihet edhe me emrin Israil, që sipas disa mendimeve do të thotë "Abdullah / Rob i Allahut". Prandaj dhe pasardhësit e tij u quajtën Bijtë e Israilit, për të cilët Kurani Fisnik flet me detaje, duke i përmendur ata me emër në 41 ajete të ndryshme.

Për të kuptuar më mirë se kush është ky popull, të cilin historia njerëzore e përmend herë për vuajtje, herë për dredhi, herë për ambicie të shthurura dhe herë për mizori, siç edhe po i dëshmojmë që prej 70 vjetësh në rajonin e Lindjes së Mesme, mjafton t'i hedhim një sy profitit psikologjik, sociologjik e historik që na jep Allahu i Madhëruar në Kuranin Fisnik:

"O bijtë e Israilit, kujtoni të mirat që ju kam falur! Përbushni premtimin që Më keni dhënë, që edhe Unë të përbush premtimin që ju kam bërë (për t'ju futur në Xhenet). Vetëm prej Meje duhet të frikësoheni. Besoni në atë (Kuran) që kam zbritur si vërtetues të Shkrimeve tuaja e mos u bëni mohuesit e parë të tij! Mos i këmbeni shpalljet e Mia me një vlerë të vogël dhe ruhuni vetëm prej Meje!"

**Mos e përzieni të vërtetën me të pavërtetën dhe të**

**vërtetën mos e fshihni me vetëdije.** Faleni namazin, jepeni zekatin dhe përkuluni në ruku bashkë me ata që përkulen (në namaz). **Vallë, a i urdhëroni njerëzit që të bëjnë të mira e veten po e harroni, ju që lexoni Shkrimet?** A nuk arsyeton? Kërkoni ndihmën e Allahut me durim e me namaz! Kjo është një mend e vështirë, përvèçse përtë devotshmit, që janë të bindur se do të takojnë Zotin e tyre dhe se do të kthehen tek Ai.

O bijtë e Israilit! Kujtoni të mirat që ju kam dhënë dhe që ju kam ngritur mbi njerëzit e tjerë (të asaj kohe). Friksionji Ditës kur askush nuk do të mund të bëjë asgjë për askënd dhe kur prej askujt nuk do të pranohet as ndërmjetësim, as shpërblësë e as që do të ndihmoni. Kujtoni se si ju shpëtuam nga populli i Faraonit, i cili ju shtypte mizorish: jua therte djemtë e juu linte të gjalla femrat. Kjo ka qenë një sprovë e madhe për ju - nga Zoti juaj.

Kujtoni se si e çamë detin e ju shpëtuam, ndërsa në praninë tuaj i fundosëm njerëzit e Faraonit. Kujtoni kur i caktuam Musait dyzet net (për takimin me të), e pastaj **ju adhuruat viçin, duke vepruar si keqbëres!** Pastaj Ne ju falëm, që të bëheni mirënjoës.

Kujtoni kur Musait i dhamë Librin dhe Dalluesin, që të udhëzoheni (në rrugën e drejtë) dhe, kur ai i tha popullit

të vet: "O populli im, ju vetëm vetes i bëtë keq, kur e adhuruat viçin si zot! Prandaj kthehuni të penduar te Krijuesi juaj dhe vritni njëri-tjetrin! Kjo është më mirë për ju në sy të Krijuesit tuaj. Aiju fali gabimin, sepse Ai i pranon shumë pendimet dhe është Mëshirëploti".

**Kujtoni kur i thatë Musait: "O Musa! Ne nuk do të të besojmë ty, derisa të shohim Allahun haptazi!". Atëherë një rrufe ju goditi, ndërsa ishit duke parë.**

Pas vdekjes suaj, Ne ju ringjallëm, që të bëheni falënderues. Pastaj bëmë që retë t'ju bënин hije dhe ju zbritëm manën dhe thëllëza, duke thënë: "Hani nga ushqimet e mira, që ju kemi dhënë!" (Ata nuk ishin mirënjohnës dhe kështu) nuk na bënë keq Neve, por i bënë keq vetes.

Kujtoni kur thamë: "Hyni në këtë qytet dhe hani ç'të doni dhe sa të dëshironi, por, duke hyrë në qytet, përuluni në sexhde dhe thoni: "Falna!" që Ne t'ju falim gabimet. Atyre që bëjnë vepra të mira, Ne ua shtojmë shpërblimin" Por keqbërësit e ndryshuan fjalen që iu tha me një fjalë tjetër, prandaj Ne u sollëm atyre që bënë (këtë) padrejtësi një dënim nga qielli për mosbindjen e tyre.

Kur Musai kërkoi ujë për pullin e tij, Ne i thamë: "Bjeri gurit me shkopin tënd!" Atëherë, nga ai shpërthyen dy mbëdhjetë burime, dhe çdo fis e dinte burimin e vet. Ne thamë: "Hani e pini prej negative të Allahut dhe mos bëni të këqija e mbrapshti në Tokë!"

Kujtoni kur i thatë: "O Musa! Ne nuk mund të kënaqemi vetëm me një lloj ushqimi, prandaj lutju për ne Zotit tënd të na dhurojë nga ato që jep toka: perime, tranguj, thjerrëza, qepë dhe hudhra!" Ai ju tha: "Vërtet doni të ndërroni atë që është më e mirë me atë që është më e dobët? Shkonit në qytet, atje do të gjeni atë që kërkoni!" Ata i kaploj poshtërimi dhe përulja dhe merituan zemërimin e Allahut. **Kjo, sepse ata i mohonin shpalljet e Allahut dhe i vrissin të dërguarit pa asnje të drejtë. Kjo, sepse ata kundërshtonin dhe kalonin çdo kufi...**

...Kujtoni (o hebrejn) kur morëm besën tuaj dhe ngritëm mbi ju malin Tur, duke thënë: "Merreni seriozisht atë që ju dhamë dhe mbanit në mendje rregullat e saj, në mënyrë që të ruheni nga gjynahet!" Por **më pas, ju i kthyet shpinën (besëlidhjes) dhe, sikur të mos ishte mësia e Allahut ndaj jush dhe mëshira e Tij, do të ishit të humbur.** Sigurisht që ju keni dëgjuar për **ata prej jush që shkelën Sabatin<sup>1</sup>** dhe të cilëve Ne

u thamë: "Bëhuni majmunë të përcmuar e të urryer!" Këtë dënim e bëmë paralajmërim për bashkëkohësitet dhe për brezat e tyre pasardhës, si dhe këshillë për ata që i frikësohen Allahut.

Kujto kur Musai i tha kombit të vet: "Allahu ju urdhëron të thermi një lopë!" Ata thanë: "A do të tallesh me ne?" - "Zoti më ruajtë!" - tha Musai - "të bëhem unë nga të paditurit!"

Ata thanë: "Lutju Zotit tënd, që të na shpjegojë si duhet të jetë ajo!" Musai tha: "Ajo të jetë një lopë as plakë, as e re, por e mesme; pra, bëni atë që ju është urdhëruar!"

Ata thanë: "Lutju Zotit tënd që të na shpjegojë çfarë ngjyre duhet të ketë ajo!" Musai tha: "Ai thotë se ajo duhet të jetë lopë me ngjyrë të verdhë të ndezur, të cilin e pëlqejnë shikuesit".

Ata thanë: "Lutju Zotit tënd, që të na shpjegojë çfarë lloji të jetë, sepse lopët të gjitha na duken njësoj e ne, në dashtë Zoti, do të udhëzoimi në rrugën e drejtë".

Musai tha: "Ai thotë se lopas' duhet të jetë e lodhur nga lërimi apo nga ujita e tokës, por të jetë e shëndoshë dhe pa asnje të metë". Ata thanë: "Tani na the të vërtetë". Kështu, ata e therën lopën, por desh e lanë pa fliuar. Dhe, **pasi vratë një njeri e u grindët me njëri-tjetrin në lidhje me të, Allahu e nxori në shesh atë që fshihnit ju.**

Ne ju thamë: "Prekeni të vrarin me një copë të lopës së fliuar!" Dhe kështu, Allahu do t'i ngjallë të vdekurit dhe do t'ju tregojë mrekullitë e veta, që ju të kuptoni.

Por, pas kësaj, **zemrat tuaja u forcuan e u bënë si guri, madje edhe më të forta.** Në të vërtetë, ka gurë nga të cilët burojnë lumenj, ka të atillë që çahen e nga të cilët rrjedh uji, madje ka edhe syresh që rrëzohen nga frika e Allahut. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj veprimeve tuaja.

Vërtet shpresoni ju (besimtarë) se ata (hebrejn) do t'ju besoninju, ndërkohë që **disa prej tyre i dëgjonin fjalët e Allahut dhe, pasi i kuptionin, me vetëdije i shtrëmbëronin ato?** Kur takohen me besimtarët, ata thonë: "Ne besojmë", e kur ngelin vetëm me njëri-tjetrin, ata thonë: "A u tregoni atyre, atë që ua ka shpallur Allahu (në Teurat), për ta përdorur si argument kundër jush te Zoti juaj? A nuk po mendoni?" A nuk e dinë ata se Allahu di çfarë fshehin dhe çfarë shpallin?

1. - Sabati është dita e shtunë, gjatë së cilës Allahu ua ndaloj hebrejnje

të peshkonin, si sprovë dhe ndëshkim për gjynahet e tyre.



Disa prej atyre janë analfabetë, nuk e njohin Librin, përveç disa trillimeve dhe flasin vetëm me hamendje. Mjerë ata që me duart e tyre **shkruajnë Librin, e pastaj thonë: "Kjo është prej Allahut"** që për këtë të kenë ndonjë dobi të vogël (materiale). Mjerë ata për çfarë kanë shkruar me duart e tyre dhe mjerë ata për çfarë kanë fituar!

**Ata thonë: "Zjarri do të na prekë vetëm ca ditë të numëruara".** Thuaju (o Muhamed): "A keni marrë për këtë ndonjë zotim prej Allahut, kështu që Ai nuk do ta shkelë kurrë zotimin e vet (dhe do t'ju dënojë pak) apo po shpifni kundër Allahut gjëra që nuk i dini?"...

...Kujtoni kur Ne morëm besën tuaj, o bijtë e Israilit, se do të adhuroni vetëm Allahun, do të silleni mirë me prindërit, të afërmis, jetimët dhe të varfrit, do t'u thoni fjalë të mira njerëzve, do të falni namazin e do të jepni zekatin. Mirëpo, më pas, **ju ia kthyet shpinën** (besëlidhjes), përveç një pakice prej jush, duke iu **shmangur**.

Kujtoni kur nga ju morëm besën që të mos derdhni gjakun e njëri-tjetrit dhe që të mos e déboni njëri-tjetrin nga banesat tuaja! Ju e pranuat këtë dhe dolët dëshmitarë. Mirëpo ja tek **jeni, duke vrarë farefisin tuaj, duke i dëbuar disa syresh nga shtëpitë e veta dhe duke ndihmuar njëri-tjetrin kundër tyre, fajësish dhe armiqësisht...**

...Mos vallë, **një pjesë të Librit** (Teuratit) **e besoni, kurse pjesën tjetër e mohoni?** Cilido prej jush që vepron kështu, do të ndëshkohet me poshtërim në këtë jetë, ndërsa në Ditën e Kiametit do të dërgohet në dënimin më të ashpër. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj veprimeve tuaja. Këta janë ata që jetën e kësaj bote e kanë blerë me jetën e ardhshme. Atyre nuk do t'u lehtësohet dënim i dëshmi dhe askush nuk do t'u vijë në ndihmë.

Ne i dhamë Musait Librin dhe pas tij çuam të dërguarit njërin pas tjetrit. Ne i dhamë Isait, të birit të Merjemes, mrekulli të qarta dhe e përforcuam atë me Shpirtin e Shenjtë (Xhebrailin a.s.). **Sa herë që ndonjë i dërguar ju sillte atë që nuk ju pëlgente, ju kapariseshit, prandaj disa i quajtët gënjeshtarë e disa i vratë.**

**Ata thonë: "Zemrat tona janë të vulosura".** Jo, s'është ashtu, por ata i ka mallkuar Allahu për shkak të mohimit të tyre, prandaj shumë pak prej tyre besojnë.

**Dhe, kur një Libër që vërtetonte Shkrimet e tyre, u erdhi atyre nga Allahu, ndonëse përparrë luteshin për ndihmë kundër jobesimtarëve, pra, kur u erdhi ajo që e dinin se është e vërtetë, ata e mohuan atë!** **Prandaj mallkimi i Allahut qoftë mbi mohuesit!**

**Ata e shitën veten keq, kur nuk besuan në atë që shpalli Allahu, nga zilia se Allahu ia zbret shpalljen kujt të dëshirojë nga robërit e Vet.** Dhe kështu tërhoqën mbi vete zemërim përbimi zemërim! Sigurisht që mohuesit i pret një dënim poshtëruar. **Kur atyre u thuhet: "Besoni në atë që ka shpallur Allahu!"** - ata përgjigjen: **"Ne besojmë në atë që na është shpallur neve", duke mos besuar në atë që është zbritur më pas, ndonëse ajo është e Vërteta që pohon Shkrimet e tyre.** **Thuaju atyre:** **"Nëse ishit besimtarë, përsë i vratë profetët e Allahut, atëherë kur ju erdhën?"**

Musai ju solli shenja të qarta, por gjatë mungesës së tij, ju adhuruat viçin si zot, prandaj u bëtë fajtorë të mëdhenj. Kur morëm besën tuaj dhe ngritëm mbi ju malin e Turit, thamë: "Merreni seriozisht atë që ju kemi dhënë dhe dëgjoni!" **Ju thatë: "Ne dëgjuam, por kundërshtojmë!"** Për shkak të mohimit, atyre u ishte rrënjosur në zemra dashuria (dhe adhurimi) për viçin. Thuaju: "Nëse jeni vërtet besimtarë, sa gjë të keqe po ju urdhëroka besimi juaj!"



Thuaju: "Nëse Shtëpia e jetës së përtejme (Xheneti) tek Allahu është vetëm për ju e jo për njerëzit e tjerë, atëherë kërkoni vdekjen, nëse ajo që thoni është e vërtetë". Por ata kurresi nuk e dëshirojnë vdekjen për shkak të të këqijave që kanë bërë! Allahu i njeh mirë keqbërësit. Dhe vërtet, do t'i gjesh ata më lakkues për të jetuar sesa njerëzit e tjerë, madje, edhe se paganët. Secili nga ata dëshiron të jetojë njëmijë vjet; por edhe nëse jeton aq, nuk do të mund t'i ikë dënimit! Allahu i sheh punët e tyre të këqija..."

...Hebrenjtë thonë: "Të krishterët nuk kanë kurrfarë udhërrëfimi ku të mbështeten!" Edhe të krishterët thonë: "Hebrenjtë nuk kanë kurrfarë udhërrëfimi ku të mbështeten!" Ndërkohë, të dyja palët lexojnë të njëjtin Libër. Po kështu, edhe ata që nuk dinë, thonë të njëjtat fjalë. Allahu do t'i gjykojë kundërshtitë e tyre në Ditën e Kiametit...

...Kur Allahu e provoi Ibrahimin me disa urdhërime, të cilat ai i plotësoi, Allahu i tha: "Unë do të të bëj ty imam (prijës) të njerëzve!" "Po pasardhësit e mi?" - pyeti ai. Allahu tha: "Premtimi lm nuk i përfshin të padrejtët." (Bekare ajetet midis 40 dhe 124)

"Prandaj Ne i urdhëruam bijtë e Israilit se kush vret ndokënd, që s'ka vrarë njeri ose që nuk ka bërë çrregullime në Tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit. Dhe, nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve. Të dërguarit tanë u sollën shenja të qarta, por shumë nga ata, edhe pas kësaj, i kaluan tërë kufijtë me të këqija në Tokë." (Maide, 32)

"Ata Israilitë që ishin mohues, u mallkuan me gjuhën e Dautit dhe të Isait, të birit të Merjemes, për shkak se kundërshtonin, shkelnin çdo kufi dhe nuk e ndalonin njëri-tjetrin të bënин vepra të këqija. Eh, sa të shëmtuara ishin veprat që bënин ata!" (Maide, 78-79)

"Kur ata ngulmuani me mendjemadhësi të bënин atë që u ishte ndaluar, Ne u thamë: "Bëhuni majmunë të përbuzur!" Pastaj Zoti yt shpalli se do t'u dërgonte atyre të tjerë që do t'i mundonin, në mënyrën më të keqe, deri në Ditën e Kiametit. Me të vërtetë, Zoti yt dënon shpejt, por Ai është edhe Falës e Mëshirëplotë. Dhe **Ne i shpërndamë ata në Tokë grupe-grupe. Disa prej tyre ishin të mirë e disa jo.** Ne i vumë në provë ata me mirësi dhe fatkeqësi, me qëllim që të ktheheteshin (në rrugë të drejtë). **Pas tyre erdhi një brezni e cila e trashëgoi Librin** (Teuratin), **por duke marrë gjërat e pavlefshme të kësaj bote dhe duke thënë: "Do të na falet çdo gjë!"** (Araf, 166-169)

"**Ne u shpallëm solemnisht në Libër bijve të Israilit: Ju do të bëni dy herë ngatërresa në tokë dhe do të tregoni mendjemadhësi të tepërt!**" (Isra, 4)

"Kujto kur Isai, i biri i Merjemes, tha: 'O bijtë e Israilit, unë jam i dërguari i Allahut tek ju, për t'ju vërtetuar Teuratin e shpallur para meje dhe për t'ju sjellë lajmin e gjëzueshmë për një të dërguar, emri i të cilit është Ahmed, që do të vijë pas meje.' Por, **kur ai u solli atyre shenja të qarta, ata thanë: 'Kjo është magji e hapur! Kush është më keqbërës se ai që shpif gjenjeshtra kundër Allahut, ndërkohë që i bëhet thirrje për t'u nënshtuar Atij? Allahu nuk i udhëzon keqbërësit. **Ata dëshirojnë të fikin dritën e Allahut me gojën e tyre,** por Allahu e përsos dritën e Vet, edhe nëse (këtë gjë) e urrejnjë jobesimtarët."** (Saff, 6-8)

"Ne u dhamë bijve të Israilit Librin, pushtetin dhe Profecinë. Ne i begatuam ata me gjëra të mira dhe i ngritëm mbi të gjithë popujt e tjerë (të asaj kohe). Gjithashtu, Ne u dhamë udhëzime të qarta mbi besimin, por ata u përçanë, atëherë kur u erdhi dituria, pasi patën smirë në mes tyre. Zoti yt, me siguri, do t'i gjykojë (ata) në Ditën e Kiametit për kundërshtitë që patën." (Xhathije, 16-17)



# Bëhu pjesëtar i ymetit të Muhemedit!

Rabia Christine Brodbeck

Mbaroi edhe muaji i Ramazanit dhe filloj periudha njëmbëdhjetë mujore e agjérimit të shpirtit. Të bëjmë kujdes mos ta prishim atë! Mbaroi edhe muaji i bekuar i Ramazanit. A u përsosëm si njerëz? A arritëm të bashkohemi edhe më shumë si ymet? Nuk mund të formojmë ymetin tonë, në qoftë se nuk jemi përsosur si njerëz. A kemi arritur ta braktisim individualizmin tonë dhe të përzihemi brenda enës së ymetit të Muhemedit? A arritëm të bëhem i një familje, një trup i vetëm dhe vëlla ose motër me të gjithë njerëzimin? A u bëmë vëllezër me të gjithë ata që janë pasuesit e Personalitetit të dërguar si mëshirë për gjithësinë? A e kemi falënderuar sa duhet krijuesin tonë që na ka mundësuar të jemi pjesë e ymetit të profetit Muhamed, që është edhe begatia më e madhe e kësaj jete? A arriti agjérimi ta rrisë ndjeshmërinë tonë ndaj njerëzve të tjerë? A është rritur dashuria mes nesh? A kemi arritur të shkëmbejmë mëshirë dhe përkushtim me anëtarët e tjerë të bashkësisë islamë?

Mbaroi muaji i bekuar i Ramazanit dhe po hyjmë në muajin e Haxhit. A nuk është muaji i haxhit muaji i ymetit? A nuk mblidhen miliona besimtarë në Arafat?

Nuk mund të diferencohen nga njëri-tjetri për nga rëndësia muaji i Ramazanit me muajin e Haxhit! Haxhi është takimi më i madh i njerëzve dhe nuk ka takim më superior sesa ai! Ramazani i bekuar dhe muaji i Haxhit realizojnë fuqinë unifikuese më madhështore të myslimanëve dhe ekspozojnë një dashuri universale. Në muajin e Haxhit dhe të Ramazanit në gjithë botën përhapet begatia dhe mëshira e Mëshirës së Botëve. Një ndër bazat e Haxhit është formimi i vetëdijes tek haxhilerët se ata të gjithë janë një bashkësi e vetme.

Detyra e Haxhit është përjetimi i enigmës së unitetit të vëllazërisë së vërtetë. Thelbi i Haxhit është shndërrimi i haxhilerëve në një frysë, një familje, një bashkësi dhe një ymet të vetëm. Braktisja e kësaj bote dhe përfshirja në atmosferën e jetës tjetër, suprimimi i të gjithë statuseve sociale që kanë njerëzit, popujt dhe shoqëritë dhe formimi i një dashurie gjithpërfshirëse.

Ne duhet të shohim se çfarë kemi arritur ne si ymet pas muajve të Ramazanit dhe të Haxhit, veçanërisht në këto ditë. Para së gjithash në qoftë se arrijmë që t'i konceptojmë këta muaj si muajt e perceptimit kjo do të ishte arritura më e madhe për shkak të situatës së frikshme të tmerrit, dhunës dhe shmangies që kanë pësuar të gjitha situatat tona politike si rezultat i privimit në ditët e sotme ngandjenjat e ymetit, dashurisë dhe unifikimit. Kështu në ajetin e Kur'anit thuhet: **"Jujeni populli më i mirë, i dalë për njerëzimin."** (Al'Imran, 110) Profeti ka thënë: "Besimtarët njegojnë me pjesët e një trupi për sa i përket dashurisë, dhembshurisë dhe përkujdesjes për njëri-tjetrin. Në qoftë se sëmuret një organ të gjitha organet e tjera të trupit do ta ndjejnë këtë gjë." Përse myslimanët sot janë kaq shumë të përcarë, madje ka raste kur janë bërë armiq me njëri-tjetrin? Përse lejojmë që në mesin tonë të zënë vend fërkimet, lufta, konflikti dhe dhuna? Përse ekzistojnë kaq shumë diferençime mes nesh? Pra ne jemi bërë të pandjeshëm për njëri-tjetrin! Kjo është fatkeqësia jonë, sepse nga zemrat tona janë zhdukur ndjenjat humane! Nuk është e mundur të ndihen dhimbjet e besimtarëve të tjerë, në qoftë se ne nuk bëhem i një trup, një familje dhe vëllezër me njëri-tjetrin!

Në qoftë se stili i jetës sonë nuk arrin nivelin "tu bëfsha kurban, o i Dërguari i Allahut!", atëherë ne nuk



jetojmë sipas vlerave, thelbit dhe frysës së fesë islam, pra nuk jemi bërë ymeti i Muhamedit. Allahu i Lartësuar thotë në Kur'an: "**I Dërguari është më i afërt për besimtarët.**" (Ahzab, 6) Imani ynë nuk ka përfundon me perfekcionuar, përderisa ne nuk e duam Profetin më shumë se veten tonë. Vetëm kur të heqim dorë nga egoja jonë do të nisë mëshira e Allahut të zbrësë mbi trupat tanë. Pra ne duhet të bëhem i pjesëtarë të ymetit Muhamed! A nuk e kemi ne përditës që të përfaqjojmë dhe ta duam atë? Ai është kreun i ymetit! Në një hadith i Dërguari i Allahut ka thënë: "Tek Allahu nuk ka duamë të dashur që mund t'i bëj Atij njeriu sesa duaja: 'O Zot, mëshiroje të gjithë ymetin e Muhamedit!' Profetit iu shpall Kurani! Profeti përfjetoi Miraxhin! Ai është margaritari i të gjitha kriesave! Atëherë, kur ne të humbim ndjeshmérinë dhe ndërgjegjësimin tonë si pjesëtarë të umetit, kemi humbur shumë gjëra edhe nga feja e monoteizmit!

Çfarë po ndodh me ymetin mysliman? Çfarë ka ndodhur që jemi bërë armiq me njëri-tjetrin, luftojmë me njëri-tjetrin, vrasim njëri-tjetrin, bombardojmë xhamitë dhe kishat? Përse përfjetojmë kaq shumë dhimbje, padrejtësi, vuajtje dhe pushtime? Përse përfjetojmë ura dhe mjerim? Shtetet janë shkatërruar, qytetërimet janë zhdukur, shtete dhe kombe janë shuar. Kjo do të thotë se janë shkatërruar ndjenjat tona të humanitetit, shoqërisë, vëllazërisë, shpirtrave dhe zemrave tona! Kjo do të thotë se është shkatërruar ymeti ynë!

Një evlja e ka përshtuar me këto fjalë situatën e njeriut të sotëm: "Tjetërsimi i natyrës së njeriut apo dehumanizimi i njeriut është i rrezikshëm përfundim, po aq sa është i rrezikshëm edhe shpërthimi i bombave atomike." Kjo do të thotë se njeriu është shndërruar në një kriesë pa shpirt.

Shohim se shoqëritë moderne kanë rënë nga shkalla më e lartë e tyre, që është sineriteti tek niveli i falimentimit moral dhe shpirtëror. Po shuhet lidhja e njeriut me monoteizmin. Në qoftë se e privojmë veten tonë nga monoteizmi, atëherë humbim humanizmin, bëhem i të huaj përfundim i kësaj pesha e shpëtimit të gjithë njerëzimit. Allahu urdhëron dhe thotë: "Trupi yt shtypet nga rëndesa e kësaj pesha dhe Unë dëgjoj zhurmën e eshtrave tuaj tek shtypen!" pastaj Nurbaki na rrëfen një ngjarje që na bën të habitemi: "Teksa flet përfundim, thotë: "Jeta ime në këtë botë është si pushimi i udhëtarit nën hijen e një peme." Ja ne jemi ymeti i këtij Profeti, të cilin Allahu e ka dërguar vetëm me një qëllim, si mëshirë përfundim!

**u erdhën provat e qarta, u përqanë dhe u grindën.**

**Për këta do të ketë dënim të madh.**" (Al 'Imran, 105)

Mund të themi se ngjarjet që ndodhin sot në botë kanë shkatërruar gjithçka. Çdo ngjarje shndërrohet në një qamat përfundim. Kur një beduin erdhi dhe e pyeti Profetin Muhamed se: "Kur do të shpërthente qamat?" i Dërguari i Allahut iu përgjigji: "Atëherë kur t'ë humbas amanet!" Atëherë beduini e pyeti: "E kur do të humbas amanet?" Profeti Muhamed iu përgjigji: "Atëherë kur administrimi i punëve do t'u lihet në dorë njerëzve të paaftë." (Buhari, Ilm, 2.)

Allahu e ka krijuar njeriun me dy aftësi: të njohë vetveten dhe të dojë Profetin! Ne kemi ardhur në këtë botë që ta duam njëri-tjetrin! Ne kemi ardhur në këtë botë që të pimë ujin e jetës dhe të hamë nga sofa e qiellit! Pa dyshim që kemi probleme me sineritetin tonë! Profeti Muhamed (a.s.), gjithë jetën e tij përpëlloj dhe thoshte "Ymeti im! Ymeti im!". Përse shqetësohet vallë ai? Ai donte që në ymetin e tij të mbizotëronte afrimi dhe sineriteti. Ashtu si shqetësohet nëna përfëmijen e saj dhe rri gjithë kohën e thotë: Fëmija im! Fëmija im!, ashtu edhe Profeti shqetësohet përfundim! Pasi nuk jemi më ymeti që Profeti dëshironte të ishim! Jemi bërë të shurdhë, të verbër dhe të pandjeshëm! Profeti ynë i dashur ushqente mahnitje dhe habi ndaj Allahu, ndërsa përmallim dhe dashuri përfundim! Për këtë arsyen ai gjatë gjithë jetës së tij thoshte "Ymeti im!" Aty ku kishte një shqetësim, në qoftë se një kriesë në gjithësia vuante, Profeti (a.s.), përfshihej nën peshën e asaj vuajtjeje. Ja si e komenton këtë situatë Dr. Haluk Nurbaki: "Në ajetin e Kur'anit Allahu urdhëron dhe thotë:

**"Ti ke marrë mbi vete një peshë të papërbollueshme!"**

Cfarë është kjo peshë? Kjo është pesha e shpëtimit të gjithë njerëzimit. Allahu urdhëron dhe thotë: "Trupi yt shtypet nga rëndesa e kësaj pesha dhe Unë dëgjoj zhurmën e eshtrave tuaj tek shtypen!" pastaj Nurbaki na rrëfen një ngjarje që na bën të habitemi: "Teksa flet përfundim, thotë: "Jeta ime në këtë botë është si pushimi i udhëtarit nën hijen e një peme." Ja ne jemi ymeti i këtij Profeti, të cilin Allahu e ka dërguar vetëm me një qëllim, si mëshirë përfundim!

Fitorja më e madhe është përfshirja nën flamurin e monoteizmit, ndërsa humbja më e madhe është dalja jashtë tij. Xhamia Aksa sot është e pushtuar. Xhamia Aksa është vendi nga ku u ngrit profeti Muhamed (a.s.),

drejt pérjetësisë natën e Miraxhit pér t'u takuar me Allahun (xh.sh.). Po tē hedhim një vështrim tek vetvetja, do tē shohim se edhe zemra jonë, prej ku ne mund tē pérjetojmë miraxhin e vogël éshtë e pushtuar. Pérse xhamia Aksa éshtë nē duart e pushtuesve? Si mund ta lejojë këtë Zoti ynë? Përgjigja éshtë e qartë. Ne kemi lejuar që tē pushtohet gjëja më e shtrenjtë që kemi, pra zemrën tonë. Ne i kemi bërë padrejtësi vetes sonë, ashtu siç thotë edhe Zoti nē Kuran, nē ajetin 101 tē sures Hud: **"Ne nuk u kemi bërë padrejtësi atyre, por ata i bënë padrejtësi vetes së tyre."** Zotat e djallosur dhe idolet që kanë pushtuar zemrat tona, si dhe sëmundjet shpirtërore që na i kanë fëlliqur zemrat tona, me pak fjalë "shirku", na ka pushtuar tē gjithëve. Këtu ne gjendemi përballë tragedisë më të madhe tē njerëzimit: ymeti i Muhamedit ka mundësinë e pérjetimit tē "miraxhit tē vogël", që éshtë shkalla më e lartë e afrit me xhenetin, por ne e kemi humbur këtë mundësi me duart tona. Allahu i fton myslimanët nē pérjetimin e kësaj gjendjeje shpirtërore, duke ju ofruar mundësinë e ngritjes shpirtërore drejt xhenetit. Miraxhi éshtë piedestali i entuziazmit shpirtëror, shpalosja e flatrave drejt hijeshive tē prehjes dhe shpirtrave tē njerëzve.

E vërteta éshtë se ne jemi shndërruar nē kukullat e shejtanit dhe egos sonë. Skllavëria e vërtetë éshtë skllavëria ndaj egos. Shpëtim nga padrejtësia nuk éshtë vetëm liria e trupit. Liria më e madhe éshtë robëria ndaj Allahut! Liria e vërtetë e njeriut éshtë shpëtimi i i tij prej dëshirave, epsheve dhe padrejtësisë që mund t'i bëjë ai vetvetes. Një koncept tërësisht i kundërt me atë që na ofron modernizmi nē ditët e sotme. Në lidhje me këtë pikë, Prof. Dr. Nevzat Tarhan thotë: "Në qoftë se pyesim se cila éshtë qeliza më e lirë nē trupin tonë, përgjigja éshtë se ajo éshtë qeliza e kancerit, e cila e gëlltit qelizën që ka pranë dhe konsumon tre deri nē pesë herë më shumë sheqer në gjak, nē krahasim me një qelizë tē shëndoshë. Qeliza kancerogjene rritet me shpejtësi, sepse éshtë e lirë. Ajo éshtë aq e lirë, saqë rritet dhe rritet deri sa shkatërron gjithë indet dhe nē fund fare vdes së bashku me trupin e njeriut. Ja kjo éshtë liria narciste, pa kufi."

Feja islame nuk éshtë vetëm një sistem besimi, por edhe një situatë ekzistence. Bëhu njeri i vërtetë! Bëhu edhe ti si profeti Muhamed! Bëhu pjesë e ymetit mysliman! Kur do tē zgjohemi nga gjumi i indiferencës? Kur profeti Muhamed erdhë nē këtë botë, çdo gjë ndryshoi. Ai u mësoi njërzëve fenë e lartësimit, miraxhit, purifikimit dhe dritës. Të gjitha dallimet u zhdukën dhe tē gjitha limitet u hoqën. Më i respektuar i njerëzimit i tërhoqi tē gjitha mendjet dhe zemrat drejt

përsosmërisë dhe hijeshisë së Allahut. Në mesin e njerëzimit doli ymeti më i mbarë. Në Kuran thuhet se ymeti mysliman éshtë ymeti më i mirë. Drita e Allahut u ngrit mbi gjithë gjithësinë dhe dielli i dashurisë nisi tē ndriçonte përbimi shkretëtirëne e ekzistencës. Së bashku me vulën e profetëve, profetin Muhamed, ngadhënjeh feja e vërtetë, u nda e vërteta nga gënjeshtra dhe u shtrua rruga e mrekullueshme e së drejtës absolute. Ky éshtë thesari i ymetit tē Muhamedit. Kjo rrugë éshtë një ftesë hyjnore pér ne.

Enigma e besimit gjendet e mbyllur brenda monoteizmit. Besimi i sigurt éshtë pérjetimi i monoteizmit. Enigma e tē qenit besimtar éshtë vëllazëria. Ymeti i profetit Muhamed beson tek monoteizmi! Uniteti, dashuria, vëllazëria, jeta nē bashkësi, tē gjitha këto janë tē domosdoshme që njeriu tē ekzistojë. Vëllazëria pérjetohet falë dritës së monoteizmit dhe atëherë ne zhytemi brenda detit tē monoteizmit si besimtarë tē vërtetë pér t'u bërë ymet i Muhamedit!



Në shoqëritë moderne nuk ekziston vëllazëria humane apo miqësia e singertë. Aty edhe vëllai përdoret thjesht pér interes personal dhe pér këtë arsy, aty nuk pérjetohet ndjenja e miqësisë. Ne nuk mund tē bëhem i kurrë ymeti i Muhamedit, nē qoftë se nuk ndajmë me tē tjerët ushqimet e evlivate, nuk ulemi së bashku me ta nē sofrat e parajsës, nuk shijojmë shijen e imanit, nuk nuhasim aromën e jetës tjetër, pasi nuk jetojmë pranë një personi që jeton si sahabët, nuk bëhem i pjesë e admirimit, dhembshurisë, dashurisë dhe lotëve që ata derdhin kur përmendet Profeti.

Ne duhet tē shkrihem i tek profeti ynë, duke u zhytur nē detin e përmallimit si pjesëtarë tē ymetit tē tij. Duhet tē shkrihem i duke u zhytur nē dashurinë pér tē Dashurin e Allahut. Duhet tē jemi gati tē japim edhe jetën tonë, nē mënyrë që tē afrohem i me Allahun, tē afrohem i me parajsën e Tij dhe tē kundrojmë hijeshinë e Allahut. Në qoftë se bashkësia myslimanë sot që numëron një miliard e gjysmë njerëz do tē ishte e gjitha një bashkësi zogjsh që mbushin sqepin që tē shuanjë me tē zjarrin e Nemrudit, ata do tē arrinin tē shuanin zjarrin që ka rënë nē tē gjitha pyjet. Edhe sikur zjarri i padrejtësisë do tē që përhapur nē tē gjithë botën, ky ymet mund tē shndërrojë atë nē kopsht trëndaflash. Atëherë kur njeriu do tē bëhet pjesëtar i ymetit duke u zhytur nē detin e monoteizmit, ai do tē shpëtojë nga padrejtësia e Nemrudit dhe do tē hyrë nē xhenetin e trëndafilave. Të jesh pjesëtar i ymetit tē Muhamedit éshtë fatmirësia më e madhe, që nuk ka tē krahasuar me asnjë begati që njeh njerëzimi që nga krijimi i tij.

# Qurtësia e dhurimit dhe e bamirësisë

Kurani na këshillon t'u qasemi ligjeve hyjnore që ai shpall, duke kuptuar urtësinë e tyre. Në Kuran, Allahu na këshillon me fjalët: **"Ne kemi dërguar profet nga mesi juaj, i cili ua lexon ajitet tonë, dëshiron që ju të purifikoheni dhe ua mëson Kuranin dhe urtësinë e tij. Ai ju mëson juve gjërat që nuk i keni ditur."** (Bekare, 151), duke na bërë të ditur në këtë mënyrë se lumturia në këtë jetë dhe në jetën tjetër arrihet kur besimtarit nuk e nënveftëson urtësinë që ngërthejnë urdhrat e fesë. Duke na e bërë të ditur këtë gjë, Zoti na lë të kuptojmë se besimtarit eshtë trashëgimtarit i një enigme të tillë siç eshtë urtësia.

Shprehja "ia mëson librin", që përmendet në ajetin fisnik, nënkupton urdhrat e Kurabit, ndërsa shprehja "ia mëson urtësinë" nënkupton se cilat prej këtyre urdhrove kanë të bëjnë me lejimin dhe cilat me ndalimin. Urdhrat dhe ndalimet e Kurabit do ta shpilen njeriu drejt lumturisë në këtë jetë dhe në jetën tjetër, ndërsa kapja e urtësisë së këtyre urdhëresave ia pasuron atij botën shpirtërore.

Në ajetin e mësipërm përmendet fjala "infak", një fjalë që përmendet shumë në Kuran, por që në ajetin e mësipërm eshtë përdorur në një kuptim më të veçantë, atë të urtësisë së saj. Kuptimi bazë i një fjalë e kushtëzon individin me përgjegjësi, ndërsa kuptimi i urtësisë i asaj fjalë e bën atë të vetëdijshëm në lidhje me natyrën e atij urdhri.

Kurani fisnik e numeron "dhurimin dhe bamirësinë" në cilësitë dalluese të besimtarit. (Bekare, 3) Bamirësia eshtë njëra nga bazat mbi të cilat ndërtohet personaliteti i plotë prej besimtarit, prandaj edhe Allahu na bën të ditur se të pasurit duhet të bëjnë bamirësi duke dhënë zekatin, të varfrit duke dhënë sadaka dhe pronarët e tokave duke dhënë një të dhjetën. (Bekare, 110, 267, 280) Kurani na mëson se besimtarit do t'i rritet rrizku në përputhje me sasinë e pasurisë që ai dhuron për bamirësi. (Bekare, 261) Me fjalë të tjera, teksha dhurojmë duke bërë bamirësi, jo vetëm që plotësojmë nevojat e një besimtarit tjetër, por në të njëjtën kohë bëjmë një investim në rrizkun tonë.

Po t'i qasemi konceptit të urtësisë së "bamirësisë", kuptojmë se prej besimtarit kërkohet që të bëjë bamirësi prej ndjenjës së dëshirës që Allahu ka vendosur në shpirtin e tij. Ashtu sikurse zekati eshtë një masë në para, që u duhet dhënë njerëzve nevojtarë, edhe qarja e halleve dhe zgjidha e problemeve që ka vëllai mysliman eshtë një lloj zekati apo një lloj sadakaje. Perceptimi i kësaj të vërtete arrihet me anë të urtësisë. Ashtu sikurse duhet ndihmuar besimtarit apo njeriut që nuk ka me se të ushqehet, ashtu duhet edhe të marrim pjesë në zgjidhjen e dhimbjeve shpirtërore të besimtarit me shpirt të uritur dhe me zemër të vrarë nga padrejtësitet e ndryshme. Me ta duhet ndërtuar ura e dashurisë.

Nëse për të dhënë zeqat apo një të dhjetën e prodhime-



ve duhet që besimtarit të zotërojë një sasi të caktuar të ardhurash dhe prodhimesh, për t'u qarë hallin problemeve të besimtarit dhe për t'a zgjidhur hallet që ka nuk eshtë e nevojshme të zotërojmë më parë një sasi të caktuar. Në rast se ne shpenzojmë për të zgjidhur problemet dhe vështirësitet e vëllait tonë mysliman, atëherë e pasurojmë më shumë zemrën, e gjallërojmë më shumë shpirtin dhe e zhvillojmë më shumë botën tonë të perceptimit.

Ashtu sikurse nga çdo pasuri e caktuar eshtë e detyrueshme fetarish që të shpenzohet kur ajo e arrin vlerën e nisabit, çdo mysliman i nderuar me përkatësinë e tij fetare ka një zekat për të dhënë në lidhje me ngushëllimin e njerëzve që ka përreth dhe janë me zemër të thyer dhe me shpirt të vrarë. Për këtë arsy, çdo mysliman e ka për detyrë të mbajë mbi shpatulla, në mënyrë që t'a lehtësoj sadopak peshën e halleve dhe të shqetësimëve që ka vëllai i tij mysliman.

Prandaj edhe i Dërguari i Allahut ka urdhëruar dhe ka thënë: "Besimtarët janë si një trup i vetëm, për sa i përket dashurisë, keqardhjes dhe kujdesit që ndjejnë dhe tregojnë për njëri-tjetrin. Kur njëri nga organet e trupit sëmuret, të gjithë organet e tjerë të atij trupi nuk kanë qetësi, gjumë dhe rehati. (Rijadu's-Salihin; Buhari, Edeb 27; Muslim, Birr 66) si dhe "Floku i bardhë eshtë drita e besimtarit. Në qoftë se një besimtar i zbardhen flokët nga puna e tij në rrugën e fesë islamë, ai do të fitojë sevap për secilën fije floku që i eshtë zbardhur dhe për secilën prej tyre do të rritet një gradë." (Xhamiu's-Sagir, 4:184, Hadith No: 4967)

Teksa këshillonte rreth dhënies së sadakasë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), u mësonte besimtarëve se përveç ndihmës materiale, sadaka konsiderohet edhe buzëqeshja që besimtarit i jep një besimtar, duke na mësuar kështu që sadakaja nuk duhet kuptuar vetëm si diçka materiale, por edhe si diçka morale dhe shpirtërore. Si përfundim, sadakaja eshtë një veprim i ndërsjellë, që ka ndikim si mbi personin që jep edhe atë që merr. Sadakaja e begaton jetën. E shton rrizkun. E mbron besimtarin nga zjarri i xhehenemit. Parandalon fatkeqësitet. Zgjidh hallet. Bëhet shkak që Zoti të pranojë duanë e besimtarit. Asgjëson mendjemadhësinë dhe na shpëton nga dënim i varrit. (Ibn Maxhe, Tirmidhi, Bejhaki, Dejlemi, Taberni) Prandaj qëllimi i besimtarit duhet të jetë lartësimi i njeriut dhe i dinjitetit njerëzor. Këtë na e mëson edhe vetë Kurani. Për të arritur këtë gjë, duhet të bëhem krahë i ndihmës së të varfrit, të mjerit dhe të nëpërkëmburit. Duke bërë këtë gjë, kontribuojmë në shtimin e numrit të njerëzve me fytyrë plot nur besimi. Mëshira që do të tregojmë në këtë botë, respektimi i njerëzve dhe ngopja e barkut të nevojtarëve kanë për të na mundësuar fitimin e xhenetit. Pasuria e pamatë e një zemre dhe dashuria e pamasë e njeriut kanë për të na shpënë drejt shpëtimit...



# MOS E HARRO ZOTIN DHE JETËN TJETËR!

Zoti i Madhëruar, Mëshiruesi i mëshiruesve, urdhëron dhe thotë në Kur'an:

**"Jeta e kësaj bote, nuk është gjë tjeter, veçse argëtim dhe lojë. Ndërsa jeta e botës tjeter, pikërisht ajo është jeta e vërtetë. Ah sikur ta dinin!"** (Ankebut, 64)

Me anë të ajeteve të tjera të Kur'anit, Allahu na kujton se jeta e kësaj bote nuk është gjë tjeter veçse një endje dhe lojë e shkurtër (Enam, 32; Muhamed, 36; Hadid, 20.) se njerëzit gjenden në një fushë sprove që nuk do të përsëritet më, duke na tërhequr vëmendjen me anë të këtyre fjalëve. (Zuhraf, 83; Mearixh, 42; Enam, 91; Tur, 12.)

"Njeriu, krijesa në nefsin e të cilil është frysmezuar si devocioni ashtu edhe keqbërja, është i obliguar të zhvillojë mirësitë që janë të kyçura në thelbin e tij dhe të shtypë pasionet që gjenden aty. Për të realizuar këtë, atij i nevojiten mekanizma të caktuara të kontrollit, në krye të të cilave vjen pa dyshim një akide e shëndoshë, që në vetvete plotësohet me përthithjen e frysës së bazave të besimit. Ajo perfektionohet me vetëdijshmërinë se Allahu e sheh njeriun në çdo kohë dhe në çdo vend. Ajo përmbushet me vetëdijen se një ditë do të jepet llogari për secilin veprim të kryer në jetë. Si rezultat i të gjitha këtyre, është e domosdoshme t'i japësh rëndësinë që i takon secilës, si kësaj bote ashtu edhe botës tjeter, si dhe të mos e këputësh asnjëherë lidhjen që ke me Allahun."

Të gjitha këto i mendoj kur lexoj pjesën tjeter të ajetit të mësipërm. Pasi në vazhdim të këtij ajeti thuhet: **"Kur hipin në anije, ata i luten Allahut me devotshmëri të sinqertë, por kur Ai i sjell në tokë shëndoshë e mirë,**

**menjëherë ata i veshin Atij ortakë** (në adhurim), **përtë mohuar atë që u kemi dhënë Ne dhe për t'u kënaqur. Por shpejt do ta marrin vesh!"** (Ankebut, 65-66)

Qafirët që i bëjnë shok Allahut, fjala vjen, kur hipin në anije dhe dalin për lundrim në det, tmerrohen atëherë kur deti trazohet dhe dallgët janë aq të fuqishme sa mund t'u përmbystin anijen ku gjinden. Atëherë ata i përgjërohen Allahut ashtu siç i lutet një besimtar i devotshëm, sepse edhe ata thellë në shpirtin e tyre e dinë se askush tjeter nuk mund t'i shpëtojë nga ky rrezik përvëç Allahut. Vetëm se, pasi kalon momenti i irrezikut dhe ata dalin shëndoshë e gjallë në breg të detit, harrojnë menjëherë adhurimin e Allahut, të Cilit i përgjëroheshin singerisht në momentet e rrezikut. Ata nuk u përbahen fjalëve që kanë thënë kur i janë përgjëruar Allahut me gjithë shpirt, por kthehen sërisht në baltovinë e shirkut dhe mosbindjes ndaj urdhavrave të Zotit. Allahu ua tregon besimtarëve këtë të vërtetë, duke nxjerrë në pah mospërputhjen e myshrikëve ndaj dy situatave. Ndoshta për t'u tërhequr vëmendjen besimtarëve që edhe ata të mos kryejnë veprime të tilla kundërthënëse.

Në tefsirin e Kur'anit, të quajtur Ruhu'l-bejan, në lidhje me këtë ajet të Kur'anit thuhet se ai tregon se jeta e botës është "e vdekur". Allahu i ka cilësuar si "të vdekur" jobesimtarët tekxa flet rreth tyre dhe urdhëron e thotë: **"Ti nuk mund t'i bësh të vdekurit të të dëgjojnë."** (Rum, 52) Në një ajet tjeter Ai urdhëron dhe thotë: **"...që të paralajmërosh të gjallët..."** (Jasin, 70) Në të vërtetë, në sajë këtyre ajeteve është konstatuar se bota dhe kriesat

brenda saj janë "të vdekura", me përjashtim të krijesave që u falet gjallëria e jetës në sajë të dritës së besimit, sepse jeta tjetër konsiston në botën e shpirtrave (alemul-ervah). Të dyja këto janë të gjalla në përjetësi. Në ajetin rreth të cilat po diskutojmë jeta tjetër është emërtuar "le hije'l-hajevan", fjalë që përdoret për gjallesat apo gjërat tek të cilat dallohen shenja jete.

Në këto kushte jeta e vërtetë është jeta që nuk ka hidhërim dhe halle, që nuk njolloset nga sëmundjet dhe mangësitë, në të cilën nuk do të përjetohen vdekja dhe asgjësimi. Kjo është jeta e xhenetit. Në qoftë se njerëzit do t'ia dinin vlerën dhe perfekcionimin kësaj jete, do të dëshironin më shumë që ta fitonin atë duke kryer sa më shumë punë të mira në këtë jetë.

Vetëm se jeta e kësaj bote që ngjan me një lojë dhe dëfrim është e mrekullueshme në sytë e atyre njerëzve që nuk kanë haber nga jeta e dëllirë dhe nga ringjallja në jetën tjetër. Gjallëria e jetës tjetër në jetën tonë të kësaj bote për evlijatë e Allahut gjendet tek dhikri dhe dashuria ndaj gjithë krijesave të tjera, ndërsa në jetën tjetër ata do tëjenë fatlumët që do të shohin me sytë e tyre Hijeshinë e Zotit.

Ashtu sikurse ka thënë edhe Ibrahim Haki nga Erzurumi: "Njeriu nuk duhet ta harrojë kurër se ekziston Zoti që e sheh atë kudo dhe kurdo që të gjendet, si dhe e mëshiron njeriun me rrizkun e Tij edhe në momentin më të madh të mosbindjes së tij ndaj Zotit." Njeriu duhet të ruhet që të mos bjerë në ato situata që meritojnë hidhërimin hyjnor,

sic është rasti i mushrikëve që tregohet në ajetin e Kur'anit, situata "e kujtimit të Zotit kur bie në hall dhe e zhytjes në baltovinën e mosbindjes ndaj urdhavrave të Zotit kur shpëton nga ai hall dhe rrezik për jetën."

Nga ky aspekt, është jashtëzakonisht e rëndësishme që kriteret për të cilat flitet në ajetin e mësipërm të gdhenden dhe ruhen në personalitetin e njeriut. Ka shumë rëndësi të vendoset drejtëshimi mes jetës së kësaj bote me jetën e botës tjetër, sepse njeriu përherë e kalon cakun atëherë kur harron të vërtetën absolute se kjo botë është një fushë sprove dhe kalimi të një kohe të përcaktuar. Ai e humb drejtëshimin e duhur kur harron se është nën kontrollin e Allahut. E kujton Zotin vetëm kur mbetet ngushtë dhe vazhdon të kryejë një jetë kuturu në momentet e tjera të jetës së tij. Ai kthehet në përbindësh në shtëpi, në vendin e tij të punës dhe në ambientet e tjera publike, duke dashur t'i përdorë në mënyrë abuzive kompetencat e tij. Tregohet i padrejtë me të tjerët.

Allahu i Lartësuar, i Cili ia di të metat dhe mangësítë njeriut, i kujton atij me këtë rast pozitën e tij në jetën e dynjasë. Ai i mëson njeriut se qëllimi i tij duhet të jetë jeta nën "ndërgjegjen e afërsisë" me Zotin, duke e përmendur shpesh Atë. **"O besimtarë! Përmendeni shpesh Zotin tuaj!"** (Ahzab, 41), urdhëron et hotë në Kur'an. Nënvizojmë këtu faktin se shprehja në original e këtij ajeti është "dhikren kethiran", që do të thotë "përmendeni shpesh", duke mos përcaktuar ndonjë sasi të caktuar si detyrim me këtë shprehje, sipas filologjisë arabe.



## SHPËTIMI NGA PASIONET

Allahu, Furnizuesi i vërtetë i gjithë krijesave urdhëron dhe thotë në Kur'an: **"Thuaj: 'Me të vërtetë, Zoti im i jep begati të bollshme kujt të dojë nga robërit e Tij dhe ia pakesson kujt të dojë. Ai ua zëvendëson atë që e ndani ju; Ai është Dhuruesi më i mirë."**

(Sebe, 39)

Në një ajet tjetër të Kur'anit thuhet: **"Sa e sa gjallesa nuk e kanë me vete rrizkun e tyre. Allahu ua jep edhe atyre, edhe juve rrizkun që u takon."** (Ankebut, 60)

Cfarë gjendje të prehjes shpirtëtore përjeton besimtarë, i cili i gdhend në zemrën e tij këto mësimë të Kur'anit?

A ka pse të shqetësohet besimtarë, në qoftë se e mban ndër mend paralajmërimin e Profetit se "Rrizku e kërkon të zotin e tij më shumë sesa e kërkon exhelë i tij atë. Ai e gjen atë kudo që të gjendet." (Xhamiu's-Sagir, II, 27.)

A do të dorëzohej njeriu përpëra pasioneve, në qoftë se thellë në shpirt e beson se rrizku është i siguruar nga Allahu për të dhe ai do të marrë atë që i ka caktuar Zoti?...



Nuk ka dyshim se besimtarë, i cili e di se shtimi i rrizkut ka shkaqe si materiale, ashtu edhe shpirtërore, i vihet menjëherë punës së tij, prandaj ai që e di se rrizkun ia rrit edhe mirësia që do të tregojë ndaj të afërmve të tij rend t'u bëjë mirë atyre, ai që e di se bereqetin e rrizkut ia shton ndihma që do t'u japë të varfërve, mundohet sa më shumë t'i ndihmojë nevojtarët, ai që e di se rrizku shtohet me devocion nuk u ndahet veprave të devotshmërisë. Ai e di se rrizkun e fiton më lehtë besimtarë që i beson me gjithë zemër Allahut.

Ah, sikur të gjithë njerëzit ta dinin këtë të vërtetë dhe besimtarët nuk do ta harronin kurë atë: Rrizku i të gjitha gjallesave është në sigurimin që jep Allahu. Zoti ia shpërndan në masën që e ka vendosur Vetë rrizkun që i takon si besimtarit, ashtu edhe qafirit. Besimi në këtë të vërtetë është ilaqi më i mirë për të shpëtar nga ndikimet e mbrapshta të pasioneve.



# NAMAZI ME XHEMAT DHE VËLLAZËRIA ISLAME

Dr. Kerim Bulladë

Feja islame i ka kushtuar shumë rëndësi faljes së namazit me xhemat, duke e konsideruar atë si një element të patjetërsueshëm të vëllazërisë, unititetit dhe bashkimit mes myslimanëve. Njëra nga arsyet përse feja islame e përkrah faljen me xhemat të pesë namazeve të detyruara gjatë ditës, si dhe faljen bashkë të namazit të xumasë, njëherë në javë apo të bajrameve që falen dy herë në vit, është pa dyshim formimi dhe forcimi i frysës vëllazërore.

Kurani u tërheq vëmendjen myslimanëve rrëth rëndësisë së bashkësisë dhe kërkon prej tyre të bien në ruku dhe në sexhde të gjithë së bashku përparrë Allahut:

**"Faleni namazin dhe jepeni zeqatin. Bini në ruku së bashku me njerëzit e tjerë që bien në ruku."** (Bekare, 43) Komentatorët e Kuranit pjesën në original "verkeu..." e kanë komentuar me fjalët "faluni me xhemat dhe shkoni në xhami." (Bejdavi, I, 116; Neseft, I, 167; Hazin, I, 167; Shevkân, I, 96.) Madje ka dijetarë që janë të mendimit se falja e namazit me xhemat është farz kifaje, ndërsa shumica e dijetarëve myslimanë janë të

mendimit se falja e namazit me xhemat është sunet muekede. Një pjesë e juristëve myslimanë e kanë konsideruar të ndaluar mosfaljen e namazit me xhemat pa pasur arsy. (Shevkani, a.g.e., I, 96; Kurtubi, vol. I, fashikulli, I, 327-330.)

Ajet i mëposhtëm shpreh shumë qartë se sa rëndësi i ka dhënë Kurani faljes së namazit me xhemat: "**Kur të jesh ti** (o Muhamed) **në mes të besimtarëve dhe të prish faljen e namazit** (në luftë), **atëherë njëri grup prej tyre le të falet me ty dhe le t'i mbajnë pranë edhe armët e veta! Pastaj këta, le të rrinë pas jush dhe le të vijë grupi tjetër, i cili nuk është falur dhe le të falet me ty! Le të jenë syçelë dhe t'i mbajnë armët e veta!**" (Nisa, 102)

Sikurse shihet edhe nga ajeti i mësipërm edhe në situatat kur armiqtë mund të kryejnë sulme të ashpra bëhet fjalë përfaljen e namazit me xhemat. Nxitja e besimtarëve që të falin namazet me xhemat, madje edhe në frontin e luftës, tregon qartë se sa rëndësi i jepet faljes së namazit me xhemat në kohë të lirë dhe paqeje. Në të njëtin kohë, ky ajet, jo vetëm që tregon rëndësinë e faljes me xhemat pas Profetit, por një-

kohësisht tregon se sa shumë dëshirë kishin sahabët që të falnin namaz pas pejgamberit (a.s.).

Profeti Muhamed (a.s.), gjithashtu i ka nxitur shpesh myslimanët që ta falin namazin me xhemat. Ja se si është shprehur Profeti në lidhje me epërsinë e faljes së namazit me xhemat:

*"Sevapi i namazit të falur me xhemat është njëzet e shtatë herë më i madh sesa namazi që falet vetëm."* (Buhari, Ezan, 30; Muslim, Mesaxhid, 247, 249, Nesai, Imamet, 42; Muvatta, Xhemaat, 1, Ahmed b. Hanbel, II, 65.)

Nuk ka dyshim se falja e të gjitha namazeve farz së bashku me xhemat është një veprim shumë i rëndësi-shëm, por në mesin e tyre Profeti (a.s.), dallonte faljen me xhemat të namazeve farz të sabahut dhe të jacisë. Në lidhje me këtë gjë ai qe shprehur:

*"Në qoftë se myslimanët do ta dinin vlerën e ezanit dhe faljes së namazit në rreshtin e parë, do të hidhnin short se kush do ta këndonte ezanin dhe kush do të falej në rreshtin e parë të xhematit. Po ta dinin rëndësinë e faljes së namazit të mëngjesit, do të bënin garë se kush do të shkonte i pari në xhami. Po ta dinin vlerën e faljes së namazeve me xhemat në xhami nga koha e sabahut dhe deri në jaci, do të kishin shkuar në xhami madje edhe duke u zvarritur."* (Muslim, 129, 131.)

Gjithashtu, Profeti ka nënvisuar edhe faljen e namazeve me xhemat të sabahut dhe të jacisë, duke thënë se sevapi i tyre është i barabartë me se-vapin e faljes së namazeve nafile gjatë gjithë ditës. Ai ka thënë:

*"Ai që fal namazin e jacisë me xhemat, do të marrë sevape sikur të kishte falur namaz nafile deri në mesin e natës. Në qoftë se e fal namazin e sabahut me xhemat, do të marrë sevape sikur të falë namaze nafile nga mesi i natës deri në mëngjes."* (Muslim, Kitabu'l-Mesaxhid, 260.)

Sikurse shihet, Profeti i ka dhënë shumë rëndësi faljes së namazit me xhemat dhe gjatë gjithë jetës së tij i ka falur namazet me xhemat, madje edhe gjatë periudhës së sëmundjes që i mori jetën, nuk e pati braktisur asnjëherë faljen e namazit me xhemat dhe që falur pas Ebu Bekrit (r.a.). (Buhari, Ezan, 51; Muslim, Salat, 90; Nesai, Imamet, 40; Darimi, Salat, 44; Ahmed b. Hanbel, II, 52.)

Namazi i falur me xhemat shton dashurinë dhe respektin në mesin e myslimanëve, duke kontribuar në formimin e frysës së solidaritetit, ndihmës dhe ndarjes së mundësive me njëri-tjetrin, si dhe në forcimin dhe zhvillimin e bashkësisë myslimane.

Falja e namazit me xhemat është shfaqja më e qartë e edukimit vëllazëror. Të gjithë myslimanët, pa dallim pozite, posti apo statusi tjeter social dalin në namaz përpara Allahut dhe i drejtohen Qabes. Ata zënë vendin e lirë që gjendet në rreshtat e xhematit, pa bërë dallim mes tyre. Askush nuk ka vend të përcaktuar për t'u falur vetëm ai aty në xhami. Ai që vjen i pari në xhami, zë vendin e lirë në rresht dhe mund të falet aty ku është ulur. Feja islame nuk e konsideron aspak të hijshëm kapërcimin mes rreshtave në namaz, në mënyrë që të dilet në rreshtat e parë.

Të gjithë myslimanët që falen me xhemat, çfarëdo qofshin ata, të varfér, drejtues, të pasur, nëpunës, pronarë dhe punëtorë vihen në rresht përpara Alla-hut brenda në xhami dhe kryejnë faljen e namazit me xhemat. Panorama universale e besimit mysliman dhe vëllazërisë islame manifestohet përpara njerëzimit pesë herë në ditë në sajë të namazit. Këtë unitet dhe bashkim nuk e mundëson asnjë fuqi tjeter përvenc namazit, që është ana praktike e Shprehjes së Njësisë së Zotit.

Namazi dhe rreshtat e myslimanëve kur falen me xhemat, janë një manifestim i fuqishëm, që arrin të zhdukë elementët negativë që bien ndesh me unifikimin e myslimanëve, siç janë dallimi mes klasave të shoqërisë, kombësia, farefisnia dhe ngjyra e lëkurës.

Namazi me xhemat, jo vetëm që forcon lidhjet vëllazërore mes myslimanëve, por njëkohësisht siguron formimin e të drejtës vëllazërore. Gjithashtu, namazi jo vetëm që na mëson domosdoshmërinë e ndarjes me të tjerët të gjëzimeve dhe hallevë, por njëkohësisht minimizon zilitë e padhimbshtme, armiqësitë, urrejtjen dhe smirën në jetën e përditshme. Shkurtimisht, namazi me xhemat është faktori më i madh dhe më me ndikim në formimin, vazhdimin dhe qëndrueshmërinë e vëllazërisë mes myslimanëve.

Faktin që namazi me xhemat, fotografia më mëdhështore e vëllazërisë dhe barazisë universale, ka nisur të shndërrrohet në një fotografi të zbehtë në kohën që jetojmë, mund ta kuptojmë nga pjesëmarrja e xhematit në faljen e namazeve në xhami në ditët tona. Për këtë arsy, në qoftë se myslimanët dëshirojnë së-rish të shndërrrohen në protagonistë aktivë në skenën e historisë, ata duhet të ringjallin sërisht faljen e namazeve me xhemat. Ditën që myslimanët do ta kuptojnë se formimi i vëllazërisë myslimane kalon nga falja e namazeve me xhemat, atë ditë do të ndryshojë edhe pamja e botës ku jetojmë.



# Një Ajet

Mendjemandhësia është vlerësimi i tepruar i aftësive personale, ndërsa mendjemandh është ai të cilat i pëlqen shumë mendja e vet dhe nuk pranon e nuk përfill mendimin e të tjera, por shfaq sjellje arrogancë ndaj tyre. Përkundrejt kësaj qëndron përulësia, butësia dhe modestia. Mendjemandhësia mund të shfaqet në forma të ndryshme, si për shembull origjinal, përkatësia fisnore, pasuria, fuqia, forca fizike, bukuria, të mësuarit e dituria, statusi social e arritjet personale. Madje mendjemandhësia mund të shfaqet edhe në shërbimin e tepruar ndaj Zotit. Tipi më i keq i kryelartësisë është ajo që shprehet ndaj Zotit, ndaj të Dërguarit të Tij dhe ndaj fesë.

Në ajetin e mësipërm shprehet qartë se një nga kushtet për të fituar xhenetin është të moskenit mendjemëhenj e arrogantë ndaj njerëzve. Kjo arrihet duke besuar Allahu në mënyrën më të sinqertë dhe duke iu bindur pa asnjë mëdyshje urdhreve dhe vullnetit të Tij, duke mos shpalosur as më të voglën shenjë madhështie ndaj Allahut dhe krijesave të Tij. Ishte pikërisht kjo ndjenjë madhështie ajo që shfaqi shejtani, i cili për këtë arsy meritoi mallkimin e Allahut, duke e humbur kështu njëherë e përgjithmonë mundësinë për t'u përfshirë nga mëshira e Allahut. Në një ajet tjetër, duke na urdhëruar që të mos mburremi, Allahu thotë:

*"Dhe mos shtrembëro ftyrën tënde prej njerëzve, mos ec nëpër tokë kryelartë, se Allahu nuk e do asnjë mendjemandh e që shumë lavdërohet."* (Lukman, 18)

Kur njeriu e zbras zemrën nga ndjenja e besimit që ekziston në mënyrë të natyrshme në

*"Atë, xhenetin ua kemi përcaktuar atyre që nuk dëshirojnë madhështi dhe nuk bëjnë arrogancë në tokë. Përfundimi i këndshëm u takon atyre që i frikësohen Allahut."*

(Kasas, 83)

zemrën e tij, ai fillon të pushtohet nga ndjenja e madhështisë dhe kryelartësisë, aq sa çdo të mirë që zotëron, si fjala vjen pasuria, fuqia, pushteti, bukuria, ia dedikon aftësive të veta personale. Sikur të arrinte të kuptonte se të gjitha ato të mira i janë dhënë nga Allahu, në mënyrë që të bëhej i vetëdijshëm përfuqinë dhe dobësinë e tij përballë fuqisë së Allahut, do të sillej në mënyrë modeste me njerëzit, pa treguar as shenjën më të vogël të mendjemandhësë. Kush e harron këtë fakt të rëndësishëm, nuk bën gjë tjetër vetëm se përsërit gabimet që kanë bërë faraoni dhe Karuni, të cilët jepen si modele dhe shembuj të këqinj sa i përket shfaqjes së mendjemandhësë dhe të arrogancës në tokë. Allahu i dha Karunit begati të shumta, si pasuri dhe pushtet, por në vend që të falënderonte Allahu përmirësitet e dhëna dhe t'i shpenzon përfbamirësi, ai u përfshi nga ndjenja e madhështisë dhe arrogancës.

Por si ishte përfundimi i tij? Allahu thotë në Kur'an:

*"Dhe për këtë arsy, Ne e fundosëm thellë në tokë atë edhe pallatin e tij, dhe nuk pati askënd që ta ndihmonte dhe as veten e tij nuk mundi të mbronte përballë Allahut."* (Kasas, 81)

Përfundimi i këndshëm dhe i lumtur është për ata që janë modestë dhe të sjellshëm me njerëzit.

Allahu ka thënë në Kur'anin famëlartë: "...e s'ka dyshim se te Allahu, më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat)...." (Huxhurat, 13)

Transmetohet nga Ebu Ja'la Shedad ibn Evs (r.a.),  
se Pejgamberi -salall-llahu alejhi ve selem-, ka thënë:

"I zgjuar është ai që kontrollon veten e tij dhe përgatitet për jetën e botës tjetër, kurse i paaftë është ai që ndjek epshin e vet dhe krijon iluzione se Allahu do ta falë."

### Rreth transmetuesit

Ebu Ja'la Shedad ibn Evs (r.a.), rrjedh prej një familjeje myslimanë, mjaft të njojur ndër sahabët për dijen dhe asketizmin. Ka transmetuar 50 hadithe nga Pejgamberi (a.s.). Të gjitha transmetimet gjenden në koleksionin e famshëm kutubu sitte.

Janë një grup faktorësh, si besimi, shpirti, shoqëria, shejtani, që ndikojnë në vlerësimin e kësaj bote apo botës së përtejme.

Kontrollimi i vetes dhe përpjekjet pér botën tjetër janë tregues të zgjuarsisë. Të mbash veten nën kontroll, së pari do të thotë të gjykosh veten para se të gjy-kohesh, siç mbëshetet edhe nga thënia e Omerit (r.a.): "Gjykoni veten para se të gjykoheni. Përgatituni pér ditën e madhe të gjykimit, sepse gjykimi në botën tjetër do të jetë i lehtë pér ata që në radhë të parë gjykojnë veten." Kurse Pejgamberi

(a.s.), në një hadith tjetër, thotë: "Vlera e vërtetë e veprave matet sipas pasojave që sjellin", pra sipas hadithit, mençuria dhe zgjuarsia e vërtetë e njerëzve do të evidentohen në ditën e madhe të gjykimit.

Simptomë e paaftësisë është ndjekja e epsheve dhe krijimi i iluzioneve të kota se do të falesh nga Allahu. Të gjithë ata që harxhojnë jetën pas epsheve të veta, u hapin krahët fantazive dhe ëndrrave të kota, sepse e vëtmja gjë ku mund të ngushëllohen, janë fantazitë.

Feja islame i inkurajon, i nxit besimtarët t'i luten Allahut (xh.sh.), pér çdo gjë. Por gjithmonë duke i marrë të gjitha masat që duhen pér të përbushur dëshirat. Kurse ai që ushqehet me shpresat të kota në kryerjen e diçkaje, pa bërë përpjekjet e duhura, nuk ka bërë gjë tjetër vetëm se ka gënjiyer veten e tij.

### Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Mençuria dhe largpamësia dallohen nga sjelljet dhe veprat.
2. I mençuri dhe jo i mençuri përkufizohen sipas perceptimit dhe vlerësimit që i bëjnë botës dhe ahiretit dhe sipas përgatitjes që bëjnë në këtë botë pér botën tjetër.
3. Pér të përfituar prej mëshirës së Allahut, duhet të kryejmë detyrat që na takojnë.
4. Duhet të kontrollojmë vazhdimisht veten.
5. Allahu (xh.sh.), shpërbolen veprat dhe jo shpresat e kota.





- NGA MORALI I I EVLIJAVE -

## TË JETOSH MORALIN HYJNOR

Atributi i Zotit "el-Vedud" do të thotë "Ai që do dhe duhet më shumë se gjithçka". Zoti e ka krijuar gjithësinë për shkak të dashurisë. Në qoftë se në gjithësi nuk do të shfaqej ky atribut hyjnor, atëherë kriesat nuk do ta donin njëra-tjetrën, asnjë nënë nuk do të kujdesej për fëmijën e saj. Si shenjë e mëshirës së Tij të pafund, Zoti ka bërë që të gjithë kriesat të mbërthehen me njëratjetren me lidhjen e dashurisë. Ashtu sikurse thuhet edhe në një hadith të Profetit, Zoti e ka zbritur një të njëqindtë e mëshirës së Tij në këtë botë. Nga kjo shfaqje e mëshirës në botë nëna ndjen dhembshuri që të ushqej fëmijën e saj me qumësh. (Buhari, Edeb, 19; Muslim, Tevbe, 17.)

Kështu që Zoti është burimi absolut i frysës së mëshirës që ekziston tek të gjitha kriesat. Nga ky kënd-vështrim, në gjithësi do të ballafa-qohemi me shprehje të panumërtë të gjurmëve të dashurisë hyjnore. Nuk ka dyshim se është shfaqje e atributit "Vedud" të Krijuesit edhe përkujdesja me të cilën gjarpërinxjtë që u kallin datën kriesave të tjera, rrisin të vegjlit e tyre, si dhe akrepët që mbajnë mbi shpinë të vegjilit e tyre apo edhe çdo lloj tjetër kafshe e egër që përballetë të vegjelëve të tij shndërrrohet në një vatër sigurie dhe dashurie.

Po kështu, si rezultat i begatisë së dashurisë hyjnore Zoti i do robërit e tij të devotshëm dhe bën që edhe njerëzit e tjerë t'i duan ata. Jeta dhe veprat e tyre vazhdojnë të jetojnë në kujtesën dhe zemrat e brezave të ardhshëm nëpërmjet ngjarjeve mësimdhënëse të jetës së tyre apo këshillave të tyre plot urtësi.

Njeriu tek i cili manifestohet dashuria hyjnore, përfshin brenda rrethit të tij të dashurisë në zemër para së gjithash Allahun dhe më pas çdo kriesë tjetër në varësi të afërsisë që ka me Zotin ajo kriesë. Besimtarë nuk do të arrijë kurrë besimin e përsosur, për sa kohë që dashuria e tij për Zotin të mos e kalojë çdo lloj tjetër dashurie që ai mund të ushqejë për kriesat e kësaj bote. Kështu edhe në Kur'an thuhet:

**"...Dashuria e besimtarëve për Allahun është përpara dhe përmbi çdo lloj tjetër dashurie..."** (Bekare, 165)

Për këtë arsy, njeriu duhet të kontrollojë si duhet dashurinë humane legitime që ai ushqen për fëmijët e tij, prindërit, vëllain, motrën dhe mitqtë e tij. Në të kundërt, ndjenja e dashurisë shndërrrohet nga një begati në një "fitne" dhe bën që zemrat e njerëzve të shuhën.

Prindërit, bashkëshortët, fëmijët dhe të gjitha të mirat e kësaj jete janë begatitë e mëdha që Zoti u ka mundësuar robërve të Tij. Vetëm se, dashuria që ushqehet për secilin prej tyre duhet të bëhet për hir dhe në rrugën e Zotit, sepse ata që i kthejnë zemrat e tyre në skllevër të mirësive kalimtare të kësaj jete, kanë për t'u privuar nga dashuria hyjnore, që është

burimi i të gjitha mirësive.

Dashuria dhe pasioni që është kaplimi i të gjithë ekzistencës si shenjë e rritjes së dashurisë ndaj saj, ndahet në **reale** dhe **alegorike**. Pasioni real konsiston në dashurinë ndaj Zotit dhe është kapitali më i madh në rrugën e takimit me Të, ndërsa pasioni alegorik është



**Ja Vedud**



dashuria dhe varësia ndaj krijesave. Dashuria alegorike e përjetuar brenda kritereve të pëlqimit hyjnor, është një shkallë drejt dashurisë reale dhe një lloj ushtrimi që rrit aftësinë e zemrës për të dashuruar. Rrëfimi i dashurisë mes Lejasë dhe Mexhnunit është një she mbull i kësaj kryevepre.

Në qoftë se zemra e Mexhnunit do të varej vetëm nga Lejlaja, ajo do të shndërrohej në një idhull për të, por Lejlaja luajti një rol kalimtar për Mexhnunin, zemra e të cilit arriti shkallën e konfidencës ndaj dashurisë hyjnore, duke e harruar më pas Lejlanë. Mexhnuni me të vërtetë që u nis udhës në kërkim të Lejasë, por më pas zemra e tij u dashurua pas Zotit dhe u vu në kërkim të Tij. Kështu, ajo u lirua nga të gjitha lidhjet që kishte me çdo gjë kalimtare dhe relative të kësaj bote. Mexhnuni nuk shihte dhe nuk mendonte asgjë përvëç Zotit. Të gjitha shijet dhe pasionet e kësaj bote kishin perënduar në sytë e tij përpara shijes shpirtërore të dashurisë hyjnore.

Kështu, njeriu i daldisur pas dashurisë hyjnore shpëton nga skllavëria ndaj qendrave të tërheqjes së kësaj jete kalimtare dhe nuk ka më zili për asgjë që posedojnë njerëzit. Në këtë mënyrë, ai arrin në perfeksionim dhe në destinacionin e dëshiruar. Kjo është dashuria hyjnore dhe pasoni i pastër.

Shkurtimisht, të gjitha llojet e dashurisë janë legitime dhe të vlefshme në varësi të shkallës së pranimit nga ana e Zotit të krijesës për të cilën ushqehet ajo dashuri. Mjafton që dashuritë relative të mos konkludojnë me dështim për zemrën në ndalesën e saj të fundit. Kërcënimi i vërtetë është afërsia që tregohet ndaj asaj që nuk meriton të dashurohet. Të gjithë njerëzit fitojnë një nivel të caktuar në varësi të vlerës që ka ajo që dashurojnë në këtë jetë.

Zhvillimi shpirtëror i njeriut nuk varet vetëm nga dashuria, por edhe nga e kundërtë e saj, nga armiqësia që duhet shfaqur në kushte të caktuara. Njeriu ka për të gjetur prehjen në rast se do dhe urren ato që meritojnë të duhen dhe të urrehen, ndërsa në rast të kundërt, ai ka për t'u kthyer në një krijesë të nënçmuar.

Në këtë kontekst, mesazhi që jep ajeti i Kur'anit i shpallur në lidhje me xhaxhain e Profetit, për të cilin thuhet: "**lu thafshin të dy duart Ebu Le-hebit! Kanë për t'u tharë!**" (Tebbet,

1) tregon se perfeksionimi i besimit do të arrihet edhe duke urryer atë që e meriton.

Në një ajet tjetër të Kur'anit sqarohet me këto fjalë domosdoshmëria e fokusimit të prirjes së dashurisë, që është natyrale, tek burimi i saj dhe merituesi më i madh i saj që është Zoti, si dhe kujdesi që kjo ndjenjë të mos çohet dëm, duke u përqendruar në gjërat kalimtare të kësaj jete:

**Thuaj: "Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndjeni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni deri sa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur."** (Tev-

be, 24)

Lum ata besimtarë, për të cilët dashuria për Allahun dhe të Dërguarin e Tij është më e rëndësishme se çdo lloj tjetër dashurie dhe nuk i mashtrojnë lulet mashtruese të kopshteve të egra.

Një tjetër atribut i Zotit është edhe Afuv, që do të thotë se Zoti është Falës i Madh. Besimtarët e përsosur, bazuar në parimin: "Ai që nuk di të falë të tjerët, nuk do të falet", tregohen falës ndaj robërve të Zotit,

në mënyrë që ata të meritojnë faljen hyjnore. Shndërrimi në shprehi e faljes së padrejtësive që të bëhen duke i konsideruar ato "të paqena", duke mos ndjerë as mërzinë dhe as pikëllimin më të vogël në zemër, është vepër e perfeksionimit shpirtëror dhe trimëria më e madhe morale.

Hallaxhi Mansur pati thënë këto fjalë, kur të tjerët po e mbysnin me gurë:

- O Zot! Përpara se të më falësh mua gjynahet, fali këta njerëz përfarë janë duke bërë!

Kur e kishin pyetur më parë se çfarë është moral, ai u qe përgjigjur:

*- Moral do të thatë të hedhësh pas krahësh shtypjen dhe padrejtësitetë përfir hir të Zotit.*

Njëri nga eviljatë e Zotit, Sami efendiu, sapo ishte diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë. Një evlja i Zotit, që kishte parë tek ai edukatën e thellë dhe karakterin e tij të dëlirë, e pati këshilluar me këto fjalë:

- Biri im! Arsimimi që ke mbaruar është shumë me vend, por mos harro të përfundosh arsimin tënd të vërtetë! Eja të të regjistrojmë në shkollën e tasavvufit, ku do të mësosh shkencat e shpirtit dhe enigmat e ahiretit.

Pastaj pati shtuar:

- Biri im! Unë nuk e di se si dhe çfarë do të mësojnë në atë shkollë, por di të them me siguri se mësimi i parë që ke përfunduar është **mos lëndo** askënd, ndërsa mësimi i fundit që ke përfunduar do të jetë **mos u lëndo nga askush.**

Ndonëse është shumë e vështirë që të arrish të mos lëndosh askënd në këtë jetë, prapëseprapë kjo është në dorë të njeriut të formuar shpirtërisht. Kurse, të mos lëndohesh nga askush, është gati-gati e pamundur. Në mënyrë që të mos lëndohesh, duhet t'i groposësh brenda në kraharor padrejtësitetë që i bëhen personalitetit tënd. Ky është marifeti i madh, por marifeti më i madh është të bësh zemrën që të heshtë. Gjuhën mund ta heshtësh, nëse ke vullnet përfunduar këtë gjë, por zemrën nuk mund ta kontrollosh dot me anë të vullnetit tënd, pasi zemra përherë do të flasë dhe do të cysë nga brenda. Të administrosh zemrën, kërkon një perfeksionim të madh moral dhe vendosmëri. Prandaj, të mos lëndohesh nga të tjerët, do të thatë të harrosh padrejtësitetë që mund të të kenë bërë vëllezërit e tu të fesë dhe të shkrish ftohjen që mund të jetë formuar përfundur shkak të atyre padrejtësive dhe e gjitha kjo arrihet falë aftësisë që ka besimtarë përfunduar të bëre zemrën e tij të heshtë përpëra devotshmërisë së tij të lartë. Për këtë arsy, në qoftë se **të mos lëndosh** është fillimi i rrugës së përshtypshme, **të mos lëndohesh** është konsideruar fundi i kësaj rruge.

Virtyti i shfaqur nga profeti Jusuf në këtë pikë është shumë mësimdhënës: vëllezërit e tij, që e kishin hedhur

Jusufin brenda në pus, pas shumë ngjarjeve që ndodhën më pas, më në fund e pranuan virtyshmërinë e tij të lartë dhe i thanë: "**Ti je Jusufi, Allahu të ka bërë ty më superior sesa ne.**" Nga ana e tij, Jusufi i kishte fashitur plagët e thella që i kishin shkakuar ata dhe u mjaftua duke u thënë atyre: "**Sot nuk kam përfunduar dhe përfunduar hakërryer.**" Më pas, përfunduar zemrat e tyre të pikëlluar u pati kujtuar se: "**Allahu është Mëshiruesi më i Madh.**"

Besimtarët e pjekur bëjnë më parë një autologaritje para së gjithash nëse e meritojnë apo jo atë ngjarje apo ndodhi që i bën të lëndohen. Kështu, ata fitojnë mundësinë që të përfitojnë shpirtërisht nga vuajtjet që kanë pësuar.

Një person, i cili një herë e një kohë më parë kishte qenë rrugaç, por më pas ishte shndërruar në një njeri të devotshëm, një ditë teksha po punonte në dyqanin e tij, ishte rrahur dhe plagosur paq pa këmbyer asnjë fjalë nga një person i panjohur që kishte hyrë në dyqanin e tij gjithë nervozizëm. Përpara kësaj situate, i devotshmi, që njëherë e një kohë kishte qenë vetë rrugaç, nuk i kishte kthyer dorë dhe nuk i ishte hakërryer agresorit të tij. Njeriu i nervozuar ishte larguar, por ishte kthyer pas një ore sërish, por këtë herë përfunduar falje se e kishte sulmuar padrejtësish duke e ngatërruar me një person tjetër. I devotshmi i qe përgjigjur :

- Jo, jo, t'i nuk ke bërë asnjë gabim! Unë e kam merituar këtë të rrahur, sepse edhe unë njëherë e një kohë kam rrahur sa e sa persona më të dobët se vetja ime, pa pasur arsyet të vërtetë. Prandaj unë e kam merituar të rrahurën tëndë. Haku që kam përfunduar do të vlejtar si kompensim përfunduar të tjerë që i kam rrahur pa të drejtë.

Çdo situatë duhet parë edhe nga një aspekt tjetër. Çdo fatkeqësi nuk ngjan sepse e meritojmë atë. Ndonjëherë një individ mund të pësojë një fatkeqësi, në mënyrë që ai të vëré mbi kokë aureolën e nëpërkëmbjes, në mënyrë që të fitojë nivele shpirtërore nëpërmjet durimit dhe në fund fare, të shpërbërëhet në jetën tjetër përfunduar treguar me vendimin e Zotit. Në qoftë se fatkeqësitë do të binin vetëm mbi personat që i meritojnë ato, të gjithë njerëzit do të bëhen të mirë me pahir dhe profetët nuk duhet të kishin përfunduar asnjë lloj fatkeqësie. E vërteta është se profetët kanë qenë personat që kanë vuajtur më shumë se të tjerët fatkeqësitë më të mëdha në këtë jetë. Përfunduar, ata kanë vuajtur, megjithëse kanë gëzuar cilësinë e pafajësisë.

Duhet menduar: vallë, me çfarë fytyre mund t'i kërkojnë falje Allahut ata persona të cilët nuk shprehin vullnetin që të falin robërit e Zotit dhe kanë një shpirt interesaxhi, egoist dhe të pandjeshëm? Sëmundja e mosfaljes së të tjerëve buron nga indiferenca që njeriu tregon ndaj vërvetes, pasi falës më i madh është Zoti. Besimtarët mund të falin të tjerët në varësi të dashu-

risë që ata ushqejnë në zemrat e tyre ndaj Allahut. Për këtë arsy, mosshfaqja e virtytit të faljes për arsy personale dhe ushqimi i smirës dhe hakmarrjes nuk i shkon aspak për shtat besimtarëve. Besimtarit i takon të ushqejë mëshirë ndaj njerëzve me të meta, në vend që të ushqejë hakmarrje për ta. Të ndjesh keqardhje për gjynahqarin për shkak të gjynaheve që ai kryen, është shprehje e perfektionimit të besimit. Besimtarët e vërtetë ekspozojnë ndaj besimtarit që kryen një gabim, madje edhe kur ai gabim i dëmton ata personalisht, atë qëndrim që ekspozon mjeku ndaj pacientit të tij. Asnjë doktor nuk hidhërohet me pacientin e tij që është sëmurë, edhe nëse ajo sëmundje ka ardhur si pasojë e gabimit të tij, por e konsideron veten të detyruar dhe përgjegjës për shërimin e sëmundjes së tij. Evlijatë që jetonin me këto parime morale nuk ua reflektojnë gjunahqarëve urrejtjen që ata ndjenin ndaj mëkatit në vete. Ata i konsideronin gjynahqarët si zogj të plagosur dhe përpinqeshin t'i shëronin brenda sarajeve të tyre të shpirtit.

Kur e patën pyetur Sehli Tus-terin se çfarë ishte morali, ai u qe përgjigjur :

"Niveli më i ulët i moralit është të përballosh shtypjen që të bëhet pa ushqyer në zemër dëshirën për hakmarrje, të më-shirosh personin që të bën ty padrejtësi dhe të të dhimbset në atë shkallë sa të kërkosh prej Zotit që ta falë atë." (Ihja, III, 163)

Sa bukur e ka shprehur ky hadith i raportuar nga Enes ibn Maliku faktin se ai mysliman që arrin këtë nivel shpirtëror ka për të qenë udhëtar drejt xhenetit:

Po qëndronim së bashku me të Dërguarin e Allahut (a.s.). Profeti tha:

- Tani do të vijë në mesin tonë një njeri që do të jetë në xhenet në jetën tjetër.

Ne pritëm dhe pamë se erdhi një sahab nga ensa-ri, të cilit po i rridhite nga mjekra uji i abdesit dhe po i mbante këpucët në dorën e majtë. Ditën e nesërme, Profeti (a.s.), përsëriti të njëjtat fjalë. Pritëm dhe erdhi sërisht i njëjti person. Kjo u përsërit edhe ditën e tre-të. I Dërguari i Allahut u ngrit e shkoi dhe Abdullah ibn Amr u ngrit dhe e ndoqi atë person dhe kur e mbërriti e pyeti:

- Jam zënë me babain tim dhe u betova se nuk do të shkoj ta takoj për tri ditë. A pranon të më mbash si mysfir në shtëpinë tende gjatë këtyre tri ditëve.

Personi pranoi. Pastaj, Abdullah ibn Amr (r.a.), rrëfen:

- Kam jetuar tri net në shtëpinë e tij. Nuk ishte se ai falte namaze gjatë natës me orë të gjata. Vetëm se aty afër agimit zgjohet dhe bënte ziqr. Nuk e kam dëgjuar që të thoshte fjalë tjetër përvçe fjalë të hajrit. Pas tri netësh, në sytë e mi ai person nuk ishte më një person i ndryshëm nga unë nga aspekti i ibadeteve. E pyeta:

- O rob i Zotit! E vërteta është se nuk jam grindur me babain tim. Arsyja përsë kërkova të banova këto tri net në shtëpinë tende ka të bëjë me faktin se i Dërguari i Allahut për tri ditë me radhë pati thënë se personi që do të vinte i pari në xhami ka për të hyrë në xhenet në jetën tjetër dhe çdo herë personi i parë që vinte në xhami ishet. Desha të qëndroja pranë teje që të mësoja se çfarë veprash bën ti dhe të kryeja edhe unë të njëjtat gjëra që të meritoja të hyja në xhenet, por pas tri netësh nuk kam parë se ti bën ndonjë punë të ndryshme nga ato që bën çdo mysliman i mirë. Vallë, për çfarë arsyje e ke mbërritur shkallën e lartë të cilën e ka paralajmëruar i Dërguari i Allahut për ty?

Ai u përgjigji:

- Unë nuk kryej asnjë ver-pim tjetër, përvëç atyre që ti ke parë me sytë e tu.

Teksa po bëhesha gati të largohesha, ai më bëri zë dhe më tha:

- Unë nuk bëj asgjë më shumë se sa bën një mysliman i rregullt në jetën e tij, por nuk i mbaj as mërinë më të vogël ndonjë mysliman dhe nuk ia kam zili asnjë personi begatitë dhe mirësitë që i ka dhuruar Allahu.

- Ja pra, - i thashë unë, - përkëtë arsy t'i ke arritur gradën për të cilën të ka përgëzuar

Allahu. (Ahmed, III, 166.)

Edhe ngjarja e mëposhtme e shpreh shumë bukur madhështinë e moralit të faljes së të tjerëve:

E pyetën Ahnef ibn Kajsin:

- Prej kujt e mësuat moralin e hijshëm?
- Prej Kajs ibn Asimit. - u përgjigj ai.
- Çfarë moral kishte ai? - e pyetën.

- Ky njeri, një ditë po rrinte në shtëpinë e tij, kur një moment hyn brenda njëra nga skllavet e tij me një shish hekuri të mbushur me qebape. Kur, padashur, shishi i bie nga dora mbi kokën e foshnjës së vogël që për pasojë edhe vdes. Skllavja u tmerrua për atë që ndodhi dhe nuk e donte veten më. Ai person, në vend që të nervozohej dhe të fillonte t'i hakërrhej skllaves së tij për atë që bëri, i tha: "Mos u mërzit! Çdo gjë është caktimi i Zotit! Ti nuk je fajtore, sepse nuk e ke bërë qëllimiشت këtë



**Allahu im, s'ka dyshim se Ti je Falës,  
e do faljen, më fal mua!**

gjë! Unë vendosa të ta fal lirinë për shkak të tronditjes shpirtërore që pësove." (Ihya, III, 164)

Nga ana tjetër, nuk duhet harruar se besimtari i cili ka për qëllim të fitojë faljen e hyjnored duke ua falur të tjerëve gabimet dhe fajet që i kanë bërë, ka për të marrë pjesë nga morali hyjnor i atributit hyjnor **Tevvab**, duke ua pranuar lutjet përfalje që i drejtuanë ata të cilët i kanë bërë keq dhe padrejtësi.

Një nga atributet e tjera hyjnore është **Halim**. Zoti është i Butë, sillet shumë butë me robërit e Tij dhe tregon durim dhe vetëpërmajtje shumë të madhe ndaj fajeve dhe gabimeve të robërve të Tij, në vend që të nxehet dhe t'i dënojë ata. Zoti ynë është i kënaqr, në qoftë se robërit e Tij shfaqin të njëjtën edukatë në marrëdhëniet e tyre me të tjerët. I Dërguari i Allahut i pati thënë kështu Eshexhit nga Benu Abdulkaisit:

- *Ti ke dy shprehi që Allahu i do shumë: Je njeri i butë dhe i ekilibruar.* (Muslim, Iman, 25, 26.)

E kundërtë e butësisë është vrazhdësia, një shprehi e keqe që i bën të tjerët të fyhen, ua kall datën më të dobëtve prej tyre dhe i bën më të fortët të tëurrenjë dhe të distancohen prej teje. Për këtë arsy, butësia ka qenë njëra nga cilësitet e profetëve. Disa rabinë hebrej që e dinin këtë gjë nga librat e tyre, shkuan dhe deshën ta sprovojnë Profetin (a.s.), në lidhje me këtë gjë dhe kur panë detin e butësisë që kishte ai në shpirt, vendosën dhe u bënë myslimanë.

Allahu urdhëron dhe thotë:

**"Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta** (o Muhamed). **Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ata..."** (Al'l'mran, 159)

I Dërguari i Allahut ka qenë njeriu më i butë në botë. Kjo bënte që ai të zgjidhte përherë më të kollajshmen në marrëdhëniet që krijonte me njerëzit dhe të mos linte vend përvështirësi, nervozizëm dhe mëri. Atë nuk e nxehet asgjë, me përjashtim të shkeljes së të drejtës dhe i falte përherë gabimet që të tjerët bënë kundër personit të tij. Sado me vrazhdësi të sillej personi që kishte përballë, ai nuk e prishte qëndrimin e tij **të sjellshëm** dhe ia kthente me të mirë atij që sillej me të me të keq.

**Llukmani i Urtë** ka thënë :

- Biri im! Tri gjëra mësohen para tri situatave: Butësia përpëra nxehjes, trimëria përpëra betejës dhe vëllazëria përpëra nevojës.

Pra, njeriu ka nevojë më shumë se në çdo rast të tregohet i butë në situata kur njeriu normal nxehet dhe nevrikoset dhe në vend të mendjes komandon ndjenja. Të dish t'i vësh fre egos në këtë situata, kërkon perfekcionim shpirtëror. Profeti ka thënë:

**"Trim nuk është ai që mund kundërshtarin e tij në betejë, por ai që mund mërinë e tij në momentin që**

nevrikoset."

(Buhari, Edeb, 76; Muslim, Birr, 107, 108)

Profeti (a.s.), sillej përherë me butësi dhe mirëkuptim me ata beduinë që kishin pranuar fenë islamë, por ende nuk kishin gjetur mundësinë të mësonin edukatën e fesë. Ngjarja në vijim është një shembull tipik i kësaj:

Një beduin erdhi dhe urinoi në një cep të xhamisë së Profetit (a.s.). Sahabët i ngritën që ta qortonin ashpër. Profeti (a.s.), u tha atyre:

- *Lëreni dhe mos u merrni me të. Pastrojeni vendin që ka bërë pis, duke derdhur një kovë ujë aty. Jujeni dërguar të lehtësoni, jo të nxirri problem.* (Buhari, Vudu 58, Edeb 80)

Njëri nga personalitetet e tabiinëve, imam Shabi, personit gjynahqar që e kishte fyer me fjalë të rënda i që përgjigjur me këto fjalë të rralla butësie, në vend që të nxehet dhe nevrikosej me të:

- *Në qoftë se këto që thuajanë të vërteta, Allahu më faltë! Në qoftë se ti je gënjeshtar, Allahu të faltë!*

Shkurtimisht, butësia dhe mirëkuptimi janë rezultat i virtyteve të mëshirës, dhembshurisë dhe dashurisë dhe thelbi i natyrës së Profetit (a.s.), dhe urdhrit hyjnor të Zotit. I Dërguari i Allahut ka thënë:

- *Ai që është i butë nga natyra, i ka falur Zoti shumë mirësi. Ai që nuk është i butë nga natyra, është privuar nga shumë mirësi.* (Tirmidhi, Birr, 67/2013)

Ashtu si gjithë virtytet e tjera edhe butësia dhe mirëkuptimi kanë një masë. Të ulësh kokën përpëra padrejtësisë në emër të butësisë apo të tregoshë mirëkuptim përpëra moskryerjes së urdhavrave të Zotit, nuk është aspak e lejuar. Kjo lloj sjelleje, që në gjuhën e popullit quhet edhe "butësi prej gomari", është një qëndrim totalisht i gabuar, sepse në këto raste shtihet edhe dëshira dhe guximi i keqbërësve përfshirë punë të mbrapshta.

Një tjetër atribut i Zotit është edhe Settar. Zoti një të gjitha veprimet e njerëzve, qofshin ato të kryera publikisht apo privatish dhe me mëshirën e Tij ka falur sa e sa gjynahe dhe faje të tyre. Kjo është një mundësi që u jepet atyre përfshirësuar, sepse personi i cili ekspozohet publikisht me gjynahet dhe fajet e bëra, do ta ketë të vështirë të pranojë të përmirësohet.

Myslimani duhet të distancohet fuqimisht nga humutimi i gabimeve dhe fajeve të vëllezërve të tij myslimanë. Vetë Zoti e ka ndaluar këtë sjellje të shëmtuar, duke urdhëruar dhe thënë: **"...Mos i hulumtoni gabimet dhe fajet e të tjerëve!"** (Huxurat, 12)

Rrëfimi i gjynaveve që kanë bërë të tjerët, a thua se është ndonjë marifet i madh, nënkuption përhapjen e të keqes. Veçanërisht në kohët e sotme, manifestimi i një lloj mashtrimi plot dinakëri, a thua se kjo është aftësi e madhe, është një gjynah shumë i madh, madje edhe më i rëndë sesa gjynahet e vepruara. Kjo do të thotë se përhapja me anë të fjalëve të sjelljeve të

pahijshme në mesin e shoqërisë, bën që mendjet e njerëzve të merren me këto lloj veprimesh dhe kjo është shumë e rrezikshme, sepse rrit edhe më shumë rrezikun e kryerjes së tyre nga të tjerët. Allahu i ka paralajmëruar me një dënim të dhimbshëm ata që përpiken të përhapin në mesin e njerëzve sjelljet e mbrapshta dhe gjynaqare. Personi që kryen një vepër të ndaluar, pendohet për atë që ka bërë dhe për këtë arsy e fsheh atë, shpresohet se nuk do të turpërohet në Ditën e Kiametit për shkak të atributit "Settar" të Allahut.

Nga ana tjetër, duhet menduar edhe se Zoti, për hir të atributit të Tij, Settar, ka mbuluar sa e sa gjynahet tonat dhe i ka lënë ato si pika të zeza në zemrat tona. Kjo është shprehje e pafund e madhështisë, mëshirës dhe faljes së Zotit. Në qoftë se gjynahet do të ishin pika të zeza në ftyrë dhe jo në zemër, nuk ka dyshim se askush nuk do të kishte ftyrë të vështronte personin tjetër.

Nuk duhet harruar se zemrat janë vendsositje hyjnore. Sado të meta dhe gabime të ketë bërë një person, nuk duhet qëmtuar që të mësohen dhe të nxirren në shesh ato, sepse kështu do të shkaktohet thyerja e zemrës së tij dhe kjo bën që të meritojë dënimin e Zotit. Të rrëfesh ato situata që dobësojnë nderin dhe dinjtetin e njerëzve, duke dashur që në këtë mënyrë të tregohesh në sytë e të tjerëve se sa i mirë je, është një qëndrim shumë i ulët dhe bën që sa e sa vepra të mira të kryera të shkojnë dëm në peshoren hyjnore.

Në qoftë se dëshirojmë që Zoti të na i mbulojë gabimet dhe të metat tona në mejdanin e mahsherit, atëherë duhet që edhe ne t'ua mbulojmë gjynahet dhe gabimet e robërve të Tij në këtë jetë dhe të përpinqemi të mos i fyejmë apo t'i vëmë në pozitë të keqe duke ua bërë publike. Ja edhe një rast që tregon se ç'kryevepër është kjo ndjeshmëri shpirtërore:

Hatemi Asam po bashkëbisedonte me një grua të dobët, të thyer shpirtërisht dhe me halle shumë. Teksa gruaja po ia rrëfente me shumë emocion situatën e rëndë në të cilën gjendej, pa dashje nuk e mbajti dot veten dhe lëshoi një zhurmë të lehtë. Në këtë situatë gruaja u shkri si një qiri dhe nuk e deshi veten më. Shehu

e ruajti qetësinë, nuk i la gruas të kuptonte se kishte kuptuar gjë dhe duke i treguar me gisht nga veshët i tha asaj:

- O motë! Ngrije më shumë zërin, se nuk dëgjoj mirë. Mua kanë filluar të më lënë veshët.

Gruaja kujtoi se ajo që kishte ngjarë nuk ishte kuptuar dhe mori frymë thellë, a thua se kishte lindur për herë të dytë.

Kjo **mirësjellje** e paparë në edukatën e asnjë populli tjetër, bëri që sheh Hatemin sot e tutje ta quanin Asam, që do të thotë Shurdhi. Madje Hatemi nisi të sillej si shurdh edhe me njerëzit e tjerë që bashkëbisedonte, në mënyrë që gruaja të mos e merrte vesh se ai e kishte dëgjuar. Vetëm pasi mori vesh se ajo grua kishte vdekur, ai nisi t'u thoshte bashkëbiseduesve të tij:

- Unë dëgjoj mirë nga veshët, kështu që mund të flisni me mua me zë normal.

Përfolja e të metave dhe gabimeve të njerëzve të tjerë, fatarisht është konsideruar përgojim ose gibet dhe si një nga mëkatet e mëdha. Për më shumë, përgojim do të thotë përfolja e një veprimi apo situatë që ka ndodhur me të vërtetë, ndërsa përgojimi i një veprimi apo situate që nuk ka ndodhur me të vërtetë konsiderohet "shpifje".

Shkurtimisht, marrja hise nga morali hyjnор dhe përthithja e saj thellë në shpirt, hap rrugën për virtute madhështore. Atributet e Zotit arrijnë të shfaqen vetëm tek besimtarët që e kanë purifikuar egon dhe e kanë pastruar tërësisht zemrën e tyre. Prandaj besimtari mund të shndërrohet në pasqyrën ku pa-sqyrohet morali hyjnор në masën që ai arrin të pastrojë botën e tij të brendshme nga të gjitha negativitetet dhe nga çdo sjellje dhe veprim që e mbajnë larg Allahut.

Përcjellja e madhe e atributeve të Zotit, që i treguan më sipër, duke i shndërruar ato në një pjesë të pandarë të personalitetit dhe karakterit, është viza e besimtarit për të hyrë brenda atmosferës së miqësisë me Zotin.

Zoti na bëftë nga robërit fatlumë, që arrijnë të marrin fermanin e lumturisë së përjetshme, duke marrë hise nga morali hyjnор!



# MOSMARRËVESHJET MES VENDEVE MYSLIMANE DHE RRUGËT E ZGJIDHJES SË TYRE NË DRITËN E KURANIT DHE TË SUNETIT

Prof. dr. Hamdi Dëndyren

Duket qartë se insitucionë të tillë ndërkombëtare, si Kombet e Bashkuara, Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara etj., të cilat përbëhen në shumicë nga shtete jomyslimane nuk arrijnë t'u japid zgjidhje problemeve sociale, madje as masakrave humane që përfjetohen sot në botën islame. Në këto raste të jashtëzakonshme ajetet 9 dhe 10 të sures Huxhurat i japid përgjigje pyetjes nëse është e mundur të gjejmë një zgjidhje në lidhje me këtë problem në dritën e Kuranit dhe të Sunetit. Ja se si:

Në rast se ndodh një konfrontim fizik ndërmjet dy popujve apo shteteve me shumicë myslimane, atëherë kërkohet që në mes tyre të ndërhyjë një forcë e tretë që do të arrijë të zgjidhë mosmarrëveshjen mes tyre. Në ajetin 9 të sures Huxhurat thuhet:

**"Nëse dy palë besimtarësh bëjnë luftë midis tyre, pajtojini ata. Por, nëse njëra palë sulmon tjetrën, atëherë luftoni kundër sulmuesit, derisa të kthehet në urdhrat e Allahu. E, nëse kthehet, atëherë pajtojini ata midis tyre, me drejtësi dhe paanësi,**

**sepse Allahu i do ata që veprojnë me drejtësi."**

Në ajetin e mësipërm mësohen besimtarët se si të veprojnë në rast se dy bashkësi myslimane konfliktohen me njëra-tjetrën, duke i mësuar ata që të parandaljnë konfrontimet që mund të dalin mes dy bashkësive. Në rast se njëra palë sulmon e para mbi palën tjetër, të rreshtohen me palën që është sulmuar deri sa pala sulmuese të kthehet në urdhrat e Zotit dhe kur ata të jenë të kënaqur me urdhrin e Zotit, të gjendet



zgjidhja e mesme mes dy palëve, të mos anashkalohet asnjëherë drejtësia, sepse Allahu i do të drejtët.

Në rast se mendojmë në lidhje me një konflikt që lind mes shteteve myslimanë, kërkohet që një palë e tretë në këtë rast duhet të bëjë punën e ndërmjetësit, duke u vënë në kërkim të arritjes së paqes mes tyre. Në qoftë se pala sulmuese nuk sprapset nga sulmet e saj, kërkohet që me palën e sulmuar të bëhet palë një fuqi e tretë, në mënyrë që të vendoset barazia në luftë dhe palët të detyrohen të bëjnë paqe me njëra-tjetrën. Kur të ndalen sulmet, kërkohet që të ndërtohet mbi "parimet e drejtësisë" një paqe e qëndrueshme nëpër-mjet së cilës palët do të kompensojnë edhe dëmet e shkaktuarë.

Kështu që shtetet islame duhet të mendojnë se-riozisht në lidhje me formimin e një force të tretë në mesin e tyre, që do të funksiononte si të ishte "Lidhja e Kombeve" për shtetet myslimanë. Prandaj edhe komentatori i Kuranit, Ebu Hajani i ka komentuar shpreh-jet "luftoni" dhe "bëni paqe", që përmenden në ajetin e mësipërm si domosdoshmëri e ndërmjetësimit të "personave të autorizuar për këtë gjë" brenda një shteti. (Ebu Hayyan, Bahr, VIII, 112; Elmalili, Tefsir, VII, 201.) Për zgjidhjen e problemeve dhe mosmarrëveshjeve që mund të krijohen në periudha kur ekzistojnë më shumë sesa një shtet i vetëm mysliman, nuk ka dyshim se sa e nevojshme është ekzistencë e një force të tretë. Për këtë arsy, të gjithë shtetet myslimanë ose, nëse kjo nuk është e mundur, një pjesë e madhe e tyre duhet

të bashkohet për të formuar një insitucion unitar.

Në këtë rast lind edhe e drejta e ndërryrjes së një "Force paqeje të shteteve të bashkuara islame" në rastet kur tronditen nga themellet të drejtat e njeriut, liria e tij e fesë dhe e ndërgjegjës në një shtet mysliman apo kur një shtet mysliman, në vend që të mbrojë "liranë e pasurisë, jetës, nderit dhe fesë", në të vërtetë



i shkel haptazi ato. Pas kësaj ndërryrjeje duhen hedhur hapat e duhur për formimin e një drejtimi të drejtë brenda një afati kohor logjik. Në këtë mënyrë shtet mysliman duhet të gjejnë mundësinë të zgjidhin problemet e tyre politike pa pasur nevojë të përdorin ndërmjetësimin apo fuqinë e paqes së shteteve të tjera jomyslimane.

Në rast se në një shtet mysliman kriza politike shndërrrohet në destabilitet të vendit, atëherë zbatohen urdhrit e mëposhtëm:

Krimi i mosbindjes ndaj shtetit: Ajeti 9 i sures Huxurat që u përmend më sipër, u shpall kur Abdullah ibn Ubej, lideri i mynafikëve, e pati fyer rëndë me fjalë Profetin Muhamed. Atij i qe kundërpërgjigjur me të njëjtën monedhë Abdullah ibn Revaha dhe atëherë mes përkrahësve të dy palëve patën ngjarë edhe konflikte të armatosura. Kur Profeti pati lexuar ajetin e mësipërm, të dy palët patën bërë paqe me njëra-tjetrën.

Fjala e përdorur në Kur'an dhe që tregon anarkinë është fjala **bag'j**, që do të thotë tejkalim i kufirit, sulm, të pretendosh të bëhesh prijës aty ku nuk të takon. Ndërsa si term i së drejtës islame do të thotë kundërshtim me forcën e armëve të prijësit të një shteti mysliman, duke pretenduar se e vërteta është në anën e palës kryengritëse, që mbështetet për këtë në një opinion ose argument që beson se është në favor të saj. Havarixhët të cilët patën shpalosur flamurin e mosbindjes ndaj Aliut kanë qenë të tillë.

Në hadithe thuhet: "Ai që nxjerr armët kundër nesh, nuk është mysliman." (Buhari, Fitën, 7; Muslim, Iman, 161, 163.) "Ai që nuk i bindet prijësit të shtetit mysliman, ndahet nga bashkësia e tij myslimanë dhe vdes si i tillë, do të konsiderohert se ka vdekur në periudhën e xhahiljetit." (Buhari, Fitën, 2; Ebu Davud, Sunnet, 37.)

Në raste të mosbindjes kryhen faje që një pjesë konsiderohen **had** dhe një pjesë konsiderohen **tazir**. Për sa kohë që konfrontimi nuk është i armatosur, shteti ka të drejtë të mos dënojë palën opozitare për veprimet e saj, si marshim proteste, kritikë publike, paralajmërim etj. Në rast se konstatohen veprime që prishin rendin publik, mund të zbatohen dënimë të llojit **tazir**. Të gjithë dijetarët myslimanë janë të një mendimi kur shprehen se shteti ka të drejtë të përdorë forcën e tij, në rast se përballet me konfrontim të dhunshëm apo të armatosur. Për më tepër që në ajetin e mësipërm thuhet: "**Luf-toni kundër palës sulmuese...**" (Huxurat, 9) Vetëm se në këtë rast më parë duhet bërë "paralajmërimi me fjalë" dhe më pas "paralajmërimi me qitje në ajër". Kështu, Aliu pati dërguar Ibn Abasin tek havarixhët për t'i paralajmëruar ata dhe pas takimeve të gjata pati arritur t'i bindte katër mijë myslimanë të hiqnin dorë nga kryengritja që po organizonin, por megjithatë nuk arriti të shmanget konfliktin e armatosur me pjesën

tjetër. (Askalani, Bulugu'l-Meram, III, 560, 561.)

Për betejën e Sifinit, një nga shembujt më të dhimbshëm të konfrontimit të armatosur të dy ushtrive myslimanë me njëra-tjetrën, vlen të përmendim këtu një qasje që i pati bërë problemit profesor Muhamed Hamidullah gjatë një konference të mbajtur në fakultetin e Letërsisë së universitetit të Stambollit në vitin 1968. Një ditë të rëndësishme të luftës së Sifinit, që ndodhi në vitin 657 (37 Hixri) në afërsi të Rakas në bregun e djathtë të lumit Eufrat mes haliftës katërt Ali dhe valiut të Sirisë Muavijes, kur u thirr ezani për namaz të dy palët ndërpresin luftimet dhe tërhiqen që të falin namazin. Pasi falin namazin, njëri prej sahabëve e pyet Aliun: "O Al! Të dy palët falën namazin. Ende nuk i kemi varrosur të vrarët tanë. Të vrarët e cilës palë janë shehidë dhe do të shkojnë në xhenet?" Kësaj pyetjeje të vështirë Aliu i jep këtë përgjigje, ndërsa nga sytë i rrëdhënë lotë: "Të vrarët e të dy palëve janë shehidë dhe do të shkojnë në xhenet, sepse të dy palët luftojnë në emër të asaj që e konsiderojnë më të saktë dhe më të drejtë. Ata që kanë muaj dhe vite që përgatisin terrenin që këto dy ushtri të konfrontohen me armë me njëra-tjetrën, duke u bërë shkaktarët e kësaj lufte, nuk e di se çfarë llogarie kanë për të dhënë në jetën tjetër!" Kjo përgjigje ruan ende aktualitetin e saj për rastet e konflikteve që ndodhin edhe sot në mesin e shteteve myslimanë.

Të plagosurit dhe robërit e pallës kryengritëse të myslimanëve nuk vritten, ata që po arratisen nuk ndiqen nga pas dhe pasuritë e tyre nuk konsiderohen plaçkë lufte. Në rast se janë dëmtuar pasuritë e tyre apo për të vrarët nga ana e kryengritësve, shteti nuk ka detyrim të bëjë kompensime, sipas hanefive. (Serahsi, Mebsut, I, 128; Kasani, Bedaji, VII, 141; Ibn Humam, Feth, IV, 414.)

Në ajetin 10 të sures Huxurat këshillohemë me këto fjalë, në lidhje me prodhimin e zgjidhjeve së të gjithë mosmarrëveshjeve prej individit deri tek shoqëria, duke u bazuar në besimin e përbashkët që kanë palët që konfliktohen mes tyre:

**"Besimtarët janë vëllezër me njëri-tjetrin. Prandaj pajtojini ata dhe kjeni frikë Allahun, në mënyrë që Ai t'ju mëshirojë juve!"**

Teksa formonte vëllazërinë mes besimtarëve në Medine, Profeti Muhamed (a.s.), pati treguar kujdes të posaçëm që kjo vëllazëri të institucionalizohet nëpërmjet dashurisë së ndërsjellë, respektit dhe interesave personale të çdo pale.

Në ajetet 71 dhe 72 të sures Tevbe, cilësitë e besim-



tarëve me të cilët Allahu është i kënaqur radhiten në këtë formë: a) Të gjithë besimtarët dhe besimtarët janë miq dhe mbrojtës për njëri-tjetrin. Ata dhe ato janë në bashkëpunim, mbështetje dhe përgjegjësi të plotë ndaj njëri-tjetrit. b) Ata urdhërojnë për punë të mira dhe ndalojnë për kryerjen e punëve të këqija. c) Ata falen rregullisht. d) Ata jasin zeqatin. e) Ata i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

Jas si përcaktohen cilësitë e besimtarëve në hadithet e Profetit:

*"Myslimani është i sigurt nga dora dhe gjuha e myslimanëve të tjerë. Besimtarët janë të sigurtë se nuk do t'i dëmtojë fizikisht apo në pasuritë e tyre." (Tirmidhi, Iman, 12; Nesai, Iman, 8; Ibn Maxhe, Fitën, 2, Ahmet b. Hanbel, III, 154.). "Askush prej jush nuk do të ketë besuar, në qoftë se nuk do përvillain e tij të fesë atë që dëshiron edhe përveten e tij." (Muslim, Iman, 71,72; Buhari, Iman, 7;*

Tirmidhi, Kijame, 59, Iman, 19, 33; Ibn Maxhe, Mukaddime, 9.) "Nuk do të hyni në xhenet, përsakohë që nuk do të besoni. Nuk do të besoni, përsakohë që nuk e doni njëri-tjetrin."

(Muslim, Iman, 93,94; Ebu Davud, Edeb, 131; Tirmidhi, Istidhan, 1, Kijame, 56; Ibn Maxhe, Mukaddime, 9, Edeb, 11.) "Ka tri gjëra që, po nuk u përmblushën, askush nuk ka përtash shijuar shijen e besimit: a) Ta duash Allahun dhe të Dërguarin e Tij më shumë se çdo gjë tjetër.

b) Ta duash tjetrin vetëm përhir të Allahut c) Ta konsiderosh kthimin në mosbesim të barabartë me hedhjen në zjarr." (Buhari, Iman, 9)

Në hadithet e Profetit thuhet edhe se: "Asnjëri prej jush nuk do të konsideroheni se keni besuar me të vërtetë, në qoftë se nuk dëshironi përvillain tuaj të fesë atë që do të dëshironit përveten tuaj." (Buhari, Iman, 7.) "Myslimani është vëllai i myslimanit. Ai nuk e dhunon atë dhe nuk ia dorëzon armikut. Atij që zgjidh një nevojë jetike të vëllait të tij në këtë jetë, Allahu do t'i zgjidhë një nevojë që do të ketë në jetën tjetër. Atij që mbulon një të metë të vëllait të tij në këtë jetë, Allahu do t'i mbulojë turpet e tij në jetën tjetër. Myslimani e ka haram jetën, pasurinë dhe nederin e myslimanit tjetër." (Buhari, Medhalim, 3.)

Në një hadith që raporton Ebu Hurejre (r.a.), radhiten në këtë formë vlerat morale universale: "Mos e kini zili njëri-tjetrin. Mos u mundoni të fitoni myshteriun e tjetrit pa të drejtë. Mos u nxehni me njëri-tjetrin. Mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit. Orobërit e Allahut, bëhuni vëllezër me njëri-tjetrin. Myslimani është vëllai i myslimanit. Ai nuk e dhunon atë, nuk e lë pa ndihmë dhe nuk



e nënvleftëson atë. Devotshmëria gjendet këtu (dhe tregoi tri herë me duar kraharonin). Që një mysliman të quhet i keq, mjafton që ai ta nënvleftësojë vëllain e tij të fesë. Myslimani e ka haram jetën, pasurinë dhe nderin e myslimanit tjetër." (Muslim, Birr, 32.) Në një hadith që transmeton Ebu Said el-Hudri (r.a.), shprehet me këto fjalë fakti se dashuria e ushqyer për ensarët është kusht i besimit: "Ta duash ensarin është shenjë e besimit, ndërsa ta përbuzësh atë është shenjë e mynafikut." (Ahmet bin Hanbel, III, 70, 133, V, 285, VI, 7.)

Feja islame e ka shpallur vëllazërinë fetare superiore ndaj vëllazërisë së gjakut. Për këtë arsy, në beteja siç qenë ato të Bedrit dhe të Uhudit, të afërmët nga gjaku madje edhe babai me birin e tij, qenë ndeshur në anët e kundërtë të dy ushtrive. Kjo ka pasur vlerë edhe përfetë e tjera monoteiste të shpallura para fesë islame. Shembuj në lidhje me këto kemi konfliktin mes dy bijve të profetit Adem, Kabilit dhe Habilit (Maide, 27-31) apo refuzimi nga ana e Allahut të duasë së profetit Nuh për birin e tij, që nuk besonte tek Zoti dhe ishte politeist. (Hud, 45-46)

Sipas së drejtës islame, dallimi në besime mes antarëve të një familjeje ndikon edhe në çështje të së drejtës familjare, siç janë kujdestaria, trashëgimia, ndarja e pasurisë e të tjera si këto. Në Kuran bëhet e qartë se pasardhësit ateistë nuk gëzojnë të drejtë kujdestarie ndaj pjesëve të bashkëpronarëve: "**O besimtarë! Mos i pranoni për mbrojtës baballarët dhe vëllezërit tuaj, nëse ata e duan mosbesimin më shumë sesa besimin. Kushdo prej jush që i merr ata për mbrojtës, është keqbërës.**" (Tevbe, 23) Në një ajet tjetër kërkohet qartazi mosbindja ndaj prindërve në rast se ata kérkojnë nga fëmija i tyre që të mos besojnë tek Allahu. (Anketbut, 8) Teksa ndalohet për besimtarët që të bëhen miq, mbrojtës apo të zgjedhin si prijës të tyre ateistët dhe politeistët (Nisa, 89-144; Mumtehine, 1; Maide, 57), nga ana tjetër kërkohet prej tyre të veprojnë si të ishin një trup i vetëm kur u thuhet: "Besimtarët të mos i marrin për miq e mbrojtës mohuesit, në vend të besimtarëve. Ata që veprojnë kështu, nuk kanë çfarë të shpresojnë tek Allahu, vetëm nëse këtë e bëjnë (me gojë e jo me zemër) për t'u ruajtur nga ata. Allahu ju paralajmëron

që t'i ruheni Vetes së Tij."(Al 'Imran, 28)

**"Ai jua ka shpallur në Libër: Kur të dëgjoni se mohohen fjalët e Allahut dhe bëhet tallje me to, atëherë mos rrini me ata** (njërz që veprojnë kështu), **derisa të ndërrojnë bisedë, përndryshe do të ishit si ata. Allahu do t'i tubojë në Xhehenem të gjithë hipokritët dhe mohuesit."** (Nisa, 140)

Pra besimtarët duhet të mbështesin njëri-tjetrin, si në planin individual, në atë kombëtar, madje edhe në atë ndërkombëtar, duke kërkuar pikërisht tek kjo mbështetje burimin e forcës, fuqisë dhe dinjitetit të tyre. Historia ka treguar se shtetet myslimane që kanë dashur të mbështeten tek shtetet jomyslimane, si në aspektin e mbrojtjes, ashtu edhe të zhvillimit të tyre brenda një kohe të shkurtër kanë parë se u kanë rrjedhur fuqitë që kanë dhe kanë përjetuar humbje mundësish materiale dhe morale me kalimin e kohës. Në rastet kur bashkëpunimi me shtetet jomyslimane është i domosdoshëm, besimtarët duhet të reagojnë në rastet kur flitet haptazi kundër besimit të tyre, në rast se nuk kanë mundësi ta parandalojnë këtë gjë, duhet t'i braktisin ambientet e tillë.

Nga ana tjetër edhe të krishterët dhe hebrejtë janë konsideruar të barabartë me ateistët në aspektin e "mbrojtës". Allahu në Kur'an urdhëron dhe thotë: "**O besimtarë! Mos i bëni miq e mbrojtës hebrenjtë dhe të krishterët! Ata janë mbrojtës të njëri-tjetrit. Kushdo prej jush që i bën ata miq, është me ata. Vërtet, Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë keqbërësít.**" (Maide, 51) Fjala "veli" është numri njëjës i fjalës "evlja", që përmendet në tekstin original të ajeteve të mësipërme dhe kuptimi i kësaj fjale është administrator, ndihmës, mik, burrë shteti, komandant dhe gjyqtar. (Ibn Mandhur, Lisanu'l- Arab; el-Munxhid fil-Luga ; H. Basri Çantay, Kur'an-ı Hakim ve Meal-i Kerim, İstanbul 1965, I, 87, Dipnot: 14.)

I lutemi Allahut t'i bëjë myslimanët një bashkësi, anëtarët e së cilës e duan njëri-tjetrin dhe përpilen t'i zgjidhin problemet e tyre në dritën e Kuranit dhe të Sunetit. Amin.

# PËRSIATJEMBI MO

Dr. Huseln Rizai

Njohja e religjioneve, e mendimeve dhe ideve të prezentuara në historinë e tyre është nevojë e kulturës bashkëkohore. Në kuptim të nomenit/termit, njeriu nuk mund të njihet pa e njohur brendësinë e tij. E njëjtë ndodh edhe me hulumtimin fenomenologjik të antropologjisë kulturore të njerëzimit, që është e pamundur pa studimin e religionit si dukuri shoqërore.

Religionet e në këtë rast, Islami, nuk burojnë vetëm nga besimi dhe morali, por përkundrazi, janë të lidhura thellë me artin, me letërsinë e bile edhe me organizimin e jetës shoqërore; madje edhe shkencat që dimë rrjedhin nga mjediset klerike dhe religioze. Sa i përket studimit sistematik të vetë religjioneve, kjo është një shkencë e re në krahasim me shkencat e tjera. Në mënyrë më të theksuar paraqitet në mjediset antireligioze dhe me elemente të theksuara antireligioze. Nga kjo ngërthesë janë filozofia religioze, studimet komparative të gjuhëve, gjuha e religionit etj. Por, me kalimin e kohës, vetë përfaqësuesit e religjioneve filluan që në studimet e tyre t'i përdorin metodat bashkëkohore sociologjike-antropololgjike për studimin e dimensionit fenomenologjik të religionit e veçanërisht dukurinë e fraksioneve dhe shkollave me platforma të ndryshme ideologjike, politike dhe shoqërore.

Modernizmi, jo vetëm në religion, por edhe në fushat e tjera të filozofisë, shkencës, artit, do të përpinqet t'i çrrënjosë botëkuptimet e vjetra dhe metodat e tyre për realitetin dhe do të ndërtojë një platformë mendore e në këtë rast edhe platformë mendore, e cila është e bazuar në zhvillimin e teknologjisë dhe shkencave logjike-racionale.

Modernizmi islam udhëhiqet nga ideja e filozofisë për orientim drejt së resë dhe largim të së vjetrës si e ngurtë dhe jofunksionale. Islami, si një nga fetë e

shpallura botërore në procesin e rrugëtimit të tij historik drejt kohës sonë, ballafaqohet me problemin e modernizimit, reformimit dhe përshtatjes me rrjedhat e reja shoqërore. Modernizmi islam paraqet njërin nga fenomenet më të rëndësishme të historisë moderne myslimanë. Ai është një tendencë intelektuale dhe një lloj lëvizjeje shoqërore që paraqitet në gjysmën dytë të shekullit të 19-të në vendet myslimanë, të cilat ishin nën ndikimin e Perëndimit. Myslimanët u ballafaquan me modernizimin e shoqërive tradicionale, duke filluar me tanzimatin e Shtetit Osman dhe imponimet e tjera nëpërmjet kolonive, siç është rasti me Indinë dhe vendet e tjera. Edhe Ballkani e përjetoi këtë modernizim, me intensitet më të madh në Bosnje, por edhe në viset e tjera, siç janë Kosova dhe Maqedonia.

Të ballafaqura me sfidat e ideve dhe institucioneve europerëndimore, autorët myslimanë të modernizmit filluan t'i kritikojnë intelektualët tradicionalë dhe reaktivitet shqërore të botës myslimanë. Islami që në fillim ishte i hapur ndaj traditave të huaja kulturore, që mund të shihet nga përkthimet e letërsisë antike greke në shekujt e parë pas profetit Muhamedit (a.s.). E njëjtë ndodh edhe gjatë kontaktit të myslimanëve me arritjet e kulturës perëndimore.

Islami, sikurse edhe fetë e tjera që iellore, do të përpinqet me ngulm t'i bëjë ballë modernizmit, ta sfidojë sekularizmin si krijues aktiv të shoqërisë bashkëkohore të bazuar në arsimin dhe humanizmin, të cilat kishin një qasje antropocentrike dhe laike për ndërtimin e shoqërisë (society building). Veçanërisht pas 11 shtatorit

# DERNİZMIN İSLAM

torit të vitit 2001, Islami u bë një nga kategoritë më të debatuara, duke filluar nga masa e gjerë e deri te elitat intelektuale, katedrat universitare, institutet hulumtuese... Linja e analizës shkonte prej paragjykimeve dhe injorancës e deri te qasjet objektive eksperte, me bazë të mirë shkencore. Ndërkohë kishte edhe paraqitje nga prizmi i qarqeve islamofobe, të cilat e dënojnë pikëpamjen islamë për qëndrim statik, amorf, këmbëngulës, mospruanë ndaj reformave etj.

Themeluesit dhe iniciatorët e parë të modernizmit islam Afgani, Abduhuja, Ridaja, Ikballi, Sheriati, Kutubi, Mevludi etj., do ta kuptojnë transcendencën dhe universalizmin e me këtë edhe paraqitjen aktuale në përditshmëri, që në rastin tonë është te modernizmi, në të gjitha fetë e veçanërisht në ato të shpallurat, si gjallëri të dimensionit universal të së vërtetës. Mu për këtë, në rindërtimin e mendimit dhe aktualizimin e tij në dimensionin bashkëkohor në të cilin jeton njeriu fetar, do ta paraqesin si institucion mendor, ku imanenca dhe ezoterizmi e paraqesin idenë e paharxhuar të transcençës, ndërsa ezoterizmi e paraqet nënshtimin ndaj Zotit.

Në këtë proces modernistët islamë do të konfronohen me ulematë tradicionalë për shkak të idesë për çrrënjosjen e shprehive të vjetra shkencore e njëkohësisht edhe me idetë kolonizuese të Perëndimit në vendet myslimane e veçanërisht me qeveritë satelitore të fuqisë politike perëndimore në vendet myslimane. Në këtë periudhë janë shkruar edhe veprat kujanë prezantuar idetë kryesore nismëtare të modernistëve islamë që mund të rezymohen me sa vijon:

1) Pastrimi i arsyes nga thashethemet dhe intrepre-

timet e gabuara të gjërave, për shkak se arsyja është gjëja e vetme që na mundëson ta gjejmë të vërtetën dhe të mendojmë në mënyrë të drejtë. Këtu bën pjesë edhe teuhidi, teomonizmi dhe besimi se njeriu duhet të pastrohet nga të gjitha ideologjitë e deformuara dhe besimet që e largojnë nga Zoti.

2) Potencialisht asnjë shoqëri, as në nivel individual, as në nivel kolektiv nuk është më e aftë se ndonjë shoqëri tjetër. Teoritë bazohen në mendimet se çdo individ ose shoqëri duhet të besojë e pastaj duhet edhe ta arrijë qëllimin e planifikuar humanitar dhe të mirë, duke i arritur të gjitha sukseset, me përjashtim të të genit profet. Islami që në fillimin e shpalljes së tij është prezantuar si religion që i kundërvihet nacionalizmit dhe fashizmit, gjithmonë janë përkrahur tezat se njërit janë të barbabartë edhe për nga ngjyra edhe për nga raca dhe se përparësia qëndron vetëm te mendja, arsyja, te shpirti, dija dhe virtytet.

3) Dija dhe besimi duhet të ndërtohen mbi dëshmi dhe argumente të fuqishme e jo duke imituar. Lirisht mund të thuhet se Islami është feja e vetme që i jep rëndësi shumë të madhe dijes dhe shkencës. Kjo do të thotë se Islami i nxit besimtarët të mos i pranojnë gjërat pa i analizuar, por t'i analizojnë dhe t'i ndërtojnë mendimet e tyre mbi dëshmi të fuqishme, të mos imitojnë, të janë të bindur fort në dëshmitë e tyre, për shkak se Islami nuk pranon aktivitete për të cilat nuk ka dëshmi dhe i kundërvihet çdo gjëje që është në kundërshtim me arsyen.

4) Në çdo shoqëri, çdo individ dhe çdo i punësuar në ndonjë institucion të caktuar duhet të jetë i arsimuar dhe i edukuar, me qëllim që të jetë i përgatitur profesionalisht për kryerjen e detyrave që i janë dhënë; në çdo shoqëri duhet të ketë shkencëtarë të mençur, që do të kontribuojnë për ngritjen e vetëdijes së njerëzve dhe që do të janë liderë në shoqëri. Dy komponentet

e lartpërmendura në Islam janë obligim i çdo individu mysliman.

Në të njëjtën linjë vazhdojnë edhe postmodernistët, por me një dallim që vjen nga vetë platforma e postmodernizmit. Ajo është se ata janë pak më tepër të koncentruar në ngritjen shpirtërore të besimitari si nevojë kryesore e kohës. Te postmodernistët, kryesisht do të paraqiten këto ide:

Në vend të parë vendoset dija dhe potencoherët esenca e fesë. Thuhet se Kurani e po ashtu edhe vetë feja, nuk kanë për qëllim ta korrigojnë të vërtetën njerëzore si të tillë, por kanë për qëllim që në mënyrë plotësuese ta pasurojnë dhe ta zgjerojnë ose t'i potencoherët dimensionet e pazbuluara ose të lëna pasdore të njeriut dhe të botës. Postmodernistët dëshirojnë ta studiojnë vetëdijen në lidhje me Zotin dhe universin, me qëllim që të zbulohet plotësimi i realitetit dhe në atë mënyrë njeriu të mund të jetojë në mënyrë të mirëfilltë.

Ata në atë mënyrë tërheqin vërejtjen për një çështje shumë të rëndësishme, e cila akoma nuk është elaboruar sa duhet nga ana e mendimtarëve bashkëko-horë myslimanë e ajo është çështja e botës si bërthamë e njeriut. Ata në mënyrë lucide e konstatojnë gjendjen e cila është rezultat i letargjisë dhe vetëdijes së pazgjuar në mjediset myslimanë, duke theksuar se më nuk ekziston një frymë magjike ciklike, e cila në çdo hap do të punonte për pasurimin shpirtëror dhe vazhdimin e vetëdijes njerëzore dhe mjedisit jetësor. Për këtë arsy, postmodernistët gjithmonë e potencoherët parimin kurancë ortopaktikës mbi ortodoksinë. Fillimisht çdo-herë ka vepër, për shkak se personaliteti i njeriut mund të studiojë vetëm duke bërë interpretimin e aktit. Përfundimi i realitetit, raportet dhe lidhjet me Burimoren do të çojnë deri te triada e njohur kognitive, interpretimi shpirtëror i universit, lirimi shpirtëror i njeriut dhe parimet shpirtërore për zhvillimin e sho-qërisë. Ato, sipas tyre, janë nevojë e domosdoshme e njerëzimit, qëllimi i të cilët është ideali shpirtëror i demokracisë, e cila i anashkalon të gjitha konceptet e mëdha ideologjike të modernizmit.

Postmodernistët mendojnë se parimet kryesore për çorientimin e botës bashkëkohore të myslimanëve janë: mualizmi, mbyllja dhe paqëndrueshmëria e ulëmave, misticizmi, aristokacia shpirtërore dhe largimi i fesë nga praktika dhe në fund, mbretëria ose sistemi i monarkisë retrograde të dinastisë si formë e vetme e pushtetit në vendet myslimanë.

Postmodernistët e mundësojnë solidaritetin e pa-shkëputur të individualizmit si burim të potencialit të madh dhe shoqërisë si një arenë ku ai potencial mund

të realizohet. Në këtë mënyrë, ata në mënyrë brilante i potencoherët rrethanat nga historia myslimanë, duke i përmendur ndodhitë e myslimanëve që largohen nga Islami në dobi të vetëpëlgjimit dhe interesit, që akoma është gjendje akute në shpirtin e shumicës së vendeve myslimanë.

Refleksioni historik dhe temporal-aktual i mendimit modernist islam mbi Gadishullin Ballkanik është me rëndësi të veçantë për analizën e drejtë të modernizmit dhe reformizmit fetar në këto hapësira dhe më gjerë. Sot, në suaza botërore, por edhe në Ballkan dhe në Maqedoni, vërehet një trend i rivitalizimit fetar, një lloj i zgjimit fetar, ku vërehet nevoja për kthimin drejt çerdhes së vet, drejt kornukopisë (begatisë, pasurisë) së vet, drejt kultit kargo (tradicional, të bartur) të vet, duke perceptuar se gjatë sundimit pesëdhjetëvjeçar të monizmit kanë qenë në huti të madhe. Nga njëra anë, presioni i kohës, ndërsa nga ana tjetër kthimi drejt të shenjtës, dy trende kundërshtuese që janë në zënë permanente.

Në prezantimin e modernizmit dhe postmodernizmit në Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë dhe në Maqedoni, presonalitet qendorë ka qenë

Husein Xhozo, si bartës i ideve të lartpërmendura shtytëse të modernistëve dhe postmodernistëve në hapësirat ballkanike. Përveç tij, në kuptim të përfaqësimit të spektrave të ndryshëm të modernizmit në këto hapësira, rol të rëndësishëm do të luajnë edhe institucionet e bashkësive islamë, shkollat fetare, medreset dhe fakultetet, organizatat shoqërore, etj. Po ashtu, me rëndësi të madhe është edhe akademizmi islam nga Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, e veçanërisht nga Maqedonia.

Përfaqësuesit të ndryshëm të akademizmit islam, duhet të përpilen në fusha të caktuara të jetës shoqërore dhe shkencore ta përcjellin mendimin islam me karakterin e tij të drejtë. Ideja e tyre të jetë që Islami dhe myslimanët të hapërojnë me kohën. Me specializime në shkenca të caktuara shoqërore teologjike, dijetarët islamë do të kontribuojnë në bartjen e letërsisë ekzistuese bashkëkohore, fetare dhe religioze-filosofike në rajonin e Maqedonisë. Akademizmi islam në Maqedoni dhe përfaqësuesit e tij janë mendje moderniste dhe të matura, të cilët fenë e kuptojnë si sistem të jetës dhe si mjet për mirëqenie dhe jetesë të përbashkët të të gjithë njerëzve në botë. Lirisht mund të thuhet se kjo gjeneratë e mendimtarëve nga Maqedonia për herë të parë do të dijë të jetë në hap me zhvillimet shkencore botërore dhe do të kuptohet seriozisht nga ana e të gjithë aktorëve të shkencës islamë në Ballkan, Evropë dhe botë.





# FUNKSIONALITETI I MENDIMIT ISLAM

Dr. Muhamed Mustafi

## HYRJE

Në botën e mendimeve ekzistojnë shumë ide, çështje dhe problematika që shqyrtohen për masën e ndikimit të tyre në shoqëri dhe në më të shumtën e rasteve vlerësohen idetë dhe mendimet që kanë ndikim sa më të fuqishëm në botë. Ndryshimet shoqërore dhe politike në botë janë të lloollojshme, por në bazë të asaj që përjetojmë edhe ne sot, vërehet qartë se asnë prej tyre nuk ka tejkaluar masën e kohës, sepse kanë kohë dhe periu-dhë të caktuar të funksionalitetit. Sistemet shoqërore dhe politike janë funksionale aq sa kanë pushtetin dhe kur humbin pushtetin, humbin ndikimin dhe kështu, për teoritë e tillë mund të lexojmë vetëm në literaturën e historisë së zhvillimit të mendimit njerëzor.

Të njëjtin fat e përjeton edhe mendimi fetar perëndimore, sepse siç shohim, në Perëndim nuk ndikon në nxitjen e lëvizjeve të mendimit.

Mendimet e tillë janë funksionale, nëse kanë përkrahje nga institucionet e ndryshme, në të kundërtën, jo.

Vlen të theksohet se kur bisedohet për funksionalitetin e mendimit islam, asnjëherë nuk kemi hasur në histori, bile as sot nuk vërejmë ndonjë dobësim të tij,

pa marrë parasysh se a ka përshtatje nga jashtë apo jo. Në shumë shoqëri myslimanë jeton dhe vepron sipas mendimit islam, si në shoqërinë islame ashtu edhe në atë joislame. Funksionaliteti i tillë nuk është i dobët, nëse bisedohet për dëshminë fetare dhe për jetën fetare, bile ka të njejtën fuqi në botën islame dhe në atë joislame.

Lëvizja e jetës private, familjare dhe shoqërore brenda parimeve të mendimit islam vërtet është multifunksionale dhe çdo mysliman i aplikon parimet e fesë islame, sepse në trurin e tij mendimi islam është funksional.

## MENDIMI ISLAM

Funksionaliteti i mendimit të tij është shumë i qëndrueshëm, edhe pse "armiqtë e Islamit mundohen ta keqrezantojnë dhe nënçmojnë Islamin, që ta bëjnë më pak atraktiv për gjeneratën e njerëzve dhe për ata që tentojnë të largohen nga shoqëria e tyre."<sup>1</sup>

Një opsion i tillë u ofrohet atyre që jetojnë në zbrazëtirë dhe në mendjet e të cilëve nuk ekziston një bindje

1. Abdussabour Marzouq, *Conguest through ideas, end and means*, Muslim World League, Maqqah, f.29

e thellë islame.

Në një mejdan të konflikteve të tillë, as individi e as shoqëria nuk mund të bien në kurthin e keqinterpretimave të tillë, nëse në mendjet e tyre funksionon mentaliteti islam. Në këtë kontekst, Marzouqi thotë: "Sikur të praktikohet Islami në mënyrë korrekte nga ana e myslimanëve, atëherë ata do të bëhen mrekulli dhe krenari e historisë, por nëse e braktisin dhe anojnë nga regresi, apatia dhe në këtë mënyrë, faji i pafalur do të ishte i tyre e jo i Islamit".<sup>2</sup>

Sa më funksional të jetë mendimi islam, aq më funksional do të jetë edhe myslimani, sepse fuqia ndërli-dhëse ndërmjet këtyre dy komponentëve është shumë e madhe dhe e pandashme. Nuk mund të pritet ndonjë rezultat pozitiv, nëse raporti i tillë është i ndërprerë dhe nuk funksionon si duhet. Mosfunkcionimi i mendimit do të vërtetonte të kundërtën e asaj që kemi obligim si myslimanë, qofshim arabë ose jo. Funksionaliteti i tillë do t'i detyrojë njerëzit që "të mos e shikojnë me një indiferencë botën e sotme. Sqarimi i Islamit ashtu siç është do të vërtetojë se kjo e vërtetë ende jeton në nivelin individual dhe atë shoqëror, i plotë dhe i pakompromis".<sup>3</sup>

Ndikimi i të vërtetës së Islamit mund të jetë i fuqishëm apo i zbehtë, varësisht nga funksionaliteti i mendimit islam në trurin e myslimanit. Pra, funksionaliteti i tillë e bën të gjallë në shoqëri, nëse vepron me një energji teorike dhe praktike.

Ndryshe nga të tjerët, të cilët mendojnë se mendimi fetar është i përqendruar vetëm në botën shpirtërore, ne mendojmë se mendimi fetar nuk është aq i ngush-të dhe njëdimensional. Nëse nuk funksionon në këtë mënyrë, atëherë do të ndodhë njësoj siç ndodhi me të tjerët, të cilët e lidhën vetëm me botën njëdimensionale dhe në rast të tillë, pér shoqérinë do të ketë vetëm një alternativë, gjegjësisht mbështetjen në diçka që nuk është e afërt me natyrën e botës sonë. "Feja është sistem shoqëror, legjislativ e moral dhe me çka do të zëvendësitet, nëse e braktisim sistemin e tillë dhe në cilat parime do të mbështeten pér të përfituar qetësinë në shoqëri? Në këtë mënyrë, alternativë e vetme do të ishte mbështetja në racion dhe në ndërgjegje".<sup>4</sup>

Ndryshimi i të menduarit duhet të realizohet nga brenda drejt Islamit e nga jashtë, sepse çdo efekt i huaj mund të fshijë natyrën specifike të mendimit islam. "Ne sigurisht se mund të marrim impulse nga kulturat e huaja, por nuk mund të kompletojnë Islamin e përkryer me diçka joislame, qoftë nga Perëndimi ose nga Lindja. Islami si institucion shpirtëror dhe shoqëror nuk mund

të "përmirësobet". Çdo ndryshim në konceptet apo në organizimin shoqëror të tij nëpërmes huazimit nga ndikimet e kulturave të huaja, do ta shkatërrojë në masë të madhe. Patjetër të ketë ndryshim, por nga vetvetja jonë dhe duhet drejtuar nga Islami e jo larg tij".<sup>5</sup>

Nuk kemi të drejtë të mendojmë se mendimi islam mund të funksionojë nëpërmes evolucionit të mendimeve, gjegjësisht nëpërmjet zëvendësimit të tij me mendime kalimtare dhe të përkohshme, sepse në mendimet e tillë qëndrimet do të ishin kalimtare dhe me vlerë të përkohshme. Çdo ripërtëritje e mendimeve nënkupton se ka gabim të vazhdueshëm dhe se nuk mund të shërohet gabimi i tillë nëpërmes evoluimit të ideve. Kështu, nuk do të kishte stabilitet as në fe e as në moral."<sup>6</sup>

Mendimet e ndryshme që janë prodhim i trurit të njëriut janë gjithmonë në lëvizje e sipër, sepse çdo mendim korrigjon të parin dhe kështu deri sot, por kur bisedohet pér mendimin islam, duhet biseduar ndryshe, ngase nuk buron nga truri i njeriut, por nga Zoti i Madhëruar. "Në nuk kemi nevojë të "reformojmë" Islamin ashtu siç mendojnë shumë myslimanë, por ajo që duhet ndryshuar është sjellja jonë ndaj fesë, përtacia jonë, plogështia jonë, shkurt Pamësia jonë. Pra, ne duhet të reformojmë gabimet tona e jo defektet e Islamit. Nëse dëshirojmë të fitojmë zgjim islamik, nuk duhet të kërkojmë parime të reja bihevioriste nga jashtë, por vetëm duhet të aplikojmë parimet e hershme dhe të harruara".<sup>7</sup>

## PARIMET E FUNKSIONIMIT TË MENDIMIT ISLAM

Mendimi islam nuk do të ishte funksional, nëse mbështetet në parime të ndryshueshme që janë pjellë e mendimeve njerëzore. Parimet e Islamit janë ndryshe, sepse funksionojnë në një mënyrë unike gjatë tërë historisë së mendimit... Diçka është islame kur bazohet në mësimet e Kur'anit dhe të pejgamberit Muhamed (a.s.). Sigurisht, Kurani dhe literatura e hadithit janë përplot këshilla e nxitje pér të kërkuar diturinë dhe përmirësuar veten nëpërmjet përputhjes së normave të siguruara nga Zoti dhe pejgamberi i Tij. Por dija edhe përmirësimi kuptohen gjithmonë në terma të një synimi të posaçëm, dhe ky synim është që të bëhem i plotësish së njerëzorë në këtë botë e të arrijmë lumturinë e përjetshme në tjetrën.

Në vetvete dhe pér vetvete dija s'ka vlerë, përndryshe, pejgamberi nuk do të ishte lutur... "O Zot, kërkoh mbrojtje nga dija e padobishme".<sup>8</sup>

5. Muhammad Asad, Islam at the crossroads, Noor Publishing house, Delhi, 1987, f.154

6. Abdulhalim Mahmud, op. cit, f.226

7. Muhammad Asad, op. cit, f.154

8. William Chittick, Shkencë e kozmosit, shkencë e shpirtit, Zemra e Traditës, Tiranë, 2011, f.162

2. Po aty, f.28

3. Roger du Pasquier, Unveiling Islam, The Islamic Texts Society, Cambridge, 1992, f.8

4. Abdulhalim Mahmud, El-Islam vel-aklu, Darul-Me'aref, Kairo, f.17

Pra, funksionaliteti i mendimit islam varet nga rapporti që ekziston në mes diturisë në kokën e myslimanit dhe jetës praktike të tij. Asgjë nuk mund të jetë funksionale, nësë është e mbyllur brenda kufijve të njohurive teorike e të thata që nuk mund të zbatohen në jetën praktike individuale e shoqërore.

Burimi i mendimit islam është hyjnor dhe ka për që-llim aplikimin e tij në jetën e përditshme normative individuale dhe shoqërore. Mendimi i tillë nuk mund të jetë thjesht një teori që mund të pranohet apo jo, por është obligim dhe përgjegjësi që duhet të realizohet në fjalë dhe vepra. Mendimi islam është i fryshtuar nga shpallja dhe është shpjeguar nga Pejgamberi (a.s.). "Ardhja e Pejgamberit (a.s.), është kreati, ai është shpallur për të marrë pjesë në hapësirë për t'i kontrolluar forcat e historisë dhe në këtë ményrë, për të formuar një botë të re të idealeve. E tillë është edhe përgjegjësia e myslimanit, pra të mendojë për shenjat që i sheh e jo të kalojë pranë tyre si me qenë i shurdhër dhe i verbër. Ai që është i verbër në këtë botë, do të jetë i verbër në botën tjeter."<sup>9</sup>

Meqë qëllimi kryesor i shpalljes së Islamit është udhëzimi i njerëzve në këtë botë, atëherë nuk kemi të drejtë të formojmë vetëm mendime teorike jofunksionale, sepse në të kundërtën, do të humbim rolin që kemi në këtë botë. Nuk kemi të drejtë të mendojmë jashtë botës dhe jashtë jetës, sepse nuk jemi njerëz që jetojmë në ëndrra e shpresë. Lidhja në mes mendimit islam dhe realitetit është shumë e fuqishme dhe pa kurrëfarë kontradiktash. "Në Islam, ideali dhe realiteti nuk janë dy fuqi kontradiktore që nuk mund të pajtohen. Jeta ideale nuk mund të formohet nëpërmes braktisjes së plotë të realitetit, sepse në këtë ményrë shkatërrohet uniteti organik i jetës. Idealii gjithmonë tenton të përshtatet me realitetin për ta absorbuar, për ta transformuar dhe për ta ndriçuar në tërësi."<sup>10</sup> Në këtë kontekst, Zoti i Madhieruar thotë: "**"Ne nuk i krijuam qiejt dhe tokën dhe atë që është në mes tyre për të luajtur."** (Kuran, 44:38)

Ne jemi njerëz që bartim përgjegjësinë e Islamit dhe, nëse mendojmë se vetëm me mendimet tonë jofunksionale do të mund të ndryshojmë realitetin tonë, gabojmë, sepse ajo që quhet mendim islam, duhet të ketë edhe funksion islam.

Nëse mendimin islam e largojmë për t'u mbështetur

në ndonjë parim tjetër, atëherë do të ndryshojë natyra e tij, sepse me ndryshimin e besimit ndryshon edhe efekti. "Në këtë ményrë, intelekti do të bëhet udhë-heqës e jo feja dhe në këtë ményrë do të ndryshonte natyra e fesë dhe do të largoheshim nga rruga e drejtë. Kjo rrugë e drejtë, që në arabisht quhet 'siratun mustakim', nënkupton lidhshmërinë e ngushtë mes fesës dhe intelektit."<sup>11</sup>

1. Feja është shpallur për të udhëzuar intelektin rreth çështjeve konkrete, që kanë të bëjnë me botën e metafizikës, gjegjësisht sqaron çështjet që kanë të bëjnë me Zotin, Pejgamberin e Ditën e Gjykimit.

2. Feja ka të bëjë me çështjet e moralit e gjegjësisht me të mirën e të keqen, me vlerat që bëjnë njeriun të devotshëm, të sinqertë, besnik e të mirë.

3. Feja ka të bëjë me çështjet legislative që rregullojnë shoqërinë dhe që e bëjnë shoqërinë të lumtur nëpërmes normave të tillë.

Pra, feja është shpallur për të udhëzuar intelektin pikërisht në këtë çështje.

## MËNYRA E FUNKSIONIMIT TË MENDIMIT ISLAM

Mendimi islam është funksional, sepse ka një synim dhe nuk formohet pa pasur ndonjë dobi konkrete, sepse në të kundërtën, do të ishte steril dhe i pafrytshëm. Këtë çështje e analizon shumë bukur dijetari i njohur islam William Chittick: "Thashë se ka një dallim themelor midis traditës intelektuale islamës dhe diturisë moderne. Për ta kuptuar këtë, duhet theksuar se intelektualët myslimanë përpinqeshin të arrinin një vizion njësues dhe të njësuar të të gjitha gjëra, duke aktualizuar intelektin tejpersonal, shpirtin hyjnor (ruhin) të fshehur në veten njerëzore.

Përkundrazi, shkencëtarët modernë kërkojnë të arrijnë një të kuptuar gjithnjë e më të përpiktë të gjëra që t'u lejojë kontroll në rritje mbi mjedisin, trupin e njeriut dhe shoqërinë. Mirëpo, në atë shkallë që ky kontroll arrihet, i dorëzohet egoizmit injorant dhe harraq, që tekstet e quajnë "kapriço" (hawa) ose "neps" (shahwa).

Ai nuk vihet në duart e inteligjencës plotësisht të aktualizuar të mëkëmbësit të Zotit mbi tokë. Kjo shihet veçanërisht qartë në botën moderne, ku të gjithë kanë shfrytëzuar fuqinë shkencore, teknologjike e burokratike për të ngulitur bindjet te të nënshtuarit e tyre".<sup>12</sup>

9. Muhammed Ikbal, Obnova vjerske misli u Islam, Sarajevo, 1979, f. 95

10. Muhammed Ikbal, op.cit., f.18

11. Abdulhalim Mahmud, El-Islam vel-aklu, f.17

12. William Chittick, op. cit, f. 81-82

Horizonti i mendimit islam nuk ka vetëm një funksion, por është shumëfunksional, sepse mbështetet në parimin që nuk sheh përkufizim konkret, gjegjësisht në fe. "Feja nuk është diçka e kufizuar, nuk është vetëm mendim, as vetëm ndjenjë e as vetëm vepër, por është pasqyrë e tërë e njeriut dhe prandaj, nuk ka arsyë të mendohet se kuptimi dhe intuita pengojnë njëri-tjetrin, sepse kanë një origjinë që vjen nga një burim."<sup>13</sup>

Kjo mënyrë e funksionalizimit të mendimit islam nuk përkufizohet vetëm në një shtresë njerëzish. Këtë botëkuptim e ka edhe intelektuali edhe i rëndomti, i pasuri dhe i varfri. Ky mendim funksionon te të gjithë, sepse bindja islame është në shpirtin e të gjithëve. "Islami në esencën e vet nuk i ndan njerëzit, përpos në bazë të devotshmërisë ndaj Allahut dhe kryerjes së veprave të mira.

Sipas Islamit, njerëzit janë të barabartë si dhëmbëzat e krehërit. Arabi nuk ka prioritet ndaj joarabit përveç në bazë të devotshmërisë. Që aty, Islami e zgjeroi hapësirën në drejtimin që nënkuption se çokush ka të drejtë të mendojë, të përsiatë, të hulumtojë dhe të punojë, qoftë ai pjesëtar i udhëheqësve ose rob apo i mbrojtur."<sup>14</sup>

Muslimani formon vetveten nëpërmes funksionalitetit të mendimit të tij islam. Sa më autentik të jetë mendimi i tij, aq më funksional do të jetë në botë, si dhe sa më të pasur ta ketë diapazonin e mendimit, aq më shumë do të ketë ndikim në lëvizjet botërore bashkëkohore.

Kështu vepruan myslimanët e hershëm dhe kështu u bënë udhëheqës në botën e mundimeve dhe lëvizjeve politike. Ata formuan një ndikim të dukshëm nëpërmes kulturës së tyre dhe, edhe sot e kësaj dite ndikojnë në botë nëpërmes veprrave të tyre të shkruara. Ata i shkrinë mendimet e hershme filozofike greke, duke formuar mendimin autentik islam. Ata e kuptuan mirë se si funksionon mendimi islam dhe për këtë shkak, sot, ashtu siç thotë Akkadi: "Përballë Islamit ekzistojnë dy gjëra të rëndësishme, që nuk duhen vonuar e injoruar. E para ka të bëjë me mbrojtjen e vetes para ambicieve të të huajve, kurse e dyta ka të bëjë me bashkëpunimin për t'i përfituar mjetet e përparimit dhe zhvillmit."<sup>15</sup>

Mendimi islamik nuk përqendrohet vetëm në një



popull, sepse shpallja nxit fuqinë e mendimit tek të gjithë. "Shpallja, pra, nuk është shpallje e vetëm një populli, por është një shpallje themelore"<sup>16</sup>, që vlen për të gjithë. Nuk mund të thuhet se shpallja i takon vetëm një populli, por të gjithë i shijojnë rrezet e ngrohta të saj dhe të gjithë inspirohen prej saj. Kjo ishte një analizë e mënyrës më të mirë për të qenë mendimi islam funksional ashtu siç ka qenë në kohën e kaluar, gjegjësisht në kohën e Pejgamberit (a.s.) e më vonë. Lu qasa kësaj çështjeje, sepse më vjen keq kur shoh se sot, edhe pse jemi të shumtë në numër, jemi shumë të kufizuar në ndikim, ndërsa, për sa i përket temës, ashtu siç thotë edhe Ibn Halduni në Mukkadime, "shpresoj se atyre që do të vijnë pas nesh, Zoti do t'u dhurojë mendim korrekt dhe me një shkencë të pastër do t'i shqyrtojë të gjitha çështjet e një disipline. Ata që do të vijnë më vonë, do të shtojnë fakte pas fakti, derisa shkenca të kompletohet."<sup>17</sup>

## PËRFUNDIM

Sot, nga e gjithë çfarë u tha në këtë elaborat, vërehet qartë se trasimi i rrugës për të depërtuar nëpër mendimin islam funksional në botë është shumë i vështirë. Pra, ashtu siç u ballafaqua Pejgamberi (a.s.), me realitetin e ngadhnjeu, ashtu duhet të veprojmë edhe ne me realitetin tonë. Ne nuk jemi ata që ndryshojmë mendimet e njerëzve, por nëse ofrojmë mendim të pastër e funksional, atëherë do të jemi të suksesshëm, sepse do t'i ofrojmë njeriut bashkëkohor një ideal që është më i lartë se ai material, gjegjësisht do ta mbulojmë zbrazëtirën që ekziston në mendimin njerëzor, ashtu siç ekzistonte edhe në shoqërinë para se të vinte shpallja kuranore.

Funksionalizimi i mendimit islamik mund t'li jepë mendimit teknologjik, ekonomik dhe politik ndërkombëtar shpirtin human dhe të mbulojë zbrazëtirën që ekziston në natyrën e tyre.

Vetëm nëpërmes funksionalitetit të mendimit islam mund të përfitohet pozita e hershme e myslimanëve që e kenë pasë dhe vetëm në këtë mënyrë mund të dilet në mejdan me të tjerët, përndryshe do të vazhdohet edhe më tej pa fjalën krysore dhe pa ndikim në lëvizjet globale botërore.

13. Muhammed Iqbal, op. cit, f.14

14. Ahmed Fuad El-Ehvani, Filozofia Islame, BIM-FSHI, Shkup, 2002, f.126

15. Abbas Mahmud Akkad, El-Islam vel-hadaret-insanijetu, El-Mektebetul-asrije, S'ajda, Beirut, f.12

16. Eva de Vitrej Mejerovic, Poetika islama, (Julija Krsteva, Prelazene znakova), Svetlost, Sarajevo, 1979, f.203.

17. Ibn Haldun, Muqaddima, Veselin Maslesha, Sarajevo, 1982, f.125

# Femrat dhe varret

Muhammed El-Gazali

Dikush i nevrikosur më pyeti: Përse nuk u flet femrave që të mos i vizitojnë varret, ndërkohë që u flet atyre për shumë çështje të tjera?

- Do të thuash t'u flas atyre për edukatën (rregullat) e vizitës së varreve?

- Jo, por t'i ndalosh rreptësisht, ashtu siç ka urdhëruar Islam!

- E meta juaj është se njihni vetëm një anë të çështjeve fikhore (juridike), pastaj fanatizoheni për to dhe përpinqeni të arrini përmes saj deri në Këshillin e Sigurimit!

Ejani së bashku tek më i afërti dhe më i hollësishmi burim për këto çështje, tek Fikhu Sunne, i shejkh Sejid Sabik dhe do të gjejmë në të këto fjalë: "Malikitë dhe disa Ahnaf (pjese të medhhebit hanefi), dhe një transmetim nga Ahmedi dhe pjesa më e madhe e dijetarëve e kanë lejuar vizitën e femrave në varre. Në hadith transmetohet se Aisheja po kthehej një ditë nga varrezat dhe i thashë: 'O nëna e besimtarëve, prej nga po vjen?'"

Tha: "Nga varri i vëllait tim, Abdurrahmanit." I thashë: "A nuk e ka ndaluar i Dërguari i Allahut vizitën e varreve?"

Tha: "Po. Ka qenë e ndaluar vizita e varreve, por pastaj ka urdhëruar t'i vizitojmë ato!"

Në hadithin e Buhariut dhe Muslimit transmetohet se Pejgamberi (a.s.), shkoi një grua përpara një varri duke qarë përfëmijën e saj dhe i tha: "Kije frikë Allahun dhe duro". Ajo i tha: "Ti nuk e di se çfarë fatkeqësie më ka rënë." Kur u largua, dikush i tha asaj se ai ishte i Dërguari i Allahut, sepse ajo nuk e njihet. Atë gati sa nuk e zuri vdekja dhe shkoi drejt e tek shtëpia e Pejgamberit (a.s.) dhe i tha: "O i Dërguar i Allahut, nuk të njohal!" Ai (a.s.), ia ktheu: "Durimi është në goditjen e parë" dhe nuk e qortoi se përsë kishte shkuan tek varret».

Një hadith i dobët është transmetuar nga Ahmed ibn Hanbeli, ku thuhet: "I mallkoftë Allahu vizitueset e varreve". Ky hadith, nëse do të ishte i saktë, refuzon qëndrimin tek varret, vizitat e shpeshta, transportimin e egërës së varreve nëpër shtëpi, nxitjen e dhimbjeve të pafund dhe të gjitha këto i ndalon edhe natyra e shëndoshë.

U zgjata në shpjegimin e kësaj çështjeje, sepse kam parë disa njerëz që nuk njohin vetëm se një mendim të një meseleje fikhore (juridike), madje mund të njohin mendimin më të dobët, pastaj ekstremizohen, kërkojnë t'i detyrojnë të gjithë në të dhe fillojnë e ankohen për prishjen e dynjasë dhe fesë, sepse njerëzit e tjerë nuk e pasojnë mendimin e tyre!

Mes masave janë shtuar rrëmujat për çështje kontradiktore dhe kemi parë se si djem të rinj, që nuk zotërojnë vetëm se disa lëvozhga, dëshirojnë ta shqyejnë ymetin me vlerësimin e një medhhebi ndaj një medhhebi tjetër apo parapëlqimin e një mendimi ndaj një mendimi. Këta janë fitne (sprovë) dhe ua tërheqim mendjen njerëzve nga sherri i tyre.

Fikhu islam është i mbushur me mijëra mendime në rregulla të ndryshme dhe kuptimi i ndryshimit të ymetit, do të thotë se në këtë çështje ka gjërsë. Dhe se gabimtari dhe interpretuesi kanë shpërbimin e tyre dhe në Islam nuk ekziston që feku (juristi) gabimtar të konsiderohet sikur ka kundërshtuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe ai të mbajë përgjegjësi për gabimin e vet!

Ata të cilët e përhapin fanatizmin dhe ndezin betejat për triumfin e mendimit të një imami përpara një imami tjetër si ai, janë rrezik për unitetin e ymetit tonë dhe të ardhmen e tij, në kohën që armiqtë janë vërsulur kundër Islamit dhe kërkojnë ta zhdukin atë.

Përktheu nga arabishtja:  
**Lavdrim Hamja**

# *Kumtuesi i paepur i fesë islame:* **HISHAM IBN HAKIM**

**Mustafa Erlsh**

Hisham ibn Hakim ka qenë i dalluar në mesin e sahabëve si një mysliman i përpiktë në lidhje me urdhërimin për mirë dhe ndalimin nga e keqja.

Ai ka qenë një kumtues i paepur i fesë islame, i cili nuk ngurronte t'ia kumtonte fenë islame çdokujt.

Ai qe një burrë trim dhe i guximshëm, i cili përpëllitej nga dëshira për t'u mësuar njerëzve mësimet e drejta që i kishte mësuar Allahu dhe i Dërguari i Tij nëpërmjet fesë islame.

Ai ishte vëllai i vogël i gruas së Profetit, Hatixhes, radijallahu anha, si dhe nipi i sahabit të njojur Hakim ibn Hizam.

Ai pranoi fenë islame ditën që u çlirua Meka, së bashku me babin e tij, i cili ishte njëri nga paria e ku-rejshëve si dhe vëllezërit e tij Abdullah dhe Halid.

Ai shkoi në Medine përpëra se i Dërguari i Allahut të vdiste dhe jetoi aty deri në periudhën e hilafetit të Ebu Bekrit.

Hisham ibn Hakim kishte fizik të bëshëm dhe karakter të ashpër, por ishte shumë i ndjeshëm për ato që ngjanin pérreth dhe përpiquej shumë që t'u kujtonte udhëheqësve të shtetit se cila ishte e drejta sipas mësimeve të fesë.

Këto cilësi vlenin për të gjithë sahabët. Ata sille-shin me shumë kujdes dhe përpikmëri, duke u kujtuar vazhdimisht njerëzve dhe drejtuesve të shtetit se çfarë është e mira dhe e keqja. Ata nuk ngurronin aspak për të zbatuar çdo urdhër dhe ndalesë që u shpallte Allahu dhe i Dërguari i Tij, duke u përpjekur që të ishin të parët që do t'i vinin në praktikë ato urdhra.

Hisham ibn Hakim qe një sahab konsekuent që nuk bënte lëshime në lidhje me mësimet e fesë. Halifi Umer e kishte shprehi që të thoshte: "Për sa kohë të jetoj unë dhe Hishami, kjo nuk ka për të ndodhur." (Sijeru alami'n-nubela, III, 51-52.)

Këto fjalë Umeri, (r.a.), i përsërise shpesh në çdo rast kur mësonte se kishte ngjarë një gjë që ai nuk e pëlqente apo kur shihte me sytë e tij një shfaqje që nuk është në përputhje me mësimet e fesë.

Hisham ibn Hakim ishte në shpurën e Ijad ibn Ganemit, valiut të Homsit, në kohën e halifit Umer, gjatë pushtimeve të Sirisë dhe Palestinës.

Ai pati realizuar udhëtime të shumta në këtë per-riudhë të jetës së tij, me qëllim që të urdhëronte për të mirën dhe të ndalonte nga e keqja. Përpiquej shumë t'i nxiste njerëzit të kryenin veprat e mira dhe të distancoheshin nga veprat e këqija. Ai nuk ngurronte aspak për të kritikuar çdokënd që kryente një veprim që binte ndesh me mësimet e Islamit dhe të logjikës. (Istiab, IV, 1538-1539, Usdu'l-gabe, V, 372.)

Njëherë ai u bë dëshmitar se si Ijad ibn Ganem i kishte dënuar disa jomyslimanë nga Himsi që nuk kishin paguar xhizjen, duke i detyruar të rrinin nën diellin përvëlues. Ai pati ndërhyrë menjëherë duke i transmetuar atij hadithin që kishte dëgjuar nga Profeti. Muslimi e transmeton me këto fjalë këtë hadith:

- Nga Hisham ibn Hakim ibn Hizami raportohet se ai pati hasur në Damask disa bujq, që ishin detyruar të rrinin nën diellin përvëlues, pasi u kishin derdhur më parë vaj ulliri në kokë.

- Çfarë ka ngjarë? - pyeti ai.
- Nuk kanë paguar xhizjen, prandaj edhe janë dënuar në këtë mënyrë - i patën thënë.

Atëherë Hishami, (r.a.), pati thënë:

- Betohem se e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut të ketë thënë:

*"Allahu ka pér t'i dënuar të gjithë ata që dënojnë pa të drejtë njerëzit në këtë botë."*

Pastaj Hishami pati shkuar personalisht tek valiu dhe e pati bindur atë të urdhëronte që bujqit të lihe-shin të lirë. (Muslim, Birr 117- 119, Ebu Davud, Imare 32.)

Hisham ibn Hakim e praktikonte në jetën e tij çdo mësim që kishte mësuar apo që dëgjonte t'i raporto-hej në rrugë të sigurt. Një ditë, teksha printe namazin në xhami si imam, e pati lexuar suren Furkan me kiraete të ndryshme.

Kur e dëgjoi këtë halifi Umer, ndërhyu menjëherë pas faljes së namazit, e mori Hishamin pér krahun dhe e çoi tek i Dërguari i Allahut. Hadithi sherif në të cilin rrëfehet kjo ngjarje, gjendet tek Buhariu, Muslimi dhe Ebu Davudi në këtë formë:

"Umer ibn Hatabi rrëfen:

- E pata dëgjuar Hisham Ibn Hakim ibn Hizamin duke e lexuar suren Furkan në forma të ndryshme. Nuk e kisha dëgjuar të Dërguarin e Allahut ta lexonte atë sure në atë formë. Isha në namaz dhe m'u bë t'i hidhesha përsipër. Mezi e përbajta veten dhe prita të përfundonte namazin. Me të dhënë selam, e kapa pér rrobe dhe e tërroqa pranë vetes sime.

- Kush të ka mësuar ta lexosh këtë sure në këtë formë? - e pyeta.

- Kështu më ka mësuar ta lexoj i Dërguari i Allahut, - mu përgjigji. Kur mora këtë përgjigje, e humba toruan fare.

- Ti génjen, - i thashë. - Këtë sure ma ka mësuar edhe mua Profeti, por jo kështu siç e lexon ti.

E mora Hishamin me vete dhe së bashku shkuam tek i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem.

- I Dërguari i Allahut, Hishami e lexon suren Furkan ndryshe nga mënyra se si ma keni mësuar ju mua!

I Dërguari i Allahut i tha me qetësi:

- Lëshoja njëherë krahun!- Pastaj u kthyer nga Hishami dhe i tha atij:

- Pa lexoje njëherë suren me zë, o Hisham!
- Hishami e lexoi suren ashtu siç e kishte lexuar në namaz.

I Dërguari i Allahut u kthye nga unë dhe më tha:

- Po, në këtë formë më ka zbritur edhe mua kjo sure! Pa këndoje edhe ti, Umer!

Unë e lexova suren ashtu siç ma kishte mësuar Profeti.

Atëherë Profeti na tha:

- Po, kjo sure është shpallur edhe në këtë formë leximi. Dijeni se Kurani është shpallur në shtatë dialekta. Ju lexojeni me atë formë që e keni më të lehtë." (Buhari, Fedailu'l-Kuran 5, 27, Husumat 4, Tevhid 53; Muslim, Musafirin 270, (818); Ebu Davud, Salat 357, (1475); Tirmidhi, Kiraat 2, (2944); Nesai, Salat 37, (2, 150-152); Muvatta, Kur'an 5, (1, 102)

Me këto fjalë i Dërguari i Allahut u sqaroi atyre se Kurani qe shpallur në shtatë dialekta, prandaj leximi i Kuranit sipas njërsës prej këtyre formave të leximit është e lejuar.

Megjithëse nuk dihet data e saktë se kur ka vdekur, Hisham ibn Hakimi duhet të ketë vdekur pas vitit 636. Në disa burime thuhet se ai vdiq në betejën e Exhnadejnit, por kjo nuk është e dhënë e saktë, pasi ai që vdiq në këtë betejë ka qenë Hisham ibn As.

Allahu qoftë i kënaqur me të. Allahu na mundësoftë të gjithëve shefaatin e Profetit.

Amin!..



# MURI PREJ GURI

Jetojmë mbi sipärfaqen e dheut pér tē ndërtuar atë që humbëm kur zbritëm në tokë. Kësosoj, ndërtimi është një proces që na bashkëshoqëron gjatë gjithë jetës, paravarësish se si zgjedhim tē ndërtojmë. Shumë syresh zgjedhin tē ndërtojnë pér tē fituar atë që humbën e shumë syresh zgjedhin tē ndërtojnë atë që nuk kanë humbur asnijëherë. Natyrisht, tē ndërtosh nuk është dhe aq e thjeshtë sa mund tē duket, aq e lehtë sa mund tē shfaqet në pamje tē parë.

Ndërtimi kërkon pajimin me një sërë cilësish dhe vetish, tē cilat pér hir tē së vërtetës, as nuk mund t'ia japësh vetes, po as nuk mund t'i përfitosh thjesht duke u praktikuar, në qoftë se nuk kanë ardhur bashkë me ty mbi sipärfaqen e dheut. Sakrificën e ndërtimit dhe aftësinë pér tē ndërtuar e dëshmon muri prej guri. Njeriu mendon tē ndërtojë dhe gjëja e parë që i shkon në mendje ndërtuesit është tē krijojë terrenin e përshtatshëm pér tē ndërtuar. Pasi ka parapërgatitur terrenin mendon tē zgjedhë gurët që do tē vendosë pér tē formuar bazamentin e ndërtimit, në mënyrë që lidhja e terrenit me gurët e bazamentit tē jetë e qëndrueshme.

Çfarë lloj gurësh do tē zgjedhë pér tē krijuar bazamentin? Çfarë cilësish duhet tē kenë, në mënyrë që këta gurë tē mbajnë peshën e mijëra tē tjerëve pa u dëmtuar nga pesha e tyre? Një ndërtues i mirë, një mjeshtër i mirë e di mirë se si duhet tē veprojë me përzgjedhjen e gurëve tē bazamentit. Pasi e ka realizuar

përzgjedhjen e gurëve i duhet tē vendosë mbi mënyrën e radhitjes së tyre në vijën e parë tē bazamentit, që jo vetëm lidhja me terrenin ku mbeshteten tē jetë e qëndrueshme, por edhe lidhja mes gurëve tē bazamentit tē jetë e qëndrueshme.

Për këtë ai ndalet, ulet dhe mendon. Mjeshtrin e vërtetë nuk e rrëmbej entuziazmi i ndërtimit dhe përfundimit të shpejtë tē tij. Ai e di se duhet ta ndërtojë në mendjen e tij çdo gjë më së pari përpara se tē veprojë në terren dhe pér këtë i duhet durim, përpjekje, dashuri dhe shpresë. U hedh gurëve tē bazamentit një vështrim tē thellë dhe e kupton rëndësinë që kanë ata pér ndërtimin e tij, prandaj i trajton me rëndësinë që u takon.

Fillon vendosja e tyre në vendin që u takon sipas pëshës që do tē mbajnë kur ndërtimi tē nisë e tē marrë formë. Mbi gurët e bazamentit duhet tē vendosen gurë tē tjerë, tē cilët do tē lidhen me gurët e bazamentit, me njëri-tjetrin, por do tē shërbijnë edhe vetë si bazament pér tē lidhur tē tjerë gurë me njëri-tjetrin. Sikundërse e sipërtheksuam, mund tē duket e thjeshtë në pamje tē parë pér tē ndërtuar murin prej guri, por nuk duhet tē harrojmë se gurët që do tē vendosen në këtë mur janë tē formave dhe përmasave tē ndryshme. Nuk duhet harruar gjithashtu se muri ka dy faqe dhe mes tyre një hapësirë që duhet mbushur, në mënyrë që tē jetë i qëndrueshëm dhe estetik në tē gjitha anët e tij.

Kësosoj, përballë atij që ndëronton gjendet një sfidë e madhe. Cilët gurë tē zgjedhë tē vendosë në murin e



tij? Të vendosë çdo gur që kap dora e tij për ta mbyllur shpejt këtë ndërtim apo përballë masës së gurëve që ka përballë të rrëmojë më syrin e tij për të gjetur ata gurë të cilët do të janë në lidhje të qëndrueshme dhe në sinkron me gurët e bazamentit? Sinkronizimi me gurët e bazamentit është tepër i rëndësishëm për securinë e mirë të ndërtimit, përndryshe mund të rezultojë me probleme apo edhe fatale puna e ndërtuesit. Përgjedhja nuk është e lehtë, madje është tepër e vështirë.

Duhet të jesh aq i aftë, saqë gurët e formave dhe përmasave të ndryshme të arrish t'i kombinosh dhe t'i lidhësh me njëri-tjetrin për të krijuar një tërsi. A mundet vallë të ketë sukses çokush në këtë punë? A mund të jetë kaq e thjeshtë të arrish të krijosh një unison mes gjithë këtyre formave dhe përmasave? Mjeshtri i vërtetë e di këtë dhe prandaj nuk ngutet. Përgjedh me ngadalë, godet aty ku duhet goditur, gdhend aty ku duhet gdhendur, modelon aty ku duhet modeluar, por edhe lëshon pe aty ku duhet lëshuar, pasiqë format natyrale të gurëve janë të tillë, saqë është e pamundur t'i puthitet për gjithë me njëri-tjetrin siç mund të puthiten produktet serike të teknologjisë.

Ka dhe prej atyre gurëve që nuk mbajnë dot goditje për tu latuar e duhet t'i përdorësh ashtu siç janë. Kësisoj, gjithësecili gur me formën dhe përmasën e vet do ta gjejë vendin e vet në murin prej guri, por vetëm me mjeshterinë e mjeshtrit që, duke përdorur aftesitë

që i janë dhënë, arrin të harmonizojë në një ndërtim të vetëm gurët e formave dhe përmasave të llojlojshme. E kur muri përfundon dhe i hedh një vështrim soditës, e kupton se ajo çka t'i e sheh si të bukur në një të tërë është realizuar pikërisht nëpërmjet këtyre larushive të formave dhe përmasave të gurëve të harmonizuar nga mjeshteria e mjeshtrit.

E në qoftë se dikush e sheh për të gjetur të meta dhe të paragjykojë mjeshtrin që ka ndërtuar atë çfarë ka ndërtuar, atëherë a thua paragjykimi i dikujt do t'uua prishë bukurinë aftësive të mjeshtrit dhe veprës së tij? E në qoftë se ndodh që për këtë ndërtim të përhapen fjalë shpifëse nga mjeshtërokët, a mund të ndodh që të humbasë bukuria e asaj çfarë mjeshtri ka ndërtuar? E çfarë do t'i interesojë mjeshtrit, fjalët zbukuronjëse të fjalamanëve apo qëndrueshmëria dhe bukuria e asaj që ka ndërtuar? E çfarë do t'i interesojë mjeshtrit, pëlqimi i njerezve apo pëlqimi i Atij që i dha mjeshtrit aftësinë për të ndërtuar atë që ndërtoi, qoftë edhe sikur të mbetet i panjohur në masën e mjeshtërokëve, çirakëve, kallfëve e fjalamanëve zbukuronjës? Kjo, sepse mjeshtri punon për të realizuar me përgjegjësi ndërtimin e tij, duke mos u humbamendur nga ata që duan humbamendjen e tij për ta ndërtuar jo mirë veprën e tij.

Ai nuk vramendet aspak, vetëm se për t'i shkrirë aftësitë që i janë dhënë për kënaqësinë e Atij që ia ka dhuruar këto aftësi ndërtuese pikërisht këtu mbi sipërfaqen e dheut, për të fituar atë që ka humbur.

# "ALLAHU PËR JU DËSHIRON LEHTËSI"

**"(Allahu) për ju dëshiron lehtësim e nuk dëshiron vështirësim..."** (Bekare, 185)

Allahu me mëshirën dhe rahmetin e Tij të pafund, të gjitha fetë e vërteta që i ka dërguar gjatë shekujve i ka bërë zotëruese të ligjeve që mund të zbatohen shumë lehtë. Sepse Allahu për njerëzit gjithmonë ka dëshiruar lehtësi dhe këtë të vërtetë e ka komunikuar dhe në Kur'an, duke thënë: **"(Allahu) dëshiron lehtësim për ju e nuk dëshiron vështirësim..."**. (Bekare, 185)

Kurse një pjesë e njerëzve që nuk e dinë këtë të vërtetë, mendojnë se do të jetë më e lehtë feja, në rast se ngrihen dispozitat e saj. Shembull: Ata mendojnë se do të jetojnë të lirë dhe të pavarur, kur nuk u jepet rëndësi vlerave të moralit. Ose pretendojnë se feja do t'u sjellë disa sekuestrime që do t'ua vështirësojnë jetesën. Ndërkaq, të gjitha këto janë gabime të mëdha që njerëzit i kanë rrëmbyer dhe janë mashtime te shejtanit. Sepse të jetuarit e fesë së Allahut dhe zbatimi i urdhavrave që gjenden brenda saj është shumë i lehtë. Kurse ajo që është e vështirë, është të jetuarit në një shoqëri që përbëhet prej njerëzve që nuk i njohin dispozitat, urdhrat dhe ligjet e Allahut. Një jetesë e tillë, sjell një përfundim të keq. Prandaj ata që tregojnë lëshim të dispozitave të Allahut, do të jetojnë një jetë të vështirë me brenga dhe shqetësimë si në këtë botë, po ashtu dhe në botën tjetër dhe në të njëjtën kohë,

vetëm veten dëmtojnë. Allahu thotë:

**"...Këto janë dispozitat e Allahut; e kush del jashtë dispozitave të Allahut, ai e ka dëmtuar vetveten..."** (Talak, 1)

Tani do ti shohim disa lehtësi që janë njohur rrëth kryerjes se disa obligimeve.

## FALJA E NAMAZIT ËSHTË SHUME E LEHTË

Namazi është një ibadet që çdo mysliman duhet ta kryejë pa ndërprerje gjatë gjithë jetës së tij. Mirëpo këtë ibadet e kryejnë shumë pak njerëz ose disa mendojnë ta shtyejnë kryerjen e tij në ditët e pleqërisë, ose disa të tjerë mendojnë se kryerja e këtij ibadetit është e vështirë. Ama edhe kryerja e namazit sikur çdo ibadet tjetër është shumë e lehtë.

Nuk duhet harruar se ky ibadet, i cili mund te kryhet shumë lehtë, është njëra ndër shtyllat kryesore të fesë. Prandaj ai i cili mundohet ta kryejë këtë obligim, shpresohet se do ta fitojë mëshirën, dashurinë, faljen dhe xhenetin e Allahut. Kurse lehtësia që gjendet në këtë ibadet shfaq dukjen e mëshirës dhe dashurisë së Allahut. Andaj për atë person që nuk e kryen këtë obligim të Allahut, në Ditën e Kiametit nuk do të ketë asnjë ndjesë. Sepse për kryerjen e këtij ibadeti është bërë çdo gjë e lehtë. Shembull: marrja e abdestit është

# M E NUK DËSHIRON VËSHTIRËSIM... ”

bërë shumë e lehtë. Madje, edhe nëse nuk gjendet ujë, Allahu njerëzve për abdest ua ka treguar rrugën e "tejmumit" (të marrit abdest me pluhur). E pa dyshim që marrja e tejmumit është e lehtë për çdo person.

Pastaj, atyre që nuk mund ta falin namazin në këmbë ua ka mundësuar ta falin ulur, nëse nuk munden as ulur ta falin shtrirë. Kjo tregon se Allahu nuk dëshiron aspak vështirësi për robërit e tij. Kështu që Allahu me mëshirën dhe rahmetin e Tij të pafund, për njerëzit e ka komunikuar mënyrën e kryerjes më të mirë, më të lehtë të ibadeteve (adhurimeve) dhe ata që e kryejnë këtë ibadet (adhurim), i ka pagëzuar me dashuri, mëshirë dhe me xhenet.

## AGJERIMI ËSHTË SHUMË I LEHTË

Allahu të gjithë besimtarët i ka obliguar ta agjerojnë muajin e ramazanit. Ky agjérím shumë njerëzve u duket i vështirë, mirépo në të vërtet nuk është aspak i vështirë, sepse Allahu sikur obligimet e tjera, e ka bërë të lehtë edhe këtë obligim. Përveç kësaj, Allahu (xh.sh.), agjéri-min e ka lehtësuar në gjendjet e jashtëzakonshme. Si rrjedhojë e kësaj, Allahu në ajetin 185 të sures Bekare ka treguar se kush e arrin muajin e ramazanit, duhet të agjerojë dhe si lehtësi për ata që janë të sëmurë ose janë në udhëtim, ua ka bërë të mundshëm të agjerojnë më vonë.

Ne fund të ajetin kuranor tregohet se Allahu nuk kërkon ndonjë vështirësi për njerëzit. Prandaj të përkujtuarit se Allahu dëshiron lehtësi për njerëzit në fund të ajetit kuranor tregon se nevojitet të kuptohet duke sjellë në mend dhe lehtësinë e obligimeve të tjera të fesë. Si rrjedhojë e kësaj, janë brenda një mashtrimit të madh ata që ikin dhe largohen nga kryerja e obligimeve të fesë, duke pretenduar se janë të vështira zbatimet e tyre duke qenë të paqartë në lidhje me fenë e tyre.

## ÇDO GJË BRENDË MUNDËSIVE

Sado që të shihen të vështira obligimet e fesë ose ngjarjet me të cilat përballet njeriu gjatë jetës së tij, prapëserapë ato janë në nivelin e asaj që mund të përballojë njeriu. Ai që e ka krijuar njeriun dhe e ka pa-jisur me shpirë, është Allahu i Lartmadhëruar. Në këtë mënyrë, Ai e di më së miri se sa mund të bartin njerëzit, pra sa mund të durojnë njerëzit përballë vështirësive. Kështu që Allahu askënd nuk e obligon përtej mundësisë. Në Kur'an thotë:

***Allahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë së tij... (Bekare, 286)***

***Ata që besuan dhe bënë vepra të mira; e Ne as që obligojmë ndokënd çka nuk ka mundësi (të veprojë), të tillët janë banues të xhenetit dhe në të janë përgjithmonë. (A'raf, 42)***



Pa dyshim, ngjarjet me tē cilat përballen njerëzit ka mundësi tē jenë tē ndryshme. Andaj dhe durimi dhe mbështetja në Allahun përballë këtyre ngjarjeve tek njerëzit janë tē ndryshme. Vetëm se Allahu për secilin njeri sprovat i ka bërë në përputhje me forcën e tyre. Shembull: disa njerëz në këtë jetë vazhdojnë një jetë tē varfër dhe me këtë jetë tē varfër ata sprovojen se sa janë tē durueshëm. Kurse disa tē tjerë jetojnë tē pasur, po edhe këta në tē njëjtën mënyrë sprovojen me atë se sa janë falënderues dhe tregues tē moralit tē bukur dhe shikohen nëse janë tē lidhur apo jo pas bukurive, pas kënaqësive dhe défrimeve tē kësaj jete. Por më në fund, si ai që është i pasur, si ai që është i varfër për veten e tyre, duhet ta jetojnë jetën sa më mirë. Fukurai, sado që heq prej varfërisë, kjo nuk është e papërballueshme për tē. Në tē njëjtën mënyrë edhe tē pasurin, pasuria nuk e detyron tē mburret, tē bëhet mosmirënlohës. Prandaj, njerëzit në çdo situatë, gjithmonë duhet t'i drejtohen Allahut dhe vetëm prej Tij tē kërkojnë ndihmë. Sepse për njerëzit që i besojnë dhe i mbështeten Allahut, për tē treguar mëshirën dhe dashurinë e madhe ndaj Tij, Allahu i Lartmadhëruar ua lehtëson atyre edhe punën më tē vështirë. Në një ajet kuranor është treguar:

**Sa i përket atij që besoi dhe bëri vepra tē mira, atij i takon shpërblimi më i mirë (xheneti) dhe atij nga ana Jonë do t'i bëj më lehtësi** (në jetë). (Kehf, 88)

Ndërkaq, atyre që nuk i mbësh-teten dhe nuk i besojnë Allahut, u vijnë tē vështira edhe situatat më tē lehta. Për këtë arsy, Zoti u jep këtyre njerëzve gjithmonë vështirësi në jetën e kësaj bote, si dënim për atë që janë larguar prej moralit tē Kur'anit, mirënlohjes së Allahut dhe mohimit tē fesë së vërtetë:

**E sa i përket atij që bën kopraci dhe e ndjen veten tē pavarrur (nga Zoti), dhe përgënjeshtron atë më tē mirën, ne do ta përgatisim për më tē vështirën. E pasuria e tij nuk do t'i bëjë dobi, kur ai tē zhduket. Detyra jonë është vetëm tē udhëzojmë.** (Lejl, 8-12)

### BETIMET E PAQËLLIMTA

Të betuarit, në përgjithësi është një sjellje e përhapur që është bërë ves i gjuhës në mesin e njerëzve. Kështu që njeriu me këtë ves mund tē betohet gjersa i jep fjalën dikujt për diçka. Kurse besnikëria për fjalën e dhënë dhe mbajtja e fjalës janë veçori tē besimtarit, që Allahu i ka urdhëruar në Kur'an. Megjithatë, njeriu si krijesë gabim-

tare mund tē harrojë. Kjo gjë është shumë e natyrshme kur nuk bëhet me qëllim. Padyshim që në ahiret do tē pyetet besnikëria e besimtarëve, por ata njerëz që betohen pa qëllim, Allahu nuk do t'i mbajë përgjegjës në ahiret. Kjo gjë në Kur'an tregohet kështu:

**Allahu nuk ju merr në përgjegjësi për betimet tuaja tē paqëllimta, por ju merr për ato që i bëni qëllimisht me gjithë zemër. Allahu është i butë dhe fal shumë.** (Bekare, 225)

Përveç kësaj, është edhe një lehtësi tjetër në çesh-tjen e betimit. Ajo është shpagimi. Kjo lehtësi është njojur për ata persona që betohen në emër tē Allahut, por pastaj me vetëdije tē plotë dëshirojnë ta prishin betimin. Kështu që rrugëzgjidha e kësaj është shpagimi. Allahu thotë:

**"Allahu ua ka përcaktuar juve zgjidhjen e betimeve tuaja..."** (Tahrim, 2)

**"Allahu nuk ju merr në përgjegjësi për betimet tuaja tē paqëllimta, por ju merr për ato që jeni zotuar qëllimisht. E shpagimi i tij (i betimit tē bërë) është duke i ushqyer dhjetë tē varfër me ushqim mesatar që ushqeni familjen tuaj ose duke i veshur ata (të dhjetë), ose duke liruar një rob. E kush nuk ka mundësi t'i bëjë këto, le të agjerojë tri ditë. Ky është shpagim për betimet tuaja kur i theni ato. Ruani betimet tuaja. Kështu Allahu ju sqaron dispozitat e veta, në mënyrë që tē jeni mirënlohës".** (Maide, 89)

Siq u kuptua nga ajetet kuranore, Allahu në dy gjendjet ka treguar lehtësi tē përshtat-shme në fe për veprimin e njerëzve. S'ka dyshim që mbajtja e betimit është më e drejtë dhe më e bukur. Vetëm se njeriu ose mund ta harrojë fjalën e dhënë, ose mund tē ndryshojnë kushtet në periudhën ku e ka dhënë fjalën ose mund tē bjerë në një situatë aq tē vështirë, saqë nuk mund ta mbajë fjalën. Kështu që Allahu, duke dëshiruar lehtësi për njerëzit, e ka treguar rrugë e shpagimit për betimin dhe në këtë mënyrë për çdo gjë ka treguar rrugëdalje.

Pra Allahu fenë e ka bërë shumë tē lehtë. Feja isla-më është fe e lehtësisë për çdo çështje dhe për çdo gjë. Njeriu kur synon tē bëhet fetar i mirë dhe një rob falënderues i dhundive tē Allahut, asnjëherë nuk do t'i shohë si tē vështira zbatimin dhe jetimin e dispozitave tē fesë.





# Sjelljet e hijishme DHE RESPEKTI

1. Sjellja e edukuar mes myslimanëve. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "...dhe sillu me njerëzit me ahlak t̄e bukur." (Ahmedi, Tirmidhiu, Hakimi)

2. Të mos kemi zili ndaj vëllezërve myslimanë, të cilët Allahu i ka dalluar nga t̄e tjerët, duke u dhënë t̄e mira që ne nuk i kemi. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Mos kini smirë për njëri- tjetrin, mos mashtroni, mos e urreni njëri- tjetrin, mos ia ktheni shpinën njëri- tjetrit. Bëhuni vëllezër me njëri-tjetrin." (Muslim)

3. Besimtar i duhet t̄e rrijë i buzëqeshur, fjalëmirë dhe zemërgjerë me besimtarët.

4. Të duash për vëllain tënd atë gjë që do për veten tênde. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Askush prej jush nuk është besimtar (i vërtetë), përderisa nuk do edhe për vëllain e tij atë që do për veten e tij". (Buhari Muslim)

Tregohet në librin Minhaxh el Muslim se në shtëpinë e Ebu Hasen Antakit u mblodhën tridhjetë e ca veta dhe me vete kishin vetëm disa kothere buke, që nuk mjaftonin për t'u ngopur. Kur u ulën për të ngrënë, fikën kandilin, por kur u ngrit sofa, u pa se nuk ishte prekur asnjë kothere buke, sepse secili kishte menduar për tjetrin, duke mos ngrënë vetë, megjithëse t̄e gjithë ishin t̄e uritur.

5. T'i japësh selam vëllait kur e takon atë. Selami e shuan sjelljen e ashpër, e zvogëlon urrejtjen dhe forcon vëllazërinë dhe miqësinë.

Transmetohet nga Tirmidhiu dhe Ebu Davudi se Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Më i miri prej njerëzve është ai që përshëndet i pari me selam!" Në një hadith t̄e transmetuar nga Muslimi Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Nuk do t̄e hyni në xhenet derisa t̄e besoni dhe nuk do t̄e besoni derisa t̄e mos ia doni t̄e mirën njëri-tjetrit. A dëshironi t'ju tregoj një gjë t̄e cilën, nëse e bëni, do ta respektoni më shumë njëri-tjetrin? Përhapeni selamin midis jush".

6. Konsultimi me vëllezërit dhe pranimi i propozimeve t̄e drejta. Allahu (xh.sh.), i ka thënë Pejgamberit (a.s.):

"...dhe këshillohu me ata për çështje t̄e ndryshme. Kur t̄e vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu..." (Al 'Imran, 159)

7. Mos t̄e lejohet në prezencën tuaj shpifja dhe për- gojimi i vëllezërve tanë myslimanë. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Në xhenet nuk do t̄e hyjnë ata që shpifin për t̄e tjerët." (Buhari, Muslimi, Tirmidhiu, Ebu Davudi.)

Halil Ibn Ahmedi ka thënë: "Kush bart fjalë tek ti, ai bart fjalë edhe prej teje. Kush sjell lajme për dikë, ai i dërgon dikujt lajme edhe për ty."

8. Të vizitoohen vëllezërit dhe t̄e pyeten për gjendjen e tyre. Ebu Hurejra transmeton se Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Një njeri shkoi t̄e vizitonte një vëllain e tij mysliman në një fshat tjetër. Allahu dërgoi një engjëll në rrugën nga do t̄e kalonte. Kur ai kaloi pranë tij, engjëlli e pyeti: "Ku po shkon?" "Dua t̄e shkoj t̄e vizitoj një vëlla në këtë fshat"-u përgjigj ai. "A ke ndonjë interes, që po shkon?" - vazhdoi engjëlli. "Jo-tha ai- unë e dua atë për hir t̄e Allahut, prandaj dua t̄e shkoj ta vizitoj." "Unë jam meleku i Allahut. Jam dërguar tek ti për t̄e njoftuar se Allahu t̄e do, ashtu si e do ti atë mysliman për hir t̄e Zotit" - tha engjëlli. (Muslimi)

9. Lutu për vëllain edhe kur është gjallë, edhe pasi t̄e ketë vdekur.

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Kur mysliman i lutet për vëllain e tij, pa ditur gjë (ky i fundit), lutja pranohet. Te koka e lutësit qëndron një engjëll, që ka për detyrr që pas çdo lutjeje t̄e mirë për vëllain mysliman t̄e thotë Amin, ta dhëntë Allahu edhe ty t̄e njëjtën gjë!" (Muslimi)

10. Të mos teprohet as në respektim dhe miqësi, as në urrejtje. Ali Ibn Ebu Talib (r.a.), ka thënë: "Duaje mikun t̄end me masë, ndoshta një ditë do t̄e bëhet armiku yt. Urreje armikun t̄end me masë, ndoshta një ditë do t̄e bëhet miku yt".

## NJË STUDIM I RI PËR KANCERIN E MUSHKËRIVE

Sipas një studimi të ri, një numër sëmundjesh serioze në mushkëri mund të shtojnë rrezikun e zhvillimit të kancerit të mushkërive, edhe pse studiuesit nuk gjeten të dhëna, sipas të cilave këto sëmundje shkaktojnë kancer.

Në analizimin e të dhënave të mbi 25 mijë personave, studiuesit zbuluan se njëzit që kishin kaluar bronshit kronik, emfizemë, apo pneumoni, rrezikoheshin më tepër të zhvillonin kancer në mushkëri. Ndërsa personat që i kishin pasur të treja këto sëmundje të mushkërive paraqisnin një rrezik më të madh për kancer se sa personat që kishin kaluar vetëm bronshit.

Azma dhe tuberkulozi nuk lidhen, sipas studimit, me rrezik më të madh të kancerit të mushkërive.

Përfundimet e studimit u botuan në Gazetën Amerikane të Sëmundjeve Respiratore dhe Kujdesit për Sëmundjet e Rrezikshme.



Studiuesit në Agjencinë Ndërkombëtare për Studime mbi Kancerin në Lyon të Francës, arritën në përfundimin e paraqitur në raport, pasi shqyrtuan të dhëna nga shtatë studime të kryera në Evropë dhe në Kanada.

Studiuesja Ann Olsson tha se disa mekanizma të sëmundjeve

të ndryshme të organeve të frymëmarrjes mund të janë arsyja që ato ndikojnë në zhvillimin e kancerit në mënyra të ndryshme.

Njohja e këtij rreziku, tha studiuesja, mund t'i ndihmojë mjekët që t'i mbajnë nën vëzhgim pacientët me sëmundje të ndryshme të mushkërive.

## PROPOLISI

Propolis (ngjitësi i bletës) është një masë rrëshire, zakonisht, ngjyrë e verdhë në të gjelbër ose kafe dhe e tretshme, të cilin bletët punitore e mbledhin nga sythët dhe lëkurët e pemëve dhe e përdorin përfiksimin e huallëve të dyllit dhe ngushtimin e hyrjes së kosheres sipas nevojës së bletëve. Nëse një mi apo bretkosë është aq i patët sa të vritet brenda një zgjoi, bletët do ta veshin kafshën e ngordhur me këtë lloj substance (propolis do të thotë "për mbrojtjen e individëve") para se trupi të kalbet. Kjo shhang erën e pakëndshme dhe parandalon përhapjen e baktereve në popullatën e bletës.

Përbërësit e propolis:

1. Lëndë rrëshinore, balsam dhe

lëndë ngjitëse: 55%

2. Disa lloj dyllesh: 7.5-35%

3. Vajra të avullueshëm: 5%

4. Polen: 5%

5. Lëndë të ndryshme organike dhe minerale: 5%

6. Vitamina dhe disa lëndë të panjohura: 4.4-19%

Vetitë kuruese dhe shkaqet e përdorimit:

1. Propolisi përmirëson punën e sistemit imun dhe konsiderohet si antibiotik natyror kundër viruseve dhe infeksioneve.

2. Antikanceror, përfaktin se aktivizon qelizat ngrënëse dhe është vërtetuar se ai pengon zhvillimin e qelizave kancerore në zorrën e

trashë dhe lufton kancerin e gjakut -Leukemin.

3. Antialergjik në përgjithësi, nëpërmjet shtimit të fuqisë së gjakut për pengimin e hestamini-si rezultat i "quercetin" që ai përmban.

4. Antibiotik natyral me përdorim të gjërë, d.m.th. që mbulon një varg të madh bakteriesh, siç janë hilikcobacter dhe bakteri i tuberkulozit.

5. Antimykoz. Propolisi konsiderohet si lënda më e fortë kundër mykut Candida, prandaj disa nëna e lyejnë gojën e mykur të foshnjave me të.

6. Pastrues dhe sulmues i sëmundjeve ngjitëse, për shkak se

përmban Benzoic Acid.

7. Antitumorial, sepse pakëson depërtimin nëpërmjet kapilarëve të gjakut duke i fuqizuar ato me anë të grüpuit të flavonoidëve që ai përmban.

8. Fuqizues dhe përtëritës i lëkurës dhe i membranave të brendshme mukoze.

9. Pakëson ngritjen e tensionit të gjakut.

10. Ndihmon në sekrecionin e vrerit, i cili tret yndyrat.

11. Rrit aktivitetin e qelizave limfatike për të ngrënë qelizat e huaja.

12. Parandalon dhe pakëson dështimin akut të frysëmarrjes – Eriadietyl.

13. Korrigjon prodhimin e collagenit dhe elastinit, të cilat marrin pjesë në ndërtimin e qelizave elastike të lëkurës dhe të kapilarëve të gjakut, si dhe në ndërtimin e qelizave të kërceve dhe ligamenteve.

14. Propolisi përdoret gjithashtu për lyerje sipërfaqësore: për pucërat e rinisë, të thatët, lungën (xhungat e mbushura me qelb), sëmundjet mykoze të thella të lëkurës, ekzemën dhe Pyodermën.

15. Për kurimin e infeksionit të kyçeve dhe të sistemit muskular (me lyerje nga jashtë).

Këshilla që duhen pasur para-sysh para përdorimit të propolis-it të bletës:

Eksistojnë 1-2% e njerëzve që kanë alergji nga propolis apo nga disa lëndë që ai përbën. Alergjia e këtyre njerëzve shfaqet në këto simptoma:

1. Alergji në lëkurë kur e prek propolisin në formë kremi apo të freskët, me kruarje dhe skruje të lëkurës.

2. Alergji në frysëmarrje kur e nuhat.

3. Alergji në gojë (kur e ha), duke shkaktuar ngacmim brenda gojës



ose çregullime në zorrë dhe diarre (bark).

4. Me ulje të tensionit të gjakut.

Për këtë arsy, së pari duhet provuar nëse shkaktohet apo jo alergji nga propolis (si dhe nga të gjitha produktet e bletës), duke përdorur në fillim një sasi shumë të vogël prej tij dhe më pas duke e shtuar gradualisht atë.

Doza dhe mënyra e përdorimit:

Propolis nuk përdoret për fëmijë nën një vjeç.

Doza dhe koha e saj përcaktohet nga mjeku kurues, në varësi të sëmundjes dhe të sëmurit, në këtë mënyrë:

1. Propolis i freskët (bruto): 1 gram (1-3 herë në ditë), duke e përtypur nëpër gojë për 5-20 minuta dhe më pas mund ta përcjellësh pa problem.

2. Esenca e propolis-it (5-50% përqendrim): 5-30 pika, tre herë në ditë, me mjalt të holuar me ujë ose me limonadë. Esenca e propolis mund të përdoret edhe nga jashtë në kozmetikë dhe për larje nga poshtë (për infeksionet

e vaginës).

3. Organizmi i njeriut mund ta përballojë më së miri 1 gram propolis për çdo kg të peshës së trupit të tij.

4. Pluhuri i propolis mund të përdoret duke përzierë 3 gram propolis me 125 gram mjalt, dhe të merrret një apo dy lugë në ditë.

5. Në rastet e përdorimit të jashëtëm të propolis, këshillohet që të merret edhe nga goja në të njëjtën kohë, sepse këto përdorime plotësojnë efektin e njëri-tjetrit. Përdorimi i jashtëm i propolis mund të bëhet një apo disa herë në ditë sipas nevojës.

6. Përdorimi i propolis për nuançat jep rezultate të shkëlqyera në rastet me probleme në rrugët e frysëmarrjes dhe në mushkri.

Ruatja dhe magazinimi:

Nuk kërkohen veprime të veçanta përruajtjen e propolisit, por preferohet që të ruhet në enë ku nuk depërtton drita, të myllura mirë dhe larg nxehësisë. Si gjithnjë në lidhje me përdorimet mje-kësore, preferohet që produkti të jetë i freskët.

## PANAIRI I LIBRIT ULQIN 2014



Një ndër veprimitaritë më të rëndësishme kulturore, panairi i 14 i librit i quajtur "Ulqini 2014" është celur prej tre ditësh në shëtitoren e vogël të qytetit të Ulqinit. Nën kujdesin e kryetarit të komunës së Ulqinit, Fatmir Gjeka, vazhdimi i traditës së festës së librit ka tërhequr vëmendjen e mjaft lexuesve dhe mjaft pushuesve që ndodhen në qytet.

Gjeka në fjalën e hapjes u shpreh se "Ulqini këto ditë kremton festën e librit", duke shtuar se "kjo është mënyra që Ulqini të bëhet destinacion i artit dhe kulturës". Të pranishmit i përshëndeti dhe europarlamentarja, Valentina Leskaj, ndihmësi i ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Qeverinë e Kosovës, Gani Elshani dhe drejtoresha e Organizatës Turistike të Ulqinit, Zana Sarvan. Veprimtaria, e cila ka ftuar dhe ka pasur të pranishëm

mjaft poetë e shkrimtarë, personalitete të kulturës dhe artit, si dhe përfaqësues ngajeta politike e shoqërore si nga Shqipëria, ashtu edhe nga Kosova e Mali i Zi, i prezantuar mbi 50 autorë nga këto vende dhe ka eksposuar e ka nxjerrë në shitje mbi 4 mijë tituj librash, prej të cilëve rreth 400 prej tyre janë libra të rinj. Librat janë eksposuar përgjatë shëtitores së Plazhit të Vogël në Ulqin. Lexuesve dhe pushuesve të ndodhur në panair, u janë paraqitur libra të gjinive e llojeve të ndryshme si, libra artistikë nga autorë shqiptarë e të huaj, tema nga historia e kultura, libra për fëmijë, fjalorë e metoda për mësimin e gjuhëve të huaja, katalogë e albumë të ndryshme, etj. Midis shumë shtëpive botuese nga Shqipëria mori pjesë edhe shtëpia botuese Progresi me 15 tituj të rinj.

## ZGJEDHJET PRESIDENCIALE NË TURQI

Kryeministri turk Rexhep Tajip Erdogan ka fituar zgjedhjet e para të drejtpërdrejta presidenciale me votim nga populli, duke u shpallur kështu për herë të parë President i Turqisë. Me pothuajse të gjitha votat e numëruara, Erdogan ka arritur të marrë rreth 52% të votave, ose mbi 20 milionë vota.

Kundërshtari i tij kryesor Ekmeledin Ihsanoglu, ka pranuar humbjen, pasi nuk ka arritur të marrë më shumë se 38% të votave. Ndërsa kundërshtari tjetër politikani kurd Selahattin Demirtas, mori rreth 9% të votave.

Menjëherë pas daljes së rezultateve paraprake, Erdogan, doli përpëra votuesve të tij, ku shpalli fitoren, ndërsa theksoi se populli sot shprehu vullnetin e tij.

"Njerëzit shprehën vullnetin e tyre në zgjedhjet e sotme." u shpreh Erdogan

Para zgjedhjeve Erdogan tha se ai dëshironte të fitonte për të forcuar postin e Presidentit të Turqisë që është kryesish ceremonialis. Rezultati i këtyre zgjedhjeve shmag kështu nevojnë për një balotazh pasi irregullat zgjedhore kërkonin që kandidati fitues të arrijë më tepër se 50% të votave, në të kundërt do të mbahej një raund tjetër më 24 gusht.



Kurse në postin e kryeministrit të ardhshëm u zgjodh ministri ijashtëm Ahmet Davutoglu. Partia në pozitë e shpalli zyrtarisht zgjedjen e tij si kryeministër. Përpëra kësaj, pritej gjërisht që zoti Davutoglu ta merrte këtë post, si favorit kryesor i presidentit të sapo zgjedhur Rexhep Tajip Erdogan.


Parase të bëhej ministri ijashtëm, 55-vjeçari Davutoglu ka qenë këshilltar i zotit Erdogan për politikën e jashtme. Ai është akademik dhe flet rrjedhshëm disa gjuhë.

Pas njoftimit, zoti Davutoglu tha se lufta e partisë së tij "për të drejtat dhe demokracinë" nuk do të kufizohet nga "vite apo shekuj."

## CERN: SHKENCËTARET AFËR ZBULIMIT TË GRIMCËS SË PAKAPSHME SUBATOMIKE

Shkencëtarët e Organizatës Evropiane për Shqyrtimë Atomike (CERN) në Zvicër kanë deklaruar se janë afër zbulimit të grimcës së pakapshme subatomike, që besohet se është pjesë bazike e përbërjes së materies. Gjatë ditës së sotme shkencëtarët në Gjenevë thanë se kanë gjetur shenja të të ashtuquajturës "Higgs boson", një grimcë elementare lidhëse, që mungon në Modelin Standard të

fizikës. Atakanë theksuar gjithashtu se gjetjet e tyre nuk janë zbulim përfundimtar i kësaj grimce (Higgs boson). Ky rezultat ka prodhuar një lloj lëvizjeje intensive në radhët e atyre që shpresojnë se grimca, gjithmonë nëse ajo ekziston, mund të ndihmojë në shpjegimin e shumë mistereve në univers. Në teori, "Higgs boson" është grimcë që u jep masë të gjitha grimcave të tjera fondamentale.



## TESTOHET APARATI PËR LEXIMIN E MENDJES

Javën e kaluar në takimin e radhës të Shoqërisë për Neuroshkencën në Çikago, Xhek Galanti, nga pionierët e "çkodimit nervor" në Universitetin e Kalifornisë, Berkley, paraqiti një prej arritjeve më mbresëlënëse deri më tash të neuroshkencës. Ai dhe kolegu i tij Shinzhi Nishimoto treguan se mund të krijojnë një rprodhim parak të një videoje që po shikon dikush, vetëm nëpërmjet "leximit" të veprimitarisë mendore të videoshikuesit. Gjatë takimit u tha se çkodime të tillë nervore do të mund të përdoren për leximin e kujtimeve dhe të planeve të ardhshme të dikujt, madje dhe në diagnostikimin e çregullimeve në ushqim. Por si funksionon "çkodimi nervor"? Ekipi i Galantit bëri bujë vjet me

aparatin e tij për përcaktimin e fotografive që shikon dikush, thjesht duke "lexuar" të dhënat nga korteksi pamor i trurit. "Por thjesht çkodimi i fotografive nuk na bën punë", thotë Nishimoto. "Përjetimet tona natyrore pamore janë më tepër si filma". Nishimoto dhe Galanti nisen kështu eksperimentin e tyre më të fundit duke iu shfaqur dy personave videoklipë dyorëshe të marra nga DVD të ndryshme, teksha ndërkohë iu skanonin trurin. Një program i posaçëm kompjuterik bënte modelimin e veprimitarisë së tyre trunore gjatë shikimit të videove dhe e përqaste këtë veprimitari me të dhënat përkatëse filmike të videove si forma, ngjyra dhe lëvizjet e saj në çastin që shikoheshin. Mandje programit

iu "ushqyen" videoregistrime të llojlojshme të marra nga shërbimi "YouTube" në harkun e 200 ditëve. Pas kësaj dy personave iu dha dhe një seri e re videoesh, pa lidhje me dy të tjerat, duke i riskanuar trurin. Programi kompjuterik ballafaqoi këto skanime të reja me të dhënat nga video të "Youtube"-it. Për çdo sekondë skanimi, programi zgjodhi 100 videoklipë nga "Youtube"-i që vlerësoi se do t'i ngjanin më tepër videove që ishin parë së fundi nga dy personat. Rezultati përfundimtar ishin sekuanca të vagulla filmike që tregonin pak a shumë një pamje parake se çfarë përafërsisht ishin duke parë personat në fjalë. Sekuencat përdornin modelimin e parë të formave, ngjyrave dhe lëvizjeve për të riprodhuar atë që shikonin personat herën e fundit. "Kjo do të përmirësohet së tepërimi me kalimin e kohës", shtoi Galanti. Dyshja shkencore synon të përmirësojë rindërtimin e filmave duke e ushqyer programin me të dhëna shtesë rrëth përbajtjes së videove, veç formave, ngjyrave dhe lëvizjeve që përdorte deri më tanë. Ndërkohë filmat dhe fotografitë nuk janë të vetmet sende që mund të shquhen nga veprimitaria mendore. Një ekip tjetër nën drejtimin e Eleanor Meguajrit dhe Martin Çeduikut në "Junivërsiteti Kollektiv" të Londrës sollën në Çikago përfundime të punës së tyre kërkimore që tregojnë se as kujtimet nuk janë shumë larg leximit nga skanuesit e trurit.



Arbëria Design

Të gjitha në një vend!

TETOVË - R. e Maqedonisë  
Tel. +389 44 35 33 70  
[www.arberiadesign.com](http://www.arberiadesign.com)

- Studio dizajni
- Shtypshkronjë
- Shtyp - sitë (screen printing)
- Shtypi në format të madh PVC • Tekstil • Bilboard
- Reklama ndriçuese
- Organizimi i fushatave promovuese
- PR dhe Marketing



N.T.P. MAHMUT-HOLDING

Samettin Taç - Nazim Taç

Dewilux®  
SPECIALIST IN PAINT  
NGJYRA DHE LLAQE E SPECIALIZUAR

NGJYRNA - LLAQE - PJESE TË MOBILAVE DHE MEDIJAPAN  
BOYA - VERNIK - MOBİLYA AKSESUARI VE MEDİYAPAN

- SAMET LLAGERA PËR FIOKA
- MEDIJAPAN
- KËND MALLTERIT
- KËND ME RRJET
- KËNDE KNAUFIT NGA ALUMINI
- RRJETA PËR FASADË



Lagja Arbanë Prizren  
[mahmut\\_holding@hotmail.com](mailto:mahmut_holding@hotmail.com)

Mob: +377 044 242 468  
+377 044 230 751  
+377 044 339 452  
+377 044 390 538

Turk/Mob: +90 537 887 1210



Hayatın Tatlı Yanı...





## "LUX DEKOR"

Lux Dekor është firmë private e specializuar për prodhimin e kuzhinave si dhe orendive të ndryshme shtëpiake dhe të zyreve. Bën shitjen e materialit: iverëplaka, MDF, folje për vakumpress, dhe të aksesoarëve përcjellëse për mobiljeri. Bën prodhimin e balloreve – mveshjen me ultrplast – laminat, si dhe plastifikimin vakumpres – ballonpress te balloreve me folje te pvc-se në dimisone të kerkuara nga klienti, gravirimin e fronteve me makinë CNC, kandimin –qitjen e shiritëve pvc dhe abs, prerjen e pllakave, të gjitha keto kryhen me makina te persosur kualitet dhe cilësi te lart.



# CAPA<sup>®</sup> musluk



# REYHAN


Kosovë për herë të parë  
me 5 vjet garanci

N.T.SH. REYHAN  
Distributor për KOSOVË



Të gjitha llojet e baterive, rubinetave të CAPA mund  
t'i gjeni tek firma N.T.Sh. REYHAN - Prizren.  
Si dhe mund të gjeni edhe nëpër lokale të tjera  
në KOSOVË

ELEGANCË, BUKURI, CILËSI  
DHE 5 VJET GARANCI  
ME ÇMIME TË VOLITSHME



ISO 9001



5 ★★★★★  
Yıl Garanti

[www.capamusluk.com.tr](http://www.capamusluk.com.tr)


[www.reyhan-ran.com](http://www.reyhan-ran.com)

*Armatürde Dünyaya Vurulan Marka*

Rr:UCK, Pn Tel: + 381 29 225 555  
Prizren - KOSOVË Mob: + 377 44 115 238

Shitje me shumicë mund të kontaktoni  
përmes telefonave dhe web faqes.

Prodhimet me të cilat kemi fituar SHPËRBLIMIN KOSOVAR TË PRODUKTIT TË QUMËSHTIT 2005




# CILËSI E VËRTETUAR



Adresa-Address: "Tirana" N:9, Prizren  
Tel & Fax: +381 29 622 356  
E-mail:abi@abimilk.com

[www.abimilk.com](http://www.abimilk.com)

Jogurtat me përbajtje  
të kulturave Bio Actire  
Në Kosovë prodhohet  
vetëm nga qumështorja "ABI"  
**Probiotic  
drink**



Industria e qumështit "ABI" Prizren-Kosovë  
"ABI" është licensuar nga ana e Agjencisë Veterinare e Ushqimit të Kosovës  
Numri i licencës : AVUK-001  
"ABI" ka fituar të drejtën për eksport me numrin eksportues : KS-033